



APPROACHING SCIENCE

ANALET
E ALB-SHKENCËS
Viti III, Numri 5,
Dhjetor 2008

Botim i Institutit Alb-Shkenca
(www.alb-shkenca.org)

Në këtë numër:

Tre libra të bibliotekës kastriotase
në përqasje me heraldikën shqiptare

FOTAQ ANDREA - DRITAN MUKA

Gustav Majer dhe albanologjia

BEGZAD BALIU

Elementet kimike:
emërtimi, etimologjia, drejtshkrimi

NEBI CAKA

PROLOG

Botimi i një **reviste informativo-shkencore shiptare** u bë i domosdoshëm në kushtet në të cilat ndodhet dhe zhvillohet sot shkenca në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në një kohë kur numri i anëtarëve të Forumit Alb-Shkenca (<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/alb-shkenca>) është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Shumica e këtyre anëtarëve janë studiues, pedagogë e studentë pasuniversitarë shqiptarë që kryejnë veprimtarinë e tyre shkencor në vende të ndryshme të botës. Por ka edhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës që kontribuojnë në gjallërimin e jetës shkencore në universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Revista e Alb-Shkencës synon të bëjë të njohur në të gjithë botën shqiptare aktivitetin shkencor mjaft të larmishëm dhe shpesh herë shumë cilësor, të studiuesve shqiptarë kudo që ndodhen në botë. Nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të shkrimeve, në këtë revistë kemi pranuar për botim vetëm ato shkrime që kalojnë në nanofiltrin e cilësisë. Këtu pra do të pasqyrohet ajo ç'ka është më e shquara e kontributit shkencor shqiptar në këto vite të para të shekullit XXI.

Kjo revistë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, botim i **Institutit Alb-Shkenca** (www.alb-shkenca.org), është menduar t'i shërbejë një auditori të gjerë intelektualësh e dashamirësish të shkencës në përgjithësi dhe të asaj shqiptare në veçanti. Anëtarët aktualë të Institutit vendosën ta quanin këtë revistë me emrin simbolik: **ANASH—Approaching Science**.

Dikush mund të pyesë: Përse emri ANASH? Ai është akronim i emrit “Analet e Alb-Shkencës” që është edhe emri zyrtar i kësaj reviste. Por fjala shqip “anash” merr një kuptim simbolik fare të veçantë kur vendoset përpara shprehjes në anglisht “Approaching Science”.

Fjala “anash” ka edhe një kuptim të dytë simbolik që reflekton të vërtetën, atë që diaspora intelektuale e shkencore shqiptare është lënë pakëz mënjanë nga vëmendja e politikëbërësve dhe pushtetarëve shqiptarë e ndoshta edhe është harruar për shkak të largësisë e kohës nga trojet e atdheut.

Por e vërteta është që edhe pse ndodhen larg, anash realitetit të përditshëm të shqiptarëve të Ballkanit, intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut shërbejnë jo vetëm si **ambasadorë** të shkëlqyer por vëzhgojnë e ndjekin nga afër ecuritë në çdo fushë të jetës dhe shoqërisë shqiptare. Të organizuar tek Alb-Shkenca ata gjithmonë e më shumë po kërkojnë të marrin pjesë aktivisht dhe të ndihmojnë për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që ndodhen. Botimi i revistës ANASH është shprehje e qartë e këtij angazhimi serioz të **diasporës shkencore** që po përpiqet përditë e më tepër të kontribuojë në zhvillimet jo vetëm të shkencës dhe arsimit por edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Revista ANASH-it përfshin një larmi artikujsh prej fushave nga më të ndryshmet shkencore të përgatitur nga studiues të afirmuar apo studentë pasuniversitarë shqiptarë që kontribuojnë në shkencën botërore edhe në disiplina shkencore nga më të rejat si nanoteknologjia, ekologjia dhe informatika, por edhe në fushat klasike të shkencës si fizika, veterinaria, ekonomia dhe gjuhësia (albanologjia).

Ju urojmë të gjithëve lexim të këndshëm.

Redaktor përgjegjës: **Roland Leli**, Toronto, Kanada
Adminstratore e përgjithshme: **Lindita Komani**, Grac, Austri
Redaktorë shkencorë: **Robert T. Magari**, Ph.D., Florida, SHBA
Nikolla P. Qafoku, Ph.D., Richland, SHBA

KUJTESË PËR SHKRIMET DHE AUTORËT NË “ANASH”

Në revistën ANASH—Approaching Science (Analet e Alb-Shkencës) të përgatitur nga Instituti “Alb-Shkenca” kryesisht botohen: i) raporte shkencore; ii) komente; iii) perspektiva; iv) prezantime apo përmbledhje diskutimesh në konferenca; v) letra që mund t'i dërgohen botuesit të Analeve. Botohen gjithashtu edhe shkrime të cilat mbështeten apo marrin ide nga diskutimet që bëhen në Forumin tonë “Alb-Shkenca”.

i) Raportet shkencore përmbajnë rezultate origjinale të punës shkencore të autorit apo autorëve. Duhet të jenë 4-5 faqe të gjata përfshirë këtu fotot ilustruese dhe referencat bibliografike.

ii) Komentet mund të shkruhen për artikuj të një rëndësie të veçantë në një degë përkatëse shkencore apo edhe për libra shkencorë. Ata duhet të jenë jo më të gjatë se 3 faqe.

iii) Perspektivat paraqesin ide rreth kërkimit shkencor në fusha të veçanta studimi. Ato duhet të jenë 1-3 faqe të gjata.

iv) Prezantimet në konferenca mund të paraqiten si përmbledhje të rezultateve dhe rekomandimeve më kryesore, ku mund të përfshihen jo më tepër se 1-2 foto. Ato duhet të jenë 1-2 faqe të gjatë.

v) Letrat për botuesin duhet të jenë të gjata 1-1,5 faqe dhe do të trajtojnë probleme nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me kërkimin shkencor.

ANASH është një revistë e përgjithshme shkencore me një auditor të gjerë lexuesish që i takojnë fushave të ndryshme. Për këtë arsye, dorëshkrimet që do të dërgohen për botim duhet të jenë të kuptueshme për këtë auditor. Dorëshkrimet do të pranohen në shqip dhe anglisht në adresën: anash@alb-shkenca.org. Ato duhet të shtypen në “word” me hapësirë dyfish ndërmjet rreshtave si dhe me madhësi gërmasë 11 pt.

Pasi merren në redaksi, dorëshkrimet u dërgohen 1-2 recensuesve, njeri prej të cilëve është anëtar i Institutit “Alb-Shkenca”. Procesi është i tillë që recensuesit nuk njohin emrin apo emrat e autorëve, dhe po ashtu, autorët nuk dinë emrat e recensuesve. Dorëshkrimi do t'i kthehet mbrapsht autorit për të reflektuar vërejtjet e rastit e autori do të duhet të ridërgojë në redaksi dorëshkrimin e korrigjuar pas një periudhe jo më të gjatë se 2 javë nga dita që e ka marrë nga redaksia. Çdo komunikim ndërmjet redaksisë, autorëve dhe recensuesve do të bëhet elektronikisht. Këtij procesi nuk do t'i nënshtrohen dorëshkrimet, të cilët u kërkojnë autorëve nga këshilli botues i revistës. Në këtë rast, njëri prej anëtarëve të Këshillit Botues do ta lexojë dorëshkrimin dhe do t'i dërgojë vërejtjet autorit.

Revista botohet në formë elektronike dhe mund të lexohet në faqen e Institutit “Alb-Shkenca” në internet në adresën www.alb-shkenca.org. Për mundësinë e shtypjes së saj dhe për çmimin do të vendoset në vijim. Pyetjet dhe sugjerimet tuaja mund t'i drejtoni në adresën anash@alb-shkenca.org.

PASQYRA E LËNDËS


- 4 *Science*: 10 zbulimet e vitit 2008
- 5 Tre libra të bibliotekës kastriotase në përqsasje me heraldikën shqiptare
FOTAQ ANDREA DHE DRITAN MUKA
- 12 Gara e piramidave LINDITA KOMANI
- 14 Kush do të na shpëtojë nga kriza?
GIORGIO BOCCA
- 15 Gustav Majer dhe albanologjia: Kontributi i studiuesve gjermanë në studimet albanologjike
DR. BEGZAD BALIU
- 25 Elementet kimike: emërtimi, etimologjia dhe drejtshkrimi i tyre
Prof. DR. NEBI ÇAKA
- 35 Rrugëtimi i identiteteve fetare dhe influenza e tyre në shoqërinë shqiptare
DORIAN KOÇI
- 45 Kapitali (Recension libri) LINDITA KOMANI
- 49 Pyjet e virgjëra të ahut në Shqipërinë e Veriut: Lumi i Tropojës
YLLI KORTOÇI DHE MIRVJENA KËLLEZI
- 36 Këndi i librit
- 37 Mbi librin e Dr. Bajram Berishës “Rregullimi lokal në vezoren bovine – Degradimi i matriksit jashtëqelizor, angiogjeneza dhe angioliza”
Dr. NAIM SHABANI

TAKIMI I KATËRT I ALB-SHKENCËS, TETOVË, 2009

Kanë filluar tashmë përpjekjet për organizimin e takimit të ardhshëm të Alb-Shkencës, i cili është menduar të mbahet në qytetin e **Tetovës**, pranë **Universitetit të Europës Juglindore (UEJL)**. Pas Prishtinës dhe Tiranës tani radha i vjen njerit prej qyteteve me shumicë shqiptare në Maqedoni.

Ftojme pra të gjithë anëtarët e Institutit Alb-Shkenca, veçanërisht ata që jetojnë e punojnë në Maqedoni, anëtarë të Forumit tonë dhe gjithë punonjësit shkencorë nga trojet shqiptare e nga diaspora që të na njoftojnë për dëshirën dhe gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë takim. Në adresën e Grupit Administrues ga@alb-shkenca.org, mund të dërgoni temat të cilat ju mendeni të paraqisni në këtë takim dhe të shprehni gatishmërinë tuaj për të kontribuar në mbarëvajtjen e punimeve të konferencave shkencore që do të organizohen në këtë kuadër.

Në Këshillin organizues nismëtar të **Takimit IV** janë caktuar **Zeqirja Neziri**, **Vehbi Bexheti** dhe **Hamit Xhaferi**. Drejtues i këtij grupi do të jetë **Mustafa Ibrahim**, pedagog në Universitetin e Europës Juglindore m.ibrahimi@seeu.edu.mk.



Science: 10 zbulimet e vitit 2008

Përmbledhi Roland Leli

«Riprogramimi qelizor», d.m.th. aktivizimi i një grupi gjenesh që bëjnë të kthehet prapa “orën biologjike” të qelizës deri në stadin embrional ka qenë një nga synimet kryesore shkencore të vitit. Për perspektivat që ky zbulim hap në mjekimin e sëmundjeve të pashërueshme si Alzheimer, Parkinson e distrofitë, revista e mirënjohur *Science* e ka kurorëzuar si zbulimin shkencor të vitit 2008.

Edhe këtë vit, në numrin e saj të fundit *Science* publikoi klasifikimin e zbulimeve më domethënëse të këtyre dymbëdhjetë muajve dhe formuloi parashikimet për vitin që vjen: neuroshkencat, bozoni i Higgsit dhe acidifikimi i oqeanëve mendohen si surprizat 2009.

Më poshtë një përmbledhje e klasifikimit nga vendi i dytë deri në të dhjetin:

2. Planetët jashtëdiellorë

Në vendin e dytë *Science* ka vënë të ashtuquajturit “exoplanets”. Për herë të parë më 2008 astronomët vëzhguan drejtpërsëdrejti planetë orbitantë jashtë sistemit tonë diellor falë teknikave speciale teleskopike të afta të dallojnë dritën e dobët të planetëve nga ajo pakëz më e fortë e “yjeve të tyre të referimit”.

3. «Katalogu» i gjeneve tumorale

Në vend të tretë, edhe pse që këtu e poshtë nuk flitet për një klasifikim të vërtetë por vetëm për një listë, nënvizon revista, ndodhet “katalogu” i zgjeruar i gjeneve të pranishëm në tumoret. Midis këtyre mund të përmenden ata që lidhen me glioblastomën dhe tumorin pankreatik.

4. Superpërçuesit e rinj

Më 2008 u zbuluan materiale të reja me bazë hekuri të aftë të përçojnë elektricitetin pa rezistencë dhe në temperatura shumë të larta.

5. Proteinat në punë

Këtë vit kërkuesit kanë patur shumë surpriza gjatë vëzhgimit të proteinave gjatë “orarit të tyre të punës” d.m.th. kur lidhen me receptorët e qelizave dhe modifikojnë gjendjen metabolike, duke kontribuar kështu në përcaktimin e karakteristikave të indeve.

6. Energjitë e ripërtëritshme

Këtë vit u njoh edhe rëndësia e teknikave të reja për magazinimin e tepriçave të energjisë elektrike të prodhuar nga panelet solare apo nga centralet eolike (të erës).

7. Embrionet në formim

Imazhe të mahnitshme erdhën nga filmime të detajuara si asnjëherë më parë, mbi zhvillimin embrional. U bë i mundur regjistrimi dhe analizimi i formimit të një kafshe që përdoret shpesh në laboratorët e kërkimit, peshku zebër, nga dita e parë pas konceptimit deri në kompletimin e krejt organizmit.

8. Dhjami “i mirë”

Në luftën kundër mbipeshës, një progres të dukshëm mund të përfaqësojnë njohuritë e reja mbi karakteristikat dhe funksionin e të ashtuquajturit “dhjami i mirë”, i njohur ndryshe edhe “dhjami i bardhë”.

9. Masa protonike

Hapa përpara janë kryer edhe në modelet matematikore për të parashikuar me saktësi masën e neutroneve dhe protoneve.

10. «Festivali» i gjenomës

Progrese u bënë edhe në fushën e vargëzimit të gjenomave: nga ajo e mamuthëve deri tek pacientët me tumor. Teknikat janë bërë gjithnjë e më të shpejta në krahasim me atë për vargëzimin e gjenomës së parë humane.

Tre libra të bibliotekës kastriotase në përqasje me heraldikën shqiptare

Është e njohur se deri më sot, janë specifikuar fizikisht pesë objekte personale të Heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skenderbeut, ndër të cilat prof. Kristo Frashëri veçon katër prej tyre, “dy shpata, një përkrenare dhe një libër uratash”¹, kurse kohët e fundit, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë mori nga Biblioteka e Vajmarit në Vjenë edhe një kopje të plotë të “Codex Scanderbegus”, i njohur ndryshe si “Libri i Skënderbeut.”

Para disa muajsh, duke u mbështetur në zbulimin e madh të vitit 1972 të Robert G. Calkins, Profesor i Historisë së Artit Mesjetar i Universitetit Cornell të Itakës në Amerikë, nëpërmjet artikullit “Një kryevepër e Petrarkës në bibliotekën kastriotase”², ne i kemi bërë të ditur për herë të parë publikut shqiptar se një emblemë kastriotase ndodhej e përfaqësuar dy herë në kryeveprën lirike të poetit të madh italian Françesko Petrarka “Trionfi del clarissimo – Canzoniere-sonete”, që ndodhet në fondet e Bibliotekës së mirënjohur të Universitetit Cornell që nga viti 1902, kataloguar me numër MS. 4648 n. 24 +. Shkruar në italisht, ky kodik ka në përbërje të tij 39 fletë nga vepra “Trionfi”, 143 fletë nga vepra “Canzoni” dhe 6 fletë Indeks. Sipas studiuesve Fowler, Ricci, Wilkins, Willman, Calkins etj. vepra është e ilustruar nga iluminatori i mirënjohur florentinas Francesco d’Antonio de Cherico (1433-1488)³, ndërsa skribi i saj është Nicolous Riccine. Parashtronim me këtë rast në artikull analizën dhe konkluzionin e Profesor Calkins përse ky libër i Petrarkës në formë kodiku duhet të ketë qenë me siguri në zotërim të Skënderbeut”⁴.

¹ Kristo Frashëri, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 258.

² “Koha Jonë”, 21 janar 2007.

³ Ky ilustrator mbante lidhje të ngushta me familjen e njohur italiane Medicis, Dukën e Urbinos dhe Alfonsin V; ndër punimet e tij më të bukura mbahen Libri i Petrarkës “Trionfi -Canzoni-sonete”, “Urbino-Bible” ose Bibla e Federico Da Montefeltro, “Codice Trivulziano”, libra të Tit Livit, Virgilit, etj.

⁴ “The Cornell Library Journal”, Medieval and Renaissance Illuminated Manuscript in the Cornell University Library, Foreword to the 1972, Catalog by Robert G. Calkins, revised 2003; 42. Petrarca. Trionfi, Canzoniere Italy (Florence), 1465-70 Rare Bd. MS. 4648 no. 24+

Në këtë kumtesë, duke e thelluar më tej analizën tonë lidhur me këtë zbulim të fundit, që përbën, të themi, objektin e gjashtë dhe librin e tretë të njohur deri më sot nga biblioteka kastriotase, do të përqëndrohemi në tre drejtime kryesore:

Së pari, lidhja organike e emblemës së “Librit të Uratave” me dy emblemat e “Librit të Petrarkës” dhe përqasja e tyre me heraldikën shqiptare ;

Së dyti, zanafilla apo koha e realizimit të këtyre librave në rrethanat historike, politike e diplomatike të lidhjeve të brendshme e të jashtme të Skënderbeut me feudalët vendas nga njëra anë dhe me papatin, Alfonsin V dhe mbretin Ferdinand nga ana tjetër ;

Së treti, figura e Skënderbeut si burrë shteti, intelektual, erudit, largpamës e humanist, roli i tij i gjithfuqishëm në rrafsh shqiptar e evropian.

Shpesh është vënë në dukje se pas vdekjes të kryetrimt shqiptar vlerën e të cilit Volteri e sintetizoi me një fjali të vetme lapidar se “Po të kishin qenë Skënderbej perandorët grekë, Perandoria e Orientit do të ish ruajtur”⁵ – Donika Kastrioti dhe i biri Gjoni morën me vete kur mërguan në Itali objekte personale të Heroit e të familjes. Kështu, Prof. Shuteriqi ka argumentuar tezën e një letërsie paraosmane, madje në gjuhën shqipe, që ka mërguar në Itali pas vdekjes së Skënderbeut dhe pas rënies së Krujës e Shkodrës⁶. “Librat e tyre të shërbesave, nënvizon ai [arbëreshët] i sollën nga atdheu”⁷. Nga ana tjetër, është po aq e njohur që mbreti Ferdinand, me vdekjen e Skënderbeut, nisi menjëherë një të dërguar të posaçëm tek e veja dhe i biri, Gjoni, me një letër të datuar më 24 shkurt 1468, ku u shprehte tërë miqësinë dhe sigurimet e veta për pritjen që do t’u bëhej atyre në tokat napolitane, si feude në pronësi të tyre⁸. Nuk kemi hasur të dhëna konkrete për

⁵ Volter, “Sprovè mbi historinë e përgjithshme dhe mbi doket e frymën e kombeve, që prej Karlit të Madh gjer në ditët tona”, Kreu 77, Paris, 1756.

⁶ Dh.S. Shuteriqi, “Mbi Barletin dhe shkrime të tjera”, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1979, f. 26-32.

⁷ Ibid. f. 27.

⁸ Fan Noli, “Vepra 3, Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Bot. Dudaj,

mërgimin e Donikës me të birin në Itali, veçse Gjon Muzaka, besnik gjer në fund i Skënderbeut dhe ndër princat shqiptarë i larguar i fundit nga atdheu i pushtuar (1479), jep në “Memorjen” e vet të vitit 1510 një fakt mjaft interesant për këtë largim: Donika dhe Gjoni tepër i ri u larguan shoqëruar nga dy motrat e Gjon Muzakës, edhe ato të veja, me burra të vrarë në luftë, nga fëmijët e tyre të vegjël dhe nga “zonja të tjera të nderuara”⁹. Pra ikja e saj duhet të jetë bërë e organizuar, me shpurë të posaçme dhe me siguri me anije të posaçme dërguar nga mbreti Ferrante. Në këtë rast, domosdo janë marrë me vete nga Andronika dhe zonjat e larta të Arbërit edhe tërë objektet e vyera të familjeve princërore, e ndër to pajimet personale të Heroit, kancelaria e tij dhe sidomos librat apo manuskriptet në pergamen që konsideroheshin tepër të vyer e të rallë për kohën.

1. Le të ndalemi fillimisht tek dy librat, “Libri i Uratave” dhe “Libri i Petrarkës”

Herë pas here, në media, është folur për “Librin e Uratave”, kryesisht shkrime publicistike nga Dr. Zeqo dhe Prof. Frashëri, i cili, në studimin e vet madhor “Skënderbeu – Jeta dhe vepra” pranon nëpërmjet një shënimi, se nuk e ka parë tërë veprën, por “se kemi në dorë, thotë ai, vetëm fotokopjen e faqes së parë”¹⁰. Po ashtu, edhe Dr. Zeqo, me gjithë përpjekjet e tij të një hulumtuesi serioz, shpreh keqardhjen që “Askush deri më sot nuk e ka shfletuar dhe nuk ka vjelë informacionin e duhur për këtë libër të çuditshëm që titullohet në latinisht OFFICIUM BEATAE MARIAE VIRGINIS.”¹¹

Në fakt, është botuar në shtypin shqiptar me cilësi mjaft të dobët (fotokopje që nuk të lejon studim të thelluar). Faqja që përmban emblemën kastriotase, p.sh. tek vepra e shquar e Gjin Varfit “Heraldika shqiptare”¹², apo tek libri tashmë i përmendur i prof. Frashërit¹³.

Duke hulumtuar për “Librin e Uratave”, vumë re se katalogimit dhe studimit të këtij thesari i kushtohet një vend i veçantë në veprën “Manuskriptet italiane të bibliotekës së Major J.R. Abbey”¹⁴, hartuar nga profesorët e nderuar britanikë të emblemave dhe të arkitekturës mesjetare J.J.G. Alexander dhe A.C. de la Mare të Universitetit të Manchesterit. Në studi-



min e tyre jepen të dhëna të plota për historikun dhe përmbajtjen e veprës,¹⁵ ilustruar nga faqja e plotë që përmban emblemën e Kastriotasve, veçse për fat të keq vetëm në bardhë e zi. Duke shpresuar se së shpejti mund të kemi edhe variantin original me ngjyra, po japim këtu faqen

që përmban emblemën e numerizuar. Vëmë re në këtë faqe edhe një portret, që nuk ka të bëjë aspak me ndonjë portret të hamendësuar të Skënderbeut, sikundër është shprehur mendimi në ndonjë shkrim, por thjesht kemi të bëjmë me një medalion të Krishtit, me kurorën e vet mbi krye, me gjakosjen në ballë dhe mjekrën e tij karakteristike. Për më tepër që faqja 13 ku ndodhet emblema (dhe jo kopertina e librit, apo faqja e parë sikundër është thënë)¹⁶, i përkushtohet lutjes së mëngjesit për Virgjëreshën Mari, duke filluar madje me një ilustrim të gjermës së parë në miniaturë që paraqet Shën Marinë tek mban në krahë birin e Perëndisë.

Çfarë vëmë re në këtë emblemë dhe çfarë të dhënash të sakta kemi për të?

a. Ajo është e përbërë nga dy elementë thelbësorë të lexueshëm qartë: në të djathtë, shqiponja dykrenore me kurora mbretërore dhe me yllin me gjashtë cepa; në të majtë, luani me shpatë dhe me zambakun anzuin përsipër.

¹⁵ Lidhur me autorësinë e veprës, Prof. Aleksander shkruan: “Stili i iluminimit është napolitan. Ka ngjashmëri me miniaturën e vizatuar flamande, ndikimi i së cilës ndoshta është me prejardhje nga Spanja dhe jo drejtpërdrejt. Miniaturat janë të një cilësie të paarrtshme dhe me siguri vijnë nga ndonjë artist i madh (fletët 13 – ku është emblema, 85 dhe 135) dhe punishtja e tij. Dora e artistit kryesor mund të rinjohet nëpërmjet manualit të Urdhrit të Shën Martës... Artistët tanë kanë pikturuar në fletën 25 në hyrje të tekstit Xhovanën e parë të Aragonës dhe Pascasio Diazgarlon, Kontin e Alifit. Asnjë nuk është datuar për fat të keq, por Filangeri shpreh mendimin se nuk duhet të jetë më pas nga martesja e mbretit Ferdinandi i parë më 1477. Nuk mund të thuhet me siguri kush është autori i saj, veçse nga stili mund të fletet për Matteo Felice-n.”

¹⁶ Në përshkrimin që i bën kodikut, Prof. Alexander thekson se vërtet mbulesa e lëkurtë e dorëshkrimit përmban emblemën e Kontëve Di Capua, por kjo emblemë është e shekullit XVIII, ndërkohë që vetë dorëshkrimi ka pasur riqepje e rregullime të mëvonshme e të herëpashërshme.

Tiranë, 2004, f. 122-123.

⁹ Gjon Muzaka, “Memorje”, Botimet Toena, Tiranë, 1996, f.21.

¹⁰ *Vepër e cituar*, f. 211.

¹¹ Moikom Zeqo, “Gjergj Kastriot Skënderbeu në rrafshin e një intelektual vizionar”, Koha Jonë, 1 shtator 2005.

¹² Gjin Varfi, “Heraldika shqiptare”, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë, 2000, f. 32.

¹³ K. Frashëri, *Vepër e cit.*, f.214, 261.

¹⁴ J.J.G. Alexander and A.C. De La Mare, “The italian manuscript in the library of Major J.R. Abbey”; *Libri i Uratave*, 32, J.A. 3199, (Plates XXXVII-XIa).

b. Si shqiponja, ashtu dhe luani kanë kompozim vertikal, dhe shqiponja në këtë rast është e trupëzuar¹⁷, gjë që do të thotë se paraqitet disi e ndryshme në formë nga shqiponja e vulës së madhe të Skënderbeut me krahë të shpalosura për së gjeri.

c. Duke patur parasysh domethënien e thellë të emblemave, rregullat e qarta e të prera në heraldikë dhe në emblematikë, vëmë në dukje se nuk kemi të bëjmë aspak këtu me një dekor të thjeshtë të “Librit të Uratave”, por me një emblemë të shenjtë, konkretisht me emblemën kastriotase, gjë që vërtetohet nga tetë engjëj mbrojtës, pa krahë, por me kryq në qafë, dy nga të cilët mbajnë vetë emblemën dhe mbështeten në brirët e bollëkut apo brirët e mbushur (*cornucopias*). Ja përshkrimi që i bën konkretisht emblemës Prof. Alexander: “Në fletën n. 13 është emblema, në krahun e djathtë, paraqitur në të zbehtë, ndodhet një shqiponjë me dy krerë dhe kurora të errëta përsipër dhe mbi të një yll me gjashtë cepa i argjendë mbi fushë të kaltër; në krahun e majtë është një luan ngjyrë ari në këmbë, duke mbajtur një shpatë të argjendë dhe shoqëruar nga një zambak përsipër. Është stema e Kastriotëve që përfaqëson Shqipërinë... Pas vdekjes së Gjergjit më 1468, Andronika Komnena dhe i biri u thirrën në Napoli nga mbreti Ferrante. “Uratat” u kaluan më pas në përdorim françeskan (dëshmojnë kalendari dhe e.g. fleta 142), ndërsa emrat e zotëruesve të ndryshëm lutësorë janë fshirë me bojë të bardhë, duke lënë gjurmë hapësirash.”¹⁸

d. Nga tërë prezantimi që i bën emblemës Prof. J.J.G. Alexander, mbështetur në punimet e De Marinis, del se “Libri i Uratave” nuk i është dhënë dhuratë familjes Kastriotase nga dy familjet napolitane Di Capua dhe Altavilla, sikundër është hamendësuar dhe propaganduar gjer më sot në mediat dhe studimet shqiptare, por se “Nga viti 1544, apo ndoshta pak më parë, manuskripti ka qenë në zotërim të familjes së kontëve Capua dhe Altavilla”¹⁹, dhe se një gjë e tillë vërtetohet nga shënimet në fletët 203-214, që përbëjnë pjesën shtojcë të manuskriptit original, ku datat e lindjes së pinjollëve të këtyre dy familjeve të shquara napolitane që bënë krushqi të shumta me nipër e mbesa kastriotase, shoqërohen në këtë shtojcë me emblemat e ndryshme të familjeve Capua, Altavilla, Orsini, Margherita Ruffo-s, princshës së Silës apo gruas së D.J. Fabricio di Capua-s, etj.

e. Edhe pse studiuesit britanikë shprehin mendimin që dorëshkrimi në pergamen i “Librit të Uratave” duhet të ketë qenë me siguri pronë e Skënderbeut apo birit të tij Gjonit, përsëri ata e datojnë këtë manuskrit rreth vitit 1480, kurse profesor Frashëri e daton rreth dimrit të viteve 1466-1467,



kur Skënderbeu shkoi për vizitë në Napoli. Por, theksojmë nga ana jonë se na duket tepër me vend dhe tepër me interes informacioni që jep lidhur me këtë çështje studiuesi Gjini Varfi, i cili, mbështetur në analizën e studiuesit Mallaj, vë në dukje se emblema “u punua për t’iu dhuruar Skënderbeut nga Alfonsi V i Aragonës dhe i Napolit” dhe se “Viti i punimit dhe i dhurimit të këtij libri duhet të lidhet me vitin 1451”²⁰, kur në Gaeta u nënshkrua Traktati i mirënjohur dypalësh midis përfaqësuesve të Gjergj Kastriotit dhe mbretit Alfons të Arragonës, Sicilisë e Napolit.

Se ç’përfaqësojnë konkretisht këto simbole të emblemës, shqiponja dykrerëshe me yllin me gjashtë cepa dhe luani është folur mjaft dhe kemi të dhëna interesante edhe nën penën e prof. Dhimitri Pilikës, që i sheh këto simbole me zanafillë dhe traditë të hershme shqiptare²¹, për të shprehur sovranitet dhe histori të lavdishme të kombit shqiptar që nga lashtësia, me Pirron e Epirit dhe me Aleksandrin e Madh të Maqedonisë. Por ajo çka duam të nënvizojmë këtu është se pikërisht, nëpërmjet këtyre simboleve, në unitetin e tyre të plotë, gjen mishërim teza e aleancave të ngushta familjare, politike, ushtarake dhe ekonomike e familjeve aristokratike shqiptare, dhe konkretisht “përpyqjet e Skënderbeut për t’u paraqitur si trashëgimtar i ligjshëm i zotërimeve të Topiajve e të Balshajve”, duke i shtuar për këtë gjë, siç thuhet në historiografinë shqiptare, “emblemës së familjes [së tij] edhe simbolet e këtyre dy familjeve, luanin dhe yllin”²² (*nënvizimi ynë, F.A. e D.M.*).

Le të shohim tani konkretisht dy emblemat në “Librin e Petrarkës”, mjerisht cunguar nga koha apo herezia kulturore,

²⁰ Gjini Varfi, *Vepër e cituar*, f. 32.

²¹ Dhimitri Pilika, “Pellazgët, origjina jonë e mohuar”, Botimet Enciklopedike, Tiranë 2005, f.63-95, 236

²² Akademi e Shkencave të Shqipërisë, *Histori e popullit shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2002, f. 333.

¹⁷ K. Frashëri, *Vepër e cituar*, f. 210.

¹⁸ J.J.G. Alexander and A.C. De La Mare, *Vepër e cituar*, f. 88-89.

¹⁹ *Idem*.

ku vetëm prania e të njëjtit luan (si te “Libri i Uratave”), në të njëjtin pozicion, me shpatë në dorë dhe me zambakun anzuin përsipër, paralajmëron praninë e dikurshme të shqiptarëve dykrenore kastriotase, viktimizuar, do thonim, historikisht, në mënyrë të qëllimshme.



Faqa A



Faqa B

Sikurse vihet re, kemi dy emblema në dy faqe të ndryshme të kodikut, që çelin në fakt dy libra më vete të Petrarkës përmbledhur në një: librin “Trionfi”, nga njëra anë (përfaqësuar nga emblema e faqes A), dhe librin “Canzoniere”, pjesë të zgjedhura, nga ana tjetër (përfaqësuar nga emblema e faqes B). Pra është fjala për një lloj antologjie hartuar enkas për zotëruesin që do merrte në dorë manuskriptin dhe që pasqyronte dy herë me radhë emblemën e familjes së tij.²³


Nisur nga përfaqësja e këtyre dy emblemave me emblemën e “Librit të Uratave”, prof. Calkins, vetëm më 1972 hodhi tezën se ky kodik duhet të ketë qenë në zotërim të Skënderbeut apo të birit të tij Gjonit, ndonëse përshkrimin e këtij kodiku ai e kishte bërë që në vitin 1968.

Faqa B është më e lexueshme për syrin në vendin e dëmtuar, ku duhet të ketë qenë shqiptonja në krahun e djathtë, sepse jo vetëm ka fushën trekëndore në ngjyrë të kaltër, por dallohen në të edhe tre majat e yllit të artë me gjashtë cepa (simbolit të yllit aleksandrin), që ne e kemi pagëzuar si “majën e ajsbergut që fsheh në vetvete shqiptonjën dykrenore kastriotase”²⁴, së cilës i dallohen qartë gjurmët e zeza. Edhe te faqa A, në të njëjtin vend të fushës trekëndore të yllit kemi gjurmë të kaltër. Ç’mund të themi për simbolin e luanit, duke qenë se vetëm këtë kemi këtu të pranishëm dhe

çfarë të dhënash konkrete kemi për këto emblema kastriotase të librit të Petrarkës?

a. Në bazë të rregullave të heraldikës, simbolin e luanit me shpatë në dorë, në qëndrimin ngritur në këmbë, dhe me zambakun anzuin përsipër, e hasim vetëm në heraldikën shqiptare, konkretisht te Muzakajt, Topiajt e Kastriotët²⁵, dhe askund tjetër në heraldikën evropiane, ku simboli i luanit është vërtet i gjithpranishëm, por në pozicione krejt të ndryshme, me apo pa shpatë.

b. Për herë të parë në heraldikën shqiptare, e ndeshim këtë simbol tek emblema e Muzakajve, që iu njoh despotit Andrea II Muzaka nga perandori i Konstandinopojës, Johani V Paleologu.²⁶



Emblema e Muzakajve

c. Kjo emblemë kastriotase, me tërë elementët e vet përbërës, na shfaqet edhe dy herë të tjera shumë vite pas vdekjes së Heroit dhe larg truallit kombëtar, konkretisht në monumentin që Isabela Kastrioti i ngriti të shoqit Guido Ferramosco në Montecassino dhe në varrin e një pasardhësi të Skënderbeut në vijë

femërore, Giuseppe Felice Kastriotit në Leçe të Puljes (Itali)²⁷. Nga përshkrimi që u bën Dr. Zeqo këtyre emblemave, del se ka përputhje të plotë, deri edhe në ngjyra, midis atyre emblemave dhe emblemave të “Librit të Petrarkës” e “Librit të Uratave”. Nuk kemi të bëjmë aspak, në këtë rast, me variante të ndryshme, sikurse është thënë gjer më sot, por me një vijimësi embleme kastriotase që simbolizonte në vetvete aleancat e brendshme me familjet fisnike shqiptare, vetë synimin e Skënderbeut për “aneksim” apo bashkim të feudeve të ndryshme të Shqipërisë. Kohët e fundit, është folur edhe për një zbulim në Galantina të Italisë të një embleme kastriotase me shqiptonjën dykrenore, dy luanë dhe kryqin e Jeruzalemit, që flitet se i përket Gjon Kastriotit të riut²⁸. Mendojmë se do të ishte me mjaft interes

²³ Gjin Varfi, *vepër e cituar*, f. 101, 103, 105.

²⁴ *Ibid.* f. 50. Studiuesi Jaho Braha na shprehu në Tiranë mendimin se një emblemë e tillë, në bazë të një të dhënë të fundit, (stemë e zbuluar në fasadën e një godine në rajonin e Napolit) mund të ketë qenë e familjes fisnike shqiptare Atriballa-Kastrioti (Triballa-Kastrioti), duke e parë këtë emblemë të lidhur me figurën e Vrana Kontit, që siç dihet, ka qenë në aleancë të hershme dhe me lidhje krushqërore me Kastriotët.

²⁷ M. Zeqo, “Dy dimensionaliteti i Skënderbeut, rilindas evropian”, gazeta *Ballkan*, 8 dhjetor 2006.

²⁸ Sipas pohimeve të Alessandro Castriota Skanderbeg mbështetur në shënimet e Pietro Cavotit, të ruajtura pranë bibliotekës së qytetit

²³ Në Manchester, konkretisht në Muzeun Fitzwilliam, ndodhen pjesa më e madhe e botimeve të Petrarkës, 80 nga 150, në formë kodiku, të gjitha realizuar gjatë shekullit XV, duke bërë kështu të njihet një “boom” i vërtetë në përhapjen e veprës së kryepoetit italian. Ilustrimet e bukura të kodikëve të tij nuk janë më në stilin mesjetar, sepse shkrimi, inicialet e historizuara, dekorat, emblemat dhe gjithçka tjetër pasqyrojnë një stil të ri të Rilindjes.

²⁴ Fotaq Andrea e Dritan Muka, “Një kryevepër e Petrarkës në bibliotekën kastriotase”, *Koha Jonë*, 21 janar 2007.

një përfaqje e ardhme e tërë këtyre emblemave, ku krahas shqipnjës së zezë dykrenore, gjendet edhe simboli i luanit.

Për “Librin e Skënderbeut”, i njohur ndryshe si “Libri i mrekullive” apo “Libri i inxhenjerisë”, që ndodhet në Bibliotekën e Vajmarit në Vienë, është folur në media kohët e fundit, sidomos pas ardhjes së tij në formë të numerizuar në Muzeun Historik Kombëtar, me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Dr. Zeqos. Disa karakteristika të tij për t’u veçuar :

i. Është një enciklopedi në pergamen, vepër e rrallë për kohën, që nuk përmban asnjë shenjë dalluese apo emblemë që të ketë lidhje me Kastriotët, veçse është pagëzuar, të themi, si “Libri i Skënderbeut” në bazë të historikut të tij me prejardhje nga Shqipëria dhe konkretisht nga biblioteka e Kastriotasve apo e Skënderbeut.

ii. Në prezantimin më të hershëm që i bëhet këtij libri për publikun francez, më 1833, sikurse edhe nga të dhënat që jep historiani Cantu cituar nga Prof. Jup Kastrati, vihet në dukje se “manuskripti mendohet se i është bërë dhuratë Gjergj Kastriotit, mbretit të Shqipërisë, nga Ferdinandi i Aragonës”²⁹, ndërkohë që Dr. Zeqo është i mendimit se libri nuk mund të ketë qenë pronë e Ferdinand katolikut, i cili u shpall mbret më 1468, pak para vdekjes së Skënderbeut, por se libri ka qenë pjesë e bibliotekës së atit të tij, Alfonsit të Aragonës, i cili duhet t’ia ketë dhuruar Skënderbeut në vitin 1456, kur Heroi ka shkuar në Napoli³⁰.

iii. Duke pasur parasysh vetë përmbajtjen e veprës, ku përfshihen arritjet më të mëdha të kohës, sidomos në fushën e artit ushtarak, me mjetet dhe armët më të sofistikuar, bombardat, hedhësat, dyfeqet e parë, etj., teza e Dr. Zeqos duket më e argumentuar për vetë faktin se mbi të gjitha kjo vepër kishte karakter utilitar, që i shërbente një udhëheqësi ushtarak të rangut të Skënderbeut për të njohur strategjinë dhe taktikat moderne të luftës, ashtu sikurse kishte karakter të theksuar utilitar edhe vetë “Libri i Uratave” për shërbesat fetare në Krujë e gjetkë.

2. Zanafilla dhe koha e realizimit të këtyre librave

Profesorët Pollo dhe Puto kanë vënë në dukje, në bazë të të dhënave të historianit venecian Donado da Lezze të shekullit XV, se lidhjet e Skënderbeut me Alfonsin V për përgatitjet e kthimit të tij historik në Krujë, kanë qenë mjaft të hershme, që më 1440³¹, e në këtë rast mund të flitet, pse jo, edhe për fillimin e lidhjeve të Skënderbeut me Kont Uranin, komandantin legjendar të Krujës, që shërbente fillimisht në ushtrinë e

të Galatinës.

²⁹ “Le magazin pittoresque”, Paris 1833.

³⁰ M. Zeqo, “Libri i Skënderbeut në Vajmar”.

³¹ Stefanaq Pollo e Arben Puto, “Histoire d’Albanie, dès origines à nos jours”, ed. Horvath, Paris 1974, f.82.



Libri i Skënderbeut sipas Magazin Pittoresque, 1833.

Alfonsit, ku dhe meritoi titullin kont. Një aleancë e fuqishme e Alfonsit me Skënderbeun u sanksionua, siç dihet, me Traktatin e Gaetës në mars 1451, pikërisht një muaj pas ardhjes në fuqi të sulltan Mehmetit, i cili konsiderohej tepër i egër dhe i vendosur në synimet e veta, madje edhe vetë Konstandinopoja shumë shpejt do binte nën sundimin e tij.

Alfonsi V, sovran i ndritur, për të cilin Noli nuk i kursen lavdet e veta dhe që u lidh me Skënderbeun me miqësi të fuqishme, njihet nga ana tjetër si mik i ngushtë i librit, dhe është mbiquajtur “Bujari” tek mbronte njerëzit e letrave, artit dhe shkencës, që mbushnin oborrin e tij. Pëlqente mbi të gjitha, thekson Francione, veprat e historisë, dhe siç tregojnë për të, më shumë do kish parapëlqyer humbjen e çfarëdo gjëje, veç jo të një libri.³² Ky sovran i ndritur ka pasur lidhje kontraktuale me ilustratorin e mirënjohur të “Librit të Petrarkës” Antonio del Cherico, tek i cili porosiste kodikë të autorëve të shquar. Dëshmojnë për këtë një numër dorëshkrimesh bankare që paraqesin tratativat e disa artistëve ilustratorë te mesit të shek. XV me blerësit e tyre, ku na del edhe një fakt mjaft domethënës: një marrëveshje e Alfonsit V me Chericon, datuar më 1454-55, ndonëse në to flitet për një pagesë që po bëhej për tre vëllime të Tit Livit dhe jo për libra të Petrarkës³³.

³² G. Pallota, “Scanderbeg”, vepër e cituar nga G. Francione, *Skënderbeu një hero modern*, N. Frashëri 2006, f. 95.

³³ Francis Ames-Lewis, “The Earliest Documented Manuscript Decoration by Francesco d’Antonio del Cherico”.

Përgjithësisht studiuesit amerikanë të “Librit të Petrarkës” e datojnë këtë manuskript në vitet 1465-1470, pra më herët nga vitet 1480, kur studiuesit britanikë kanë datuar “Librin e Uratave”, ndërkohë që, siç e vumë re, ky manuskript i fundit mund t’i jetë dhuruar Gjergj Kastriotit në vitin 1451, me rastin e Traktatit të Gaetës. Për mendimin tonë ka shumë të ngjarë që edhe “Libri i Petrarkës” t’i jetë dhuruar Heroit nga Alfonsi V në një nga vajtje-ardhjet e tij të shpeshta në vitet 1454-1466, periudhë kur Cherico, shkëlqeu në vepërimitarinë e tij ilustrative, duke u mbiquajtur madje edhe “miniatori”³⁴. Dy fakte kuptimplota përse Libri i Petrarkës duhet t’i jetë dhuruar Skënderbeut nga Alfonsi V :

a. i njëjti Cherico i “Librit të Petrarkës” me dy emblemat kastriotase na shfaqet ilustrator i librit “Jeta e Karlit të Madh”, dhuruar mbretit francez Luigji XI më 1461, duke pasur në hyrje të tij pikërisht emblemën e këtij mbreti;

b. punimet e Cherico-s përmbajnë elementë dekorativë dhe një numër të madh emblemash rrethuar nga kurora që afrohen shumë, në stil e në ngjyra, me veprën e autorit Eusebius (Eusebius Pamphili), kodikë që përbëjnë fondin e Bibliotekës së Mattia Korvinos (Corvinusit), birit të Huniadit të madh dhe mikut e bashkëpunëtorit të Skënderbeut në luftën e përbashkët kundër sundimtarëve osmanë. Prof. Ilona Berkovitz e Akademisë hungareze të Shkencave ka argumentuar se ky fond i Corvinusit i përket pikërisht viteve 1460-70³⁵.

Rrjedhimisht, nuk ka pse mos pranohet që kodikët me emblemat kastriotase i janë dhuruar Heroit, gjatë kohës sa ai ka qenë gjallë, dhe për më tepër, kjo të lë të hamendësosh se fare mirë Heroi apo pjesëtarë e bashkëpunëtorë të familjes së tij, si Pal Engjëlli me shokë, mund të kenë qenë edhe vetë porositës të drejtpërdrejtë kodikësh tek skribët e ilustratorët e shumtë që përgatisnin manuskriptet në Itali e gjatë.

3. Figura e Skënderbeut si burrë shteti, intelektual, erudit, largpamës e humanist

Tre librat e analizuara sa më sipër flasin pamëdyshje për gjurmët dhe ekzistencën e një biblioteke Kastriotase, - ndoshta nga më të pasurat, ashtu siç duhej t’i kish hije një

sovrani të denjë e me emër të kohës³⁶ –, krahas një kancelarie të fuqishme, një diplomacie të zhdërvjelltë, një politike të brendshme e të jashtme përherë ngadhënjese e progresiste. Për rrjedhojë, edhe vetë portreti i Skënderbeut, “mikut të virtytit”, siç shkruan ai për veten në një letër të tij, do pasqyrojë, domosdo, atë të intelektualit, eruditit e humanistit, si njohës i mirë i disa gjuhëve të huaja, me kulturë të gjerë e me njohuri të thella për historinë e lashtë, e para së gjithash për historinë e kombit të tij.

Si kryetar shteti, thekson prof. Frashëri, Skënderbeu ndihmohej nga një Këshill, dhe fillimisht vepronte në emër të Besëlidhjes, por më vonë me shturjen e saj, ai krijon një Këshill të ri, me anëtarë laikë e klerikë, si Gjergj Arianiti, kont Urani, Vladan Gjuriç, Hamza Kastrioti, Zakaria Gropa, Gjergj Balsha, Pal Engjëlli, Dhimitër Frëngu, Gjergj Pellini³⁷, etj. Po ashtu, në pozitën e tij të sovranit, të Dominus Albaniae, ai shpallte vendime, caktonte taksa, komandonte ushtrinë, emëronte ambasadorë dhe lidhte marrëveshje politike me sovranë të shteteve të tjera. Krahas Këshillit administrativ, vepronte edhe Këshilli i Luftës, i përbërë nga kapedanë të njohur, nga burra të shquar në fushën e artit ushtarak dhe bashkëpunëtorë të ngushtë të Skënderbeut. Prof. Frashëri ndalet po ashtu në kancelarinë e Skënderbeut, e trashëguar nga i ati i tij, Gjoni, por me një frymëmarrje më të gjerë, dhe me një rreze veprimi ndërkombëtar të hapur e me frekuencë të lartë. Dëshmojnë për këtë oratorët dhe ambasadorët e tij, rezultatet që ai arriti falë veprimtarisë së suksesshme të personaliteteve të tilla të mirënjohura si Gjergj Pellini, Pal Gazuli, Pal Engjëlli, Gjon Gazuli, etj. Aktet zyrtare dhe aktet diplomatike, Skënderbeu i pajiste me vulë të ndryshme nga ajo që përdorte në aktet financiare. Vula e madhe, siç dihet, ka vetëm shqiponjën dykrenore dhe yllin me gjashtë cepa, si dhe inicialet D (*dominus*) dhe Al (*Albaniae*), ashtu sikurse edhe flamuri, që kishte vetëm shqiponjën e zezë dykrenore me yllin biblik mbi fushë të kuqe, të cilën na e përshkruajnë Barleti dhe Muzaka³⁸. Në studimin tonë, ne u përpoqëm të argumentojmë se Heroi ka përdorur edhe simbolin e luanit e të zambakut anzuin në emblemën e familjes së tij kastriotase, krahas simbolit zyrtar të shqiponjës dykrenore e yllit, përfaqësuar konkretisht nga vula e tij zyrtare dhe flamuri, në emër të aleancave, qoftë të brendshme, qoftë të jashtme.

Lidhur me portretin e Skënderbeut, Montenji, filozofi

³⁴ Një tjetër libër i Petrarkës “Triumfi i jetës”, me nr. MS 438, ff. 2v-3r, ilustruar nga Cherico dhe datuar në vitet 1450-1460 ndodhet në Yale University Beinecke Rare Book and Manuscript Library, ku emblema rrethuar nga kurora dhe dekor mjaft i bukur është fshirë tërësisht, duke lënë një njollë të bardhë, ndërkohë që kodiku i Petrarkës “Triumfi” MS. Montagu e. 1. nr. 25403, që ndodhet në Bodleian Library U of Oxford është datuar edhe ai në çerekun e tretë të shek. XV me një emblemë të veçantë. Të gjitha këto libra të Petrarkës dëshmojnë për faktin që kanë qenë të porositur nga blerësit e tyre kryesisht në vitet 1450-1470.

³⁵ Ilona Berkovits, “Illuminated Manuscripts from the library of Matthias Corvinus”.

³⁶ Biblioteka e Luigji XI numëronte në të njëjtën periudhë rreth 800 kodikë, që do të përbënin më pas bërthamën e ardhshme të Bibliotekës Kombëtare të Francës.

³⁷ K. Frashëri, vepër e cituar, f. 191.

³⁸ Po ashtu, në poemën e Longfellow “Skënderbeu”, përkthyer nga Fan Noli, thuhet: *Flamur i Skënderit nërë / Shkabë e zezë me dy krerë*. Fan Noli, Vepër, 3, f. 34.

i madh francez i shek. XVI, e sheh atë si kampion të tolerancës, duke çelur veprën e tij madhore “Ese” me një episod kuptimplotë nga jeta e Heroit, i njohur për shpirtin e tij fisnik, bujar e tolerant. Barleti në këtë drejtim nuk e ka kursyer penën, madje e ka hyjnizuar portretin e tij në tërë aspektet, duke e nxjerrë qëllimisht të gjithmadhërishtëm, siç i ka hije, ndërkohë që Gjon Muzaka apo Dhimitër Frëngu tregohen më të përmbajtur e realistë, ashtu sikurse Noli shekuj më pas, që na e ka dhënë portretin e tij mjaft njerëzor e progresist.

Ymer Jaka citon Lamartinin dhe Zanoviqin për një portret të zbukuruar të Skënderbeut: Tek Zanoviqi, Skënderbeu tërë kohën e kalonte në beteja, ose pastaj duke lexuar, madje libri i tij i parapëlqyer qenkësh vepra e Jul Cezarit “Komentet”³⁹. Kurse te Lamartini, Skënderbeu, përveç bukurisë fizike e shpirtërore përshkruar me hollësi, dhe gjashtë gjuhëve që dinte, “shkruante vargje dhe këndonte këngë të përcjella nga lira e epirotëve në të gjitha këto gjuhë”.⁴⁰ Në

fakt, sikurse del tek Noli, portreti i Skënderbeut nën penën e romantikut Lamartin përputhet me atë të historianit Falmerajer⁴¹, dhe tejkalohet, kur bëhet fjalë për kohën e lirë të Skënderbeut, që merrej deri edhe me shkrime e lexime, qoftë historike, qoftë lirike. Një dëshmi e tërthortë e kësaj ideje, vërtet joshëse, është edhe vetë Libri i Petrarkës, për të cilin sapo folëm.

E përfundojmë këtu me fjalët e prof. Frashërit, që vë në dukje se “koha kur Skënderbeu trajtohej vetëm si udhëheqës i luftës çlirimtare, strateg i shquar i artit ushtarak dhe mjeshtër i shkëlqyer i fitores së betejave, tashmë duhet të marrë fund. Aspektet e tjera të veprimtarisë së Skënderbeut, si udhëheqës i shtetit shqiptar, si administrator, si legjislator dhe si diplomat, me një fjalë si burrë shteti, janë të domosdoshme për të plotësuar tërësinë e personalitetit të tij historik. Dhe po ashtu, vijon ai, është i domosdoshëm të trajtohet edhe portreti i tij njerëzor e jetësor”.

Edhe në këtë drejtim, tre librat e Skënderbeut plotësojnë sadopak këtë portret jetësor e njerëzor të tij.

³⁹ Ymer Jaka, “Skënderbeu në Historiografinë frënge”, Prishtinë, 2001, f. 133.

⁴⁰ Po aty, f. 266.

⁴¹ Fan Noli, *vepër e cituar*, f. 70-71.

KLIMA NDRYSHON, QYTETËRIMET VUAJNË



Ndryshimet klimatike mund të kenë luajtur një rol vendimtar në rënien e qytetërimeve antike. Kjo hipotezë është formuluar në bazë të një zbulimi të kryer nga disa studiues të Universitetit të Wisconsin-Madison në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Soreq Cave, shpellë shumë e njohur kjo pranë Jeruzalemit e quajtur edhe Stalactite Cave Nature Reserve.

Nëpërmjet analizimit të disa stalagmiteve të gjetura në shpellë u pa se kish ndodhur një ndryshim i papritur klimatik midis vitit 100 para erës sonë dhe vitit 700 të erës sonë. Klima gjatë këtyre shekujve u bë më e thatë dhe çuditërisht përputhet me rrëzimin e perandorisë romane dhe asaj bizantine. Tani studiuesit po hetojnë pikërisht mbi raportin e mundshëm shkak-pasojë. Nëse ky ekuacion do të vërtetohet atëherë ky studim do të botohet në

Quaternary Research Journal, dhe do të hapen spirale të reja interesante mbi ndërlidhjen midis fundit të një qytetërimi dhe transformimeve të klimës.

«Me studimin tonë po kthehemi prapa në kohë vit pas viti për të rindërtuar historinë e kësaj shpelle në shekuj» tregon drejtuesi i grupit kërkimor John Valley nga Universiteti i Wisconsin-Madison. «Në këtë udhëtim në të kaluarën po shohim efektet e ushtruara nga klima e thatë mbi gjeologjinë e zonës dhe ti dallojmë ato nga efektet tipike të klimës së lagësht.

Lloji i analizave që po u bëhet stalagmiteve të shpellës është i ngjashëm me atë që u përdor nga një tjetër grup studimi amerikan për të vërtetuar nivelin e reshjeve dhe ndryshimin e tyre me kalimin e kohës. E reja e grupit të Valley është përdorimi i një instrumenti të komplikuar të quajtur Ion microprobe, i aftë të japë më shumë hollësi lidhur me klimën.

«Objektivi ynë - vazhdon Valley - është përmbledhja në një regjistër të detajuar të gjithë të dhënave për vitet e kaluara. Deri tani kemi arritur në 185 mijë vjet. Të njejtën punë që bëjnë edhe llogaritësit që përpunojnë modelet klimatike». Pra, nga e kaluara e shpellave na vijnë informacione të vlefshme për të ardhmen.

Gara e piramidave



Lindita Komani

lindita.komani@edu.uni-graz.at

si Elie Wiesel, Steven Spielberg, Carl Shapiro, apo fondacione bamirëse si Carl & Ruth Shapiro Family Foundation.

Firma e krijuar prej Madoff në vitin 1960,

Bernard L. Madoff Investment Securities, arriti të ngjitej gradualisht për të merituar në vitin 2000 njohjen si një nga firmat më të suksesshme në SHBA. Vëmendja e fituar dhe besimi që kishin investorët në personin e tij, duket e ndihmuan Madoff që për vite të tëra të arrinte të fshihte të vërtetën e historisë së firmës së tij. Në reagimet e para pas arrestimit ai pretendoi se këtë të vërtetë para rrëzimit të skemës e njihte veç ai dhe dy bashkëpunëtorë, punonjës të lartë të firmës. Në errësirë duket kanë qenë dhe dy djemtë e tij, të cilët ishin denoncuesit e skandalit pranë FBI-së. Në fillim të dhjetorit i ati u kish treguar atyre se për shkak të krizës financiare firma po përballej me probleme likuiditeti. Investorët kërkonin të tërhiqnin 7 miliardë \$ dhe ata duhet të luftonin për t'i mbledhur aq para.

Nga analizat e hetimet e deritanishme jepen disa arsye pse e vërteta e skemës ka mundur kaq gjatë t'i shpëtojë daljes në dritë.

Së pari, në nivelin e marrëdhënies Madoff-klientë, ka rezultuar se Madoff i dërgonte klientëve të vet veç kopje në letër të ecurisë së investimeve të tyre dhe nuk u jepte akses elektronik në platformën ku ai zhvillonte tregtinë. Duke lexuar për një argument të tillë, të shtrohet një pyetje e parë: si është e mundur që kjo sjellje të mos ketë ngjallur dyshim, kur në ditët e sotshme edhe bankat më të vogla ofrojnë akses në internet direkt në llogarinë personale, kontroll dhe kryerje veprimesh transfertash?

Në nivelin e organizmave mbikëqyrëse, siç është psh SEC, ka pasur dobësi ndoshta të shkaktuara nga përqasja që përdor SEC në kontroll. Sipas njohësve të procesit të ekzaminimit të këshilluesve të regjistruar, del se vetëm 10% e këshilluesve të regjistruar në SEC ekzaminohen çdo tre vjet dhe nuk ndodh që këshilluesit e saporegjistruar të kontrollohen që në vitin e parë të punës së tyre. Rasti i një regjistrimi të tillë të von-

Opinion i publik prej vitesh i ndjek zhvillimet e ekonomisë, tregjeve,

ndërmarrjeve edhe nga një këndvështrim që dashur padashur i vë në garë me njëra-tjetrën arritjet, krizat, skandalet. Pyetjet mund të shtrohen në formë deri dhe ironike: A mund të realizohet një shpikje më e rëndësishme se interneti për të revolucionuar më tej botën e biznesit? A do të jetë kriza 2007-20?? më e madhe se Kriza e fundviteve '20? A do të mbeten Enron dhe Worldcom kampionë të skandaleve të mashtrimit në botën e biznesit? Të paktën në rastin e pyetjes më të fundit duket se opinionin po sheh sesi do të tejkalohet një "suksesi i arritur me mund" nga Enron e pikërisht nga ai ai i firmës piramidale të drejtuar nga financieri i mirënjohur Bernard L. Madoff.

Madoff është i njohur në shumë drejtime, si themeluesi më i rëndësishëm i NASDAQ, si manaxheri i suksesshëm i pasurisë të super të pasurve, ofruesi i fitimeve stabile në nivelet 12-13%, apo si filantropi i spitaleve dhe teatrove. Kush zotëronte mjaftueshëm para për të investuar përpikë me çmos që të kthehej në klient të tij. Por ai nuk pranonte gjithkënd. *NY Times* po publikon dhe po zgjeron listën e firmave, fondacioneve dhe individëve, të cilët ishin pranuar (fituar) prej Madoff si klientë dhe në të janë përfshirë emra të mëdhenj, të cilët tani përballen me humbje të mëdha. Nga bota financiare vlejnjë të përmenden emra institucionesh si: HSBC (me humbje prej 1 miliardë \$), BNP Paribas (me humbje prej mbi 470 milionë \$), Banco Santander, Optimal Investment Services (me humbje prej 3,1 miliardë \$), BBVA (me humbje prej 404 milionë \$), më tej gjenden dhe personazhe të njohur

shëm ishte ai i biznesit të këshillimit për investime, të cilin Madoff e regjistroi veç në 2006 dhe ky tani për tani duket të jetë shkaktar thelbësor për fshehjen e të vërtetës së skemës piramidale.

Por bëhet me dije se SEC ka zhvilluar edhe më parë investigime të firmës së Madoff. Qysh në vitin 1992 SEC kishte bërë një kontroll për të shqyrtuar nëse firma ishte një sistem ortek (piramidal) ose jo. Financieri Harry Markopolos, i cili për shumë vite kish punuar në një firmë konkurrenente me firmën e Madoff, kish tërhequr disa herë vëmendjen mbi këtë firmë. Në një letër drejtuar SEC ai shkruante: “Madoff Securities është sistemi më i madh ortek (piramidal) i botës”.

SEC zhvilloi kontrolle edhe në vitin 2005 dhe në vitin 2007, por ato nuk patën ndonjë vlerë, për shkak se sipas Markopolos njerëzit donin t’u besonin premtimeve për fitime.

Një kolumniste e *Bloomberg News*, në një koment të vetin, i cili shpejt e ka gjetur rrugën për në shumë faqe shqiptare në internet, sheh një ngjashmëri të skemës së Madoff me skemat e shumta piramidale në Shqipëri, rrëzimi i të cilave çoi në protesta masive dhe në rrëzimin e qeverisë. Duke iu referuar studimit të ekonomistit të FMN-së, Christopher Jarvis, mbi piramidat shqiptare, kolumnistja shprehet se argumentat që Jarvis paraqiti atëherë mbi psenë e suksesit të skemave në Shqipëri e pikërisht: mungesa e familiaritetit me tregjet financiare, mungesat e sistemit vendor formal financiar, nuk mund të jenë arsye që vlejné për investorët e Madoff.¹ Në po të njëjtin artikull kolumnistja duke iu referuar një interviste të drejtuesit të piramidës më të famshme të Ruisë postkomuniste, MMM, të dhënë pas lirimit nga burgu në 2007, jep një shpjegim të mirë mbi psenë e suksesit të skemave piramidale në perëndim. Sipas drejtuesit të MMM në perëndim (ai i referohej aty konkretisht Belgjikës, sepse për të e për Francën u pyet konkretisht në intervistë) njerëzit nuk janë injorantë e kuptojné më mirë po t’u shpjegosh. Nëse ti jep para, kush është ai që nuk do t’i merrte?

Piramida në vende me sistem pak të zhvilluar financiar, piramida në shtete të zhvilluar, një garë skandalesh, e cila çon me të drejtë në pyetjen: A ka zgjidhje përballë situatash të tilla që me skemën Madoff bëjnë të qartë që janë po aq të mundshme si në vendet me sistem më të zhvilluar financiar edhe në ato me sistem më pak të zhvilluar financiar? Jarvis shprehet se situata të tilla dëshmojnë për nevojën konstante për mbikëqyrje agresive dhe rregullative. Kolumnistja e *Bloomberg* përmbyll në mënyrë jo pak ironike, se duke u nisur nga kjo paraqitje e Jarvis, SHBA do të duhej të shihte sesi doli Shqipëria nga vështirësitë.

Muajt në vazhdim do të mund të tregojné sesa e madhe ka qenë vërtet skema e Madoff. Akuza e ngritur nga agjentët e FBI-së bën fjalë për një mashtrim me vlerë prej 50 miliardë \$. Lista e emrave të humbësve në këtë skemë do të pasurohet, ndoshta informacionet e paraqitura në këtë artikull, i cili bazohet në media të rëndësishme biznesi e finance, do të përmirësohen e saktësohen më tej, legjislacioni në SHBA do të pësojë ndryshime që do të reflektojnë si mbi krizën financiare të sotshme ashtu edhe në veçanti mbi skemën piramidale Madoff, në vendet e tjera do të ndiqet me vëmendje se çfarë do të vendoset e aplikohet në SHBA dhe do të shihet si mund të reflektohet kjo dhe në legjislacionin e zhvillimet e brendshme. Një shenjë të parë në këtë drejtim jep Serious Fraud Office në Britani, e cila po e studion rastin me qëllim njohjen e rëndësisë potenciale që mund të ketë ky rast. Rasti Madoff ndoshta do të kthehet në një studim rasti për studentët e finances dhe biznesit, ashtu siç ndodhi edhe më parë me rastet e Enron, Worldcom, etj. Ngjashëm me disa vite më parë, ndoshta një vend të rëndësishëm në kërkimin shkencor për studimin në nivel institucionesh, por në formë akoma më të spikatur se deri më sot, do të marrin Corporate Governance edhe Etika. Por ndryshe nga disa vite më parë, bazuar dhe në sukseset e arritura në kërkim, në plan të parë për shpjegimin në nivel individësh e nivel marrëdhënieje firmë (këshillues)-individ (klient) të rasteve të llojit do të vendosen rezultate të neuroshkencave që duket po japin një bazë të mirë për zhvillimin e neurofinancës. Në numrin e ardhshëm të revistës *ANASH-Approaching Science* do të jepet një hyrje në neurofinancë dhe në trende të kërkimit të sotshëm shkencor në fushën e financës. Studiuesit të cilët dëshirojnë të kontribuojné në këtë paraqitje janë të mirëpritur t’i adresohen kësaj reviste.

Burime:

Bloomberg. *Madoff Is Deja Vu All Over Again in Albania*. Nga Celestine Bohlen. 26.12.2008.

Business Week. *The Rise and Fall of Bernard L. Madoff*. Nga Monica Gagnier. 12.12.2008.

Financial Times. *SEC under fire over Madoff failings*. Nga Joanna Chung. 14.12.2008.

Handelsblatt. *Der 50-Milliarden-Dollar-Betrug*. Nga Rolf Benders, Katharina Slodczyk und Torsten Riecke. 15.12.2008.

NY Times. http://projects.nytimes.com/creditcrisis/madoff_clients/tabl

NY Times. *Standing Accused: A Pillar of Finance and Charity*. Nga Alan Feuer dhe Christine Haughney. 12.12.2008.

NY Times. Bernard L. Madoff. Nga rubrika: *Time Topics*, People. Dhjetor 2008.

1. Bëhet fjalë për studimin “The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania” nga Christopher Jarvis publikuar në *IMF Staff Papers*, Vol. 47, Nr. 1.



Kush do të na shpëtojë nga kriza?

GIORGIO BOCCA

Ç'është more kjo krizë?, ironizonin kabaretistët e viteve Tridhjetë. Por për krizën aktuale ata nuk do të mundnin të përsërisnin të njejtën gjë: të gjithë sot e dinë se ç'është ajo, e bazuar tek difektet elementare njerëzore si pangopësia, padurimi, pandershmëria, ëndrra për fuqi, shfrytëzimi i të tjerëve dhe budallallëqe të cilat është shumë vështirë, shpesh e pamundur t'i injorosh.

Ekonomistët që i kanë duart në thes janë më të përshtatshmit për ta shpjeguar krizën; ia dalin më mirë shkrimtarët dhe artistët. Le të themi Tolstoji plak: "Djali i perfeksionimit teknik i ka bindur njerëzit se sa më shumë objekte të fabrikojmë e sa më shpejt, aq më mirë do të jetë për të gjithë. Kështu njerëzit humbin edhe jetën për fabrikimin e një numri objektesh krejt të padobishme si për ata që i prodhojnë, ashtu edhe për ata që kanë hyrë në borxh për t'i blerë ato".

Kriza është e qartë, shumë e qartë për ata që e kanë dëshiruar ditë pas dite dhe kjo qartësi është arsyeja parësore e poshtërimit, e pranimit të fajit, evidenca se po shkatërrohem me duart tona. "Po jetojmë me një bombë me orar të vonuar në dollapin tonë" thotë sociologu Edgar Morin. A duhet të habitemi se po na gllabëron ankthi? Çdo mëngjes hapim gazetën, radion apo televizorin me një synim krenar: këtë herë dua të kuptoj se përse sot gjithçka shkon shtrembër, gjithçka në humbje edhe pse bëjmë të njejtat gjëra si dje kur gjithçka ishte me fitim, zhvillim. Dhe konstatimi i parë dekurajues, i dëshpëruar, është se po bëjmë gjithçka për të riprodhuar difektet dhe gabimet e së djeshmes.

Kush janë ekspertët, specialistët e nderuar, mendjet e holla të cilëve iu kërkojmë të meremetojnë barakën e ekonomisë? I pari që u çfaq në ekranet e botës ishte një gjigant i quajtur Henry Paulson, me zërin e tij të dridhur, një prej magjistarëve të Federal Reserve që kanë ndjekur

prej vitesh futjen në borxhin e pafund, shitjen e "aksioneve plehra", transferimin e borxhit të jashtëm amerikan në vende të tjera, konsumizmin e çmendur që po vë në rrezikun final mbijetesën tonë, në një vorbull të parezistueshme ku çdo gjë që bëjmë është e gabuar: nëse konsumon shumë hyn në borxh, nëse nuk konsumon ekonomia ndalet, nëse ndjek galopin teknologjik ndotet mjedisi, nëse nuk e ndjek do të falimetosh.

Duke i parë qysh në mëngjes këta menaxherë me depresion që nxjerrin në shesh çmenduritë dhe dhunën e tyre, na vjen të mendojmë se për njerëzit e një mijëvjeçari tjetër gjërat do ndryshojnë për të mirë por për ne sot e keqja është e sigurtë. Për më tepër, duke ditur që ata ishin të shkolluar e kuptojmë që gjithçka ishte e parashikueshme, e evitueshme. A nuk është e njohur që nga koha e Tacitit se "dobësia humane bën të mundur që kura të vijë gjithmonë pas së keqes?" Nuk është e stërnjohur se një nga mendimtarët e mëdhenj të kapitalizmit, zoti Taylor i metodës së famshme produktive, iu thoshte me dashuri punëtorëve "Nuk iu kërkoj të mendoni. Ka njerëz të që paguhen për këtë". Teknika si shkopi magjik! Por, pjesë e teknikës është edhe plumbi që nuk kthehet dot prapa, digat kolosale që kanë shkatërruar përgjithmonë sitemet hidrike kineze, egjiptiane e danubiane.

Çdo mëngjes hapim gazetën dhe televizionin për të parë në se po vijnë shpëtimtarët tanë. Shfaqja nuk është inkurajuese: ata luajnë me malet e dollarëve e sterlinave siç ishte në modë në vitet e mrekullisë ekonomike loja Monopoli, me zara e para fallco. Ekonomia në përgjithësi dhe ajo globale në veçanti i japin jetë disa mekanizmave jashtë çdo kontrolli, jashtë dëshirave dhe dobësive njerëzore. Të vlerësuara sidomos nëse janë jashtë çdo lloj kontrolli. Po atëhere përse duhet të ankohe mi?

L'Espresso, 24 dhjetor 2008

Gustav Majer dhe albanologjia

Kontributi i studiuesve gjermanë në studimet albanologjike

Shkolla gjermane, që ka arritjet më të suksesshme në fushë të albanologjisë dhe njëri prej studiuesve më të shquar nga kjo shkollë, Gustav Majeri, janë të lidhura ngushtë me fillimet e albanologjisë, me studimet e saj më të rëndësishme në të gjitha kohërat, me themelimin e albanologjisë si shkencë, dhe me shkallën më të lartë të studimeve të saj në ditët tona.

Mund të thuhet kështu se: në shekullin XV, kur gjejmë veprën e parë për gjuhën shqipe ndër të huaj, një Fjalorth, që sado i vogël qoftë, e kemi trashëguar nga një udhëtar gjerman, Arnold von Harff (1497); për shkak se në shekullin XVI, në mesin e disa veprave të njohura që flasin për gjuhën shqipe dhe shqiptarët, gjendet edhe vepra e një studiuesi gjerman: Konrad von Gesner (1555); për shkak se, në shekullin XVII, veç të tjerash, kemi edhe një lutje në gjuhën shqipe, të cilën e ka botuar Andrea Muller (1680); për shkak se, në shekullin e XVIII njëri prej filozofëve më të mëdhenj gjermanë dhe evropianë të kohës së tij, Gottfried Wilhelm Leibnitz (1705-1715), është njëri prej popullarizuesve më të mëdhenj të prejardhjes së gjuhës shqipe, madje jo vetëm një herë dhe në një rast, por për mëse njëzet vjet me radhë. I po kësaj kohe është edhe kritiku e filozofi i madh gjerman Johan Gotfrid Fon Herder (1744-803), si dhe historiani Johan Erih Tunman (1746-1778); në shekullin XIX, disa prej studiuesve më të shquar të gjuhësisë evropiane, gjermanët: Johan Christoph Adelung (1809), Christian Gottlieb von Arndt (1818), J.A.G. Schmidt (1822), Johann Severin Vater (1822), Karl August Anton Alfons Joseph Ritter von Xylander (1835), gjendet edhe studiuesi i madh gjerman Johann Georg von Hahn (1853-1855), i cili vuri bazat materiale dhe shkencore të albanologjisë. Le të kujtojmë se në gjysmën e parë të shekullit XIX vepron edhe studiuesi i njohur për zonën mesdhetare të Evropës, Jakob Philip Falmerajer (1790-1860). Po i kësaj kohe është edhe njëri prej historianëve më të mëdhenj të këtyre dy shekujve, Teodor Mommsen (1817-1903).

Gjithë ky interesim dhe gjithë kjo punë për studimin e gjuhës shqipe edhe është pritur që do të kurorëzohet një ditë me rezultate të reja shkencore në fushë, jo vetëm të albanologjisë si shkencë, që po linte, por edhe në shkallë të ballkanologjisë dhe të indoevropianistikës në përgjithësi. Për të ndodhur kjo nuk është dashur shumë kohë. Vetëm disa

dhjetëvjetsha më vonë, pra në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ishte studiuesi i madh Franc Boppi (1855) dhe më pas Gustav Majeri (1891), i cili do t'i vërë bazat e shkencës të albanologjisë. Puna shkencore e studiuesve gjermanë dhe austriakë nuk mbaroi me këtë shkallë të ngritjes së dijes për albanologjinë. Ata do të shtohen, jo vetëm për nga numri i hulumtuesve, por edhe sipas fushës së interesimit. Le të kujtojmë këtu punën e madhe shkencore që në fillim të shekullit XX e bëri Norbert Jokli (1916-1939), angazhimin e madh jo vetëm shkencor, por edhe kulturor e kombëtar për shqiptarët të Maksimilian Lambercit; vlerat shkencore të studimeve ilire nga profesori i gjuhësisë krahasimtare Paul Kreçmer (1886-1956), le të kujtojmë këtu profesorin e historisë Hansjorg Frommer (1939-), filozofin dhe historianin Peter Robert Franke (1926), studiuesit, nga më të zellshmit në ditët tona: Herman M. Olberg, Wilfred Fiedler e Oda Buchholz, Norbert Boretzky etj.

Megjithatë, ata që kontributin e studiuesve gjermanë e shikojnë vetëm në një kënd dhe i qasen vetëm nga një anë, nuk harrojnë të thonë se: interesimi i shkollës gjermane për gjuhën shqipe ishte i natyrës politike; i natyrës së rastit, d.m.th. studiuesit gjermanë ishin marrë me albanologjinë falë pranisë së tyre në trojet shqiptare, e madje edhe kolonitë shqiptare, për aktivitete të caktuara politike, tregtare, ushtarake etj; se për studiuesit gjermanë gjuha shqipe ishte vetëm një trampolinë krahasuese me gjuhët e tjera, për të nxjerrë rezultate sa më të sakta në shkallë të gjuhësisë indoevropiane etj. Prandaj, në këtë rast shtrohet nevoja që interesimi i studiuesve gjermanë për gjuhën shqipe, popullin shqiptar dhe për historinë e tij, të trajtohet edhe në aspekte të tjera.

Jeta dhe vepra

Gustav Majer u lind më 25 nëntor 1850 në Gross-Strelitz, krahina e Silezisë së Epërme të Gjermanisë. Ishte bir i një nëpunësi prusian. Mësimet i filloi në Gjymnazin e Opelit dhe i vazhdoi në Universitetin e Breslaut. Tregoi interesim të veçantë për studimin e gjuhëve të lashta: për indishten, sanskritishten, latinishten e në mënyrë të veçantë për greqishten. Në fillim emërohet asistent i gjuhëve të lashta në Gjymnazin e Gotës (1871), por vetëm pas një viti emërohet profesor i

universitetit të këtij qyteti. Pas dy vjetësh emërohet profesor i gjuhëve të lashta në Universitetin e Pragës dhe më 1877 emërohet profesor i Gjuhësisë indoevropiane në Universitetin e Gracit, ku i vazhdoi studimet për greqishten e vjetër, turqishten, dhe bëri një punë të madhe sidomos në studimet albanologjike. Rezultat i studimeve të tij në fushë të gjuhëve klasike, në këtë kohë, është studimi “Ndihmesë për teorinë e fjalëformimit të greqishtes dhe të latinishtes”. (1872)

Aktiviteti i tij si mësimdhënës dhe studiues në Universitetin e Gracit, baza e gjerë e dijes shkencore që kishte fituar deri më 1877 dhe metodat e rrepta shkencore që në fushë të gjuhësisë shtroreshin në fund të shekullit XIX, bënë që horizonti studimor i Gustav Majerit të kufizohej në zona më të ngushta gjuhësore. Interesimi i tij për gjuhën greke, e cila në studimet indoevropiane mbahej për gjuhë mis, nuk ishte i rastit, ashtu sikur edhe për gjuhën latine, por as interesimi i tij për gjuhën shqipe nuk mund të thuhet se ishte një rastësi. Shqipja tashmë ishte bërë fushë studimi nga shumë paraardhës të tij, si: Lajbnici, Ksilanderi, Mikloshiqi, Hani, Shuhardi, e ndonjë tjetër filozof, historian, arkeolog a gjuhëtar, dhe kishte zënë vend të qëndrueshëm në familjen e madhe indoevropiane e në bashkësinë gjuhësore të Ballkanit, bashkëthemelues i së cilës do të bëhet edhe vetë Gustav Majeri. Për ne këtu është me interes të thuhet se, ndryshe nga studiuesit e mëparshëm (historianë, filozofë, gjuhëtarë, etnografë, arkeologë etj.), Gustav Majeri me studimet albanologjike nuk do të merret në kontekst krahasues ose të rastit, por edhe me studimet e brendshme të shqipes. Aq më shumë, Majeri do të bëhet mbledhës, botues, studiues dhe sintetizues i folklorit, leksikut, të folmeve, letërsisë së shkruar etj. Një jetë të tërë do t’ia kushtojë albanologjisë, duke u bërë kështu edhe themelues shkencor i saj.

Duke hulumtuar materiale për studimet greke në Itali, Gustav Majeri u interesua edhe për gjuhën, folklorin dhe letërsinë shqiptare, prandaj të njëjtin interesim e vijoi edhe gjatë hulumtimeve të tij shkencore në Greqi. Kështu, dy kolonitë arbëreshe, kolonia e arbëreshëve të Italisë dhe kolonia shqiptare e arbëreshëve të Greqisë, u bënë nxitje e tij për gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre, për të cilat do të punojë deri në fund të jetës së tij.

Studiuesit shqiptarë dhe të huaj asnjëherë nuk e kanë vënë në pyetje karakterin thjesht shkencor të interesimeve të tij, mirëpo tash së fundi në një analizë të zgjeruar lidhur me studimet austro-hungareze për shqiptarët, kanë vënë re se interesimi i Gustav Majerit për gjuhën shqipe dhe shqiptarët, pas Kongresit të Berlinit, nuk ka qenë i rastit.

Gustav Majeri në studimet shqiptare

Jeta dhe vepra e Gustav Majerit, edhe një shekull pas vdekjes së tij, ende nuk është bërë objekt studimi në shkallën që ajo e meriton të studiohet. Shënimet, artikujt dhe studimet

e deritashme dëshmojnë se themeluesi i albanologjisë, Gustav Majeri, ende nuk është i njohur sa duhet as si personalitet i gjithanshëm, as për bëmat e tij, për popullin shqiptar dhe gjuhën e tij, prandaj është e kuptueshme pse në bibliografinë e tij ende nuk i janë shënuar të gjitha ato elemente themelore, të cilat do ta rrumbullaksonin plotësisht jetën dhe veprën e tij.

Për jetën e tij ende nuk kemi monografi të veçantë, kurse një pjesë e aktivitetit të tij për shqiptarët ende nuk na është e njohur. Megjithatë në artikujt, vështrimet, studimet shkencore dhe paraqitjet vulgare për veprën e Majerit dhe temat që lidhen me veprën e tij, autorët shqiptarë apo të huaj, janë përpjekur të paraqesin biografinë e tij jetësore dhe bibliografinë e tij shkencore, lidhjet e tij kulturore, shkencore dhe politike me studiues shqiptarë e të huaj.

Po të paraqitej një pasqyrë e përgjithshme e pranisë së Gustav Majerit në letrat shqipe brenda këtij shekulli të fundit, e nxjerrë nga bibliografia e Palok Dakës (*Bibliografi retrospektive e gjuhësisë dhe e onomastikës shqiptare*, (1879-1944), I (1879-1921), II (1921-1941), III (1941-1944), (Bibliografi me anotacione hartuar sipas të dhënave të shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë të viteve 1848-1944). Për përdorim të brendshëm, ASH e RPSSH-IGJL, Tiranë, 1984), kjo pasqyrë do të dukej kështu: Calvosa, në një nekrologji për Zef de Radën njofton se gramatika e tij, veç të tjerëve, i kishte tërhequr vëmendjen edhe Gustav Majerit; gazeta *Albania* njofton për gjendjen shëndetësore të Majerit pa shpresë se do të mund të shërohet; Kremones, duke u nisur nga vepra e Naim Frashërit *Qerbelaja*, paraqet një parashtrësë të tij për diskutim lidhur me alfabetet e shqipes, ndërsa në radhën e alfabeve më të njohura radhit edhe atë të Gustav Majerit; Bauer, në një notes të tij të botuar në *Albania*, veç të tjerash, njofton edhe për gjendjen shëndetësore të Gustav Majerit; *Kalendari i Maleve* boton një fotografi dhe shënime për jetën dhe veprën e Majerit; në gazetën *Albania* njoftohet për vdekjen e Majerit; Asdreni kundërshton mendimin e Sami Frashërit dhe të Majerit lidhur me prejardhjen e etnonimit shqiptar dhe e kërkon këtë fjalë te legjenda e Piirros; revista *Albania* e Londrës njofton se Albert Thumbi ka botuar një studim interesant mbi Gustav Majerin; *Kalendari Kombiar* boton një skicë të shkurtër për Majerin dhe e shoqëron me një fotografi; Bogdan P. Hazdeu, profesor i Universitetit të Bukureshtit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave, në një ligjëratë të mbajtur më 25 maj 1901, pikëpamjet e tij për prejardhjen ilire të popullit shqiptar i mbështet edhe te Gustav Majeri; në një mbledhje të prelatëve të Shkodrës, sipas gazetës *La Nazione albanese*, Ndre Mjeda kishte mbrojtur një sistem alfabetik, i cili nuk ishte tjetër veçse një mutatis mutandis i atij të Brugmanit, Majerit etj; në një letër të tij dërguar *Albanisë*, paraqet pikëpamjet e tij për alfabetet e shqipes, ndërsa për alfabetin e Gustav Majerit ka konsideratë, por me

kusht që t'i hiqen karakteret greke, punë të cilën, siç dihet, e bëri Ndre Mjeda; me rastin e vdekjes së Gustav Majerit, Albert Thumbi boton në *Albania* një artikull me shënime për jetën dhe veprën e tij; Loreochio mban një qëndrim kritik dhe madje favorizues ndaj shqiptarëve për rolin që kishin në zhvillimin e shqipes në kolonitë e ndryshme, përkundrazi sa u përket studiuesve të huaj, në mesin e të cilëve radhit edhe Majerin, mendon se gjuha shqipe ishte një mjet për ushtrime doktrinash morfologjike e filologjike të krahasuara; Pashko Bardhi, pasi riprodhon dy fragmente të *Ungjillit të Shën Lukës* në të folmen e Borgo Ericos, njofton se këto fragmente më parë i kishte botuar në dialekte të ndryshme edhe Gustav Majeri; fletorja e Selanikut *Diturija* jep shënime për *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* dhe e radhit në mesin e nëntë fjalorëve që mund të shërbejnë për mësimin e gjuhës shqipe, siç thuhet, derisa të botohet një fjalor i plotë i gjuhës shqipe.

Besoj se Anton Zanoni i ka bërë vështirësimin më të mirë këtij fjalori në fillim të shekullit XX, duke dhënë edhe vërejtje dhe shpjegime shumë të arsyeshme lidhur me të dhe rezultatet e tij. Autori i paidentifikuar deri më tash në *Fjalorin e pseudonimeve, anagrameve e siglave* të botuara me pseudonimin H., në gazetën *Bashkimi* të Shkodrës boton shënime për veprat dhe autorët e huaj që u morën me gjuhën shqipe, duke i dhënë një vend të merituar edhe Gustav Majerit; Lorecchio, duke i kundërshtuar mendimet e xhonturqve, që po e mohonin gjuhën shqipe, flet për lashtësinë e saj, duke iu referuar, mes të tjerash, edhe Gustav Majerit, si dhe bën thirrje për një alfabet të përbashkët, duke ftuar kështu edhe një Kongres gjuhësor për arbëreshët e Italisë, me çka, sipas autorit, do të dëshmohej se nuk kishte asgjë kontestuese ndërmjet kongreseve të arbëreshëve të Italisë për gjuhën shqipe dhe Kongresit të Manastirit. Aleksandër Xhuvani, duke bërë një polemikë me Nolin, lidhur me disa terma fetarë, kritikon edhe disa zgjidhje etimologjike të Gustav Majerit; Kristo Dako në një artikull për gjuhën shqipe sipas dijetarëve të huaj, veç të tjerash, mbështetet edhe te Gustav Majeri. Pashko Bardhi, duke shkruar për historinë e alfabeve të shqipes, thotë se për alfabetin e Dhaskal Todhrit, Hahni mendonte se ishte i lashtë, ndërsa përcaktimin e drejtë të tij e bëri Gustav Majeri. Kristo Floqi boton një artikull divulgativ, mbi lashtësinë e gjuhës shqipe, duke u mbështetur, veç të tjerash, edhe në veprën e Gustav Majerit. Aleksandër Xhuvani boton një artikull gjuhësor, duke u mbështetur në veprën e Gustav Majerit *Die Pluralbildung der albanischen Nomina*, Wien 1883. At Pashko Bardhi, me pseudonimin B., boton një artikull nga gjuhësia krahasuese, në të cilin u bëhet një vështirësim tezave kryesore të Gustav Majerit për etnogjenezën e gjuhës shqipe, emrin kombëtar dhe vendit të tyre Shqipni apo Albani etj. Në revistën *Hylli i Dritës*, botohet një artikull përmbledhës për etnogjenezën e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, mbi të arriturat e gjuhësisë krahasuese, në të cilën pasqyrohen edhe

rezultatet e Gustav Majerit; Petro Vullkani boton një artikull divulgativ në lidhje me origjinën e emrit Alban dhe lokalizimin e vendit Albanopolis, në të cilin radhit edhe mendimin e Gustav Majerit për këtë çështje. Brandejs, duke shkruar mbi albanologun e parë çek Jan Urban Jarnikun, në bibliografinë e tij radhit edhe një recension mbi tri vepra të Gustav Majerit: *Gramatikën e shkurtë të shqipes* (1888), *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* (1891) dhe *Studimet shqiptare*, III (1892). Faik Konica boton një artikull divulgativ për gjuhët e botës dhe citon një vepër për gjuhësinë, të botuar nën udhëheqjen e prof. Groberit, në të cilën një artikull mbi elementin latin të gjuhës shqipe e kishte botuar edhe Gustav Majeri. Dr. Glotofili (*pseudonim*), boton një artikull mbi origjinën e popullit shqiptar dhe radhit tri teoritë kryesore me përfaqësuesit e tyre, duke i dhënë edhe Majerit një vend shumë të merituar në mesin e përkrahësve të prejardhjes lire të popullit shqiptar. Lajos jep një përmbledhje të shkurtër të veprave të Gustav Majerit për gjuhën shqipe. Gelli, në një artikull për Dhimitër Kamardën, veç të tjerash, shkruan për jehonën që pat vepra e tij *Saggio di grammatica comparata sulla lingua albanese* (1864) edhe te Majeri. Te *Gazeta e re e Tiranës* i bëhet vërejtje Gustav Majerit, se kuptimi i fjalës *nameta*, që sipas tij ka etimologji greke, në gjuhën shqipe d.m.th. “më vonë, mbi këtë”. Në një studim të shkurtër rreth etnonimit shqiptar, *arbnuer e alban*, Marin Sirdani e mendon më të qëndrueshme tezën e Gustav Majerit për toponimin *Shqipni*. Në një studim të tij Namik Resuli kundërshton mendimin e Gustav Majerit për fjalën *regj* dhe pranon mendimin e tij për etimologjinë e fjalës *rig*; Mati Logoreci boton një studim biografik dhe shkencor për Gustav Majerin. Po këtë vit Logoreci boton edhe një vështirësim me pikëpamjet e tij rreth fjalës *shqyp*, për të cilën Gustav Majeri mendonte se vjen nga *shqiptoj*, Logoreci e lidh me greqishten *skopos*, nga fjala *skopeio* = *kqyr, vrej*. Mustafë Kruja, me pseudonimin Shpend Bardhi, në një studim mbi origjinën e popullit shqiptar, në mesin e tezave të radhitura, gjendet edhe ajo e Gustav Majerit për shqipen si gjuhë iliroindoevropiane, e cila iu prin tezave të tjera dhe studiuesve të tyre. Në një vështirësim të përgjithshëm për problemin e gjuhës letrare shqipe, ndalet edhe në gjykimet e Gustav Majerit për këtë problem. Në studimin e Norbert Joklit për popullin shqiptar e të gjuhës së tij, vendi që zë Gustav Majeri është i rëndësishëm në shumë aspekte.

Pas Luftës së Dytë Botërore emri i Gustav Majerit përmendet më rrallë në artikujt dhe në studimet shqiptare për një kohë të gjatë, nëse këtu përjashtohet emri dhe vepra e Profesor Çabejt, sado as ai nuk ka shkruar ndonjë artikull të veçantë, qoftë për veprën qoftë për jetën e tij, ashtu sikur kishte shkruar për autorë dhe vepra të tjera të studiuesve gjermanë apo austro-gjermanë sikur i paraqet Eqrem Çabej.

Deri më 1995, në asnjërin nga artikujt e botuar gjatë këtyre pesëdhjetë vjetëve të fundit, nuk është shënuar se Gustav

Majeri nuk ishte vetëm mik i rilindësve shqiptarë, por ishte edhe më shumë se kaq, ai ishte mik i çiltër i popullit shqiptar, dhe këtë e ka dëshmuar edhe me letrat që ua kishte dërguar sulltanëve të kohës, për lejimin e hapjes së shkollave shqipe për shqiptarët. Se ky element i rëndësishëm në jetën e tij dhe në historinë tonë nuk ishte i njohur, dëshmon edhe biografia e tij e paraqitur në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*. Autori i njësisë *Gustav Majer (1850-1900)*, akademiku Shaban Demiraj, vlerëson kontributin e Gustav Majerit në studimet etimologjike, duke përmendur disa lëshime (fjala është për ndikimin e madh të latinishtes, që Gustav Majeri dhe bashkëkohësit e tij shihnin në leksikon e shqipes), theksohet se ai ishte grevist e turkist, por nuk shënohet asnjë fjalë për punën e tij në mbledhjen dhe botimin e folklorit shqiptar, e cila gjë dihej, por sigurisht autori në fjalë nuk dinte për interesimin e tij rreth çlirimit të popullit shqiptar nga zgjedha turke, pra nuk dinte se Gustav Majeri ishte mik i veçantë i shqiptarëve, cilësi kjo e cila personalitetëve të huaja u mbiçmohet në këtë vëllim, madje edhe atëherë kur këtë e meritojnë më së paku.

Shqipja, gjuhë indoevropiane

Prej letrave të Lajbnicit e deri te teza themelore e Gustav Majerit për vendin e shqipes në rrethin e gjuhëve indoevropiane, mendimet e dijetarëve sado që nuk kanë qenë shumë të ndryshme, në thelb ato janë dalluar në aspekte të caktuara. Lajbnici kërkonte nga studiuesit që gjuhës shqipe t'i caktohej vendi që i takonte në mesin e gjuhëve indoevropiane; Franc Bopi, sipas Çabejt, vendin e gjuhës shqipe e caktoi me këto fjalë: "gjuha shqipe, në elementet e saj themelore, nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë, ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni me asnjërin nga gjuhët motra sanskrite të kontinentit tonë" (1959/1976, 13). A. Shllajher, ndonëse shqipen e përfshiu brenda drurit gjenealogjik, këtë vend ia bëri në kuadër të familjes pellazgjike, d.m.th. pranë e pranë greqishtes, për çka me kohë u pajtuan edhe rilindësit shqiptarë në krye me De Radën e sidomos gjuhëtarin Dhimitër Kamarda. Një vend i veçantë shqipes iu caktua edhe në teorinë e valëve nga Johanesh Shmid, por sipas Çabejt, vetëm më 1883, Gustav Majeri, me artikullin *Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indogjermane*, hapet një epokë e re në punën e afrive të shqipes me gjuhët simotra.

Duke ndarë mirë pasurinë vetiake të shqipes nga elementet e huazimit, pas një analize krahasimtare të sistemit fonetik e të disa elementeve të leksikut, ky dijetar i caktoi shqipes me dorë të sigurt një vend, i cili, në vija të përgjithshme, mbetet i vlefshëm edhe sot e gjithë ditën. Ky vend është i caktuar me këto dy drejtime: "shqipja është një gjuhë indoevropiane lindore dhe njëkohësisht një gjuhë indoevropiane veriore" (*Ibid.* 14). Nëse kthehemi përsëri te kërkesa e Lajbnicit për t'i gjetur një vend shqipes në mesin e gjuhëve indoevropiane dhe të atyre të mëvonshme, për të parë vendin e shqipes në mesin

e këtyre gjuhëve, lidhjet e saj me gjuhët indoevropiane, përkimet e veçanta dhe të përgjithshme etj., që lidhen po ashtu me vlerësimet e Çabejt për formulimin e Majerit, atëherë edhe këtu do të gjejmë vlerësimet e Çabejt. Bie fjala, sa u përket elementeve të trashëguara të shqipes, Çabej mendonte se "Gustav Majeri që i pari që konstatoi e që vuri në dukje në një formë përmbledhëse e tërësore elementin e trashëguar të shqipes dhe që e vendosi atë në vendin që i përket kësaj gjuhe në rrethin e gjuhëve të tjera indoevropiane" (Çabej: 1981-1986, 185). Sa u përket konkordancave leksikore të shqipes me gjuhët baltike, të cilat dalin nga teoria e valëve e Johanesh Shmitit, Çabej, ndonëse për hapjen e rrugës e vlerësonte Majerin, meritën për rezultate shtruese megjithatë ia njohi mësuesit të vet, Norbert Joklit (Çabej: 1976, 15). Pra, konstatojnë Çabej, "Norbert Jokli e ka vërtetuar dhe thelluar rrugën që pat rrahur Gustav Majeri (...), që shqipja ka lidhje të ngushta sidomos me gjuhët baltike, dhe që të parët e shqiptarëve, duke zbritur nga vise më veriore ngulen në brigjet e Mesdheut" (Çabej: 1972/1976, 205). Mirëpo, pas Gustav Majerit, Holger Pedersenit e Norbert Joklit, të cilët zbuluan lidhjet gjuhësore të shqipes me gjuhët simotra indoevropiane, është Çabej ai i cili me sintezën e tij *Studime etimologjike në fushë të shqipes* plotësoi kërkesën e themeltë të Hygo Shuhardit, të bërë më 1827: "Kur njëherë t'i jetë caktuar shqipes një vend i ngulët e i paluajtur brenda gjuhëve indoevropiane, atëherë mjaft fjalë që ne sot i konsiderojmë, dhe me plot të drejtë, si huazime, ka të ngjarë që do të na duhet t'ia kthejmë prapë asaj, si një pjesë të pronës së saj të trashëguar" (Çabej: 1964/1977, 243). Rrjedhimisht, në qoftë se këtë "vend të ngulët e të paluajtur brenda gjuhëve indoevropiane", ia kanë caktuar një varg studiuesish, e sidomos Majeri, Holger Pedersenit e Norbert Jokli, atëherë fjalët e konsideruara si huazime, të vjela dhe të arsyetuara nga zhvillimi i brendshëm historik i shqipes, i ka kthyer Çabej.

Prejardhja e popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe

Problemi i prejardhjes së popullit shqiptar për disa shekuj me radhë ka qenë çështje shqyrtimi nga historianët, arkeologët, historianët e gjuhës etj. Prej letrave të Lajbnicit (1774) e deri sot, kahet e studimit të këtij problemi kanë qenë nga më të ndryshmet. Në qoftë se çështja e prejardhjes së popullit shqiptar nga ilirët u zgjidh kryesisht nga arkeologët dhe historianët, çështja e prejardhjes së gjuhës shqipe, e trajtuar shumëfish nga gjuhëtarët hapi edhe probleme të reja, sidomos pas hipotezave për prejardhjen trake të gjuhës shqipe, që dolën në fillim të këtij shekulli.

Nga radhët e gjuhëtarëve të huaj prejardhjen ilire të gjuhës shqipe e kish trajtuar Lajbnici, Tunmani, Hani, Kopitari, Benfeji, Mikloshiq etj., mirëpo vetëm me punën e Gustav Majerit hidhen bazat shkencore të studimeve albanologjike, kurse leksiku i gjuhës shqipe bëhet bazë për të nxjerrë analogjitë

me ilirishten. Lidhur me prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, Gustav Majeri ka konstatuar që nga fundi i shekullit XIX, se: “Sa kohë që nuk del ndonjë fakt i kundërt, duhet të pranojmë që shqiptarët banojnë që prej kohësh të lashta në Shqipëri ose së paku në një pjesë të saj dhe që janë pasardhësit e ilirëve, të cilët në kohë të vjetra banonin në Dalmaci, Bosnje e Shqipëri” (Majer: 1943, 122), kurse shqipen e quajti me fjalë të peshuara “një epokë të dialekteve të lashta ilire” (Majer, *Ibid.* 130). Heqjen e kësaj murane e ka çmuar që më parë studiuesi i vijës së tij gjuhësore në fushë të albanologjisë, Norbert Jokli (Jokli, *Historia e shqipes...* 1972: 255). Sipas Çabejt, mendimin e Gustav Majerit për çështjen e burimit të gjuhës shqipe e mbron dhe e përforcon edhe Kreçmeri kur thotë se “shqipja paraqet fazën më të re të njërit nga dialektet e moçme ilire” (Çabej: 1957/1976, 171). Madje Kreçmeri thotë në një rast tjetër: “kjo është në bazë të të gjithë situacionit aq afër mendsh, sa duhet njeriu të sillte arsye shumë të rënda për të hedhur poshtë. Sepse shqiptarët banojnë atje ku në kohë të vjetër rronin popuj ilirë, dhe i mbajnë këto vise të paktën që nga shekulli X pas erës së re” (Kretschmer, *Gröbers Grundriss der romanischen Philologie*, I, 804, sipas E. Çabej: 1976, 29-30). Prof. Çabej edhe mendimin e Trajmerit për shqiptarët si mbeturinë të fundit të botës ilire e shihte të pajtuar nga pikëpamja gjuhësore me Gustav Majerin, i cili këtë çështje po në fund të shekullit XIX, e kishte formuluar drejt, pra: “gjuha shqipe është mbeturinë e fundit e një dialekti të ilirishtes më fort sesa mbeturinë e ilirishtes së vjetër” (Çabej: 1962/1975, 237). Po të jetë kështu, – vazhdonte Çabej – dhe kështu ka të ngjarë që të jetë, atëherë populli shqiptar si mbeturinë e një populli të madh të Evropës Juglindore dhe të Mesme është prodhim jo i një ekspansioni, po i një restriksioni; edhe trulli gjuhësor i këtij populli është pra përfundimi jo i një zgjerimi, po i ngushtimit të një treve më të hapur”. (Çabej, *Ibid.* 237). Kështu, pra, prejardhja ilire e popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe e mbrojtur nga historianët, etnografët, arkeologët, gjuhëtarët etj., në shekullin e kaluar dhe në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX (pra, deri sa nuk lindi teoria e Gustav Vajgan-dit për prejardhjen trake të shqipes), mbështetje kryesore kishin Gustav Majerin (Çabej: 1969/1977, 197) dhe rezultatet e sintezës së tij e të studiuesve të mëvonshëm, të cilët ishin të shumtë: Holger Pedersen, Sophus Bugge, Albert Thumb, Francesco Ribezzo, Matteo Bartoli, W. Meyer-Lübcke, S. Puscariu, Sigmund Feist, C. Karstien, Lehr-Sptavinski, Vacslav Cimo-chowski, Radoslav Katiqç etj., historianët si Fellmer-ayer, Nopcsa, Haberlandti, Hahni, Hertzberg, Jorga etj. Për këtë arsye, Norbert Joklin, Prof. Çabej e quante pasardhës të Gustav Majerit “për sa i përket caktimit të karakterit gjuhësor të shqipes” (Çabej: 1977, 205). Edhe përkufizimi i Katiqçit për shqipen, si një “ilirishte moderne-gjuha shqipe”, i cili është cituar shpesh nga studimet shqiptare në Kosovë, do

kërkuar krejtësisht të përfundimet e mëparshme të Gustav Majerit. Vështruar në tërësi, ndihmesa e Gustav Majerit nuk do parë si e tërësishme, por edhe si e veçantë, pra edhe për probleme të caktuara të lidhjeve gjuhësore iliro-shqiptare. Bie fjala, ndonëse, siç shkruante Çabej, “për periodën para-linguistike një nga gurët themelorë e vu J.G. Hahni, Gustav Majeri në studimet që zhvilloi rreth shqipes preku e zgjidhi edhe disa nga problemet e ilirishtes në lidhje me shqipen”. (Çabej: *Ibid.* 20) Nisur nga rezultatet e arritura shekuj me radhë, sidomos nga shkollat më të arritura të Evropës dhe i përgatitur edhe vetë në po këto shkolla, Çabej, jo njëherë, e ka përkufizuar prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, kështu: “djepi ballkanik i shqiptarëve së paku që nga epoka greko-romake e këtej është Ballkani Perëndimor, e jo Lindor. Atyre që përfaqësojnë mendimin e përkundërt, do t’u binte të zëvendësonin këtë pamje historike solide me një tjetër, e më saktësisht të na dëftonin se në cilin vend më në lindje u bë marrje e këtyre dorëzimeve. Në mënyrë përm-bledhëse do të themi pra se një gjykim objektiv i situatës historiko-gjuhësore pas mendimit tonë na çon të shohim në shqipen e sotme vijimësi e ilirishtes ose për ta thënë me fjalët e G. Majerit (*Grobers Grundriss der romanischen Philologie*), I (1888) 804) fazën më të re të njërit nga dialektet e vjetra ilire.” (Çabej, 1962/1977, 175)

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera

Biografia shkencore e Gustav Majerit tregon se ai ishte indoevropeist, grecist i shquar, turkist, ballkanolog, madje bashkë me Franc Mikloshiqin ishte edhe themelues i kësaj dijeje gjuhësore, – por mbi të gjitha ai do të mbetet albanolog. Prandaj është e kuptueshme pse Gustav Majeri, duke pasur njohuri të thella për zhvillimin e gjuhëve indoevropiane, duke qenë njëri nga autorët më të mirë të gramatikës greke dhe njohës i mirë i studimeve turke, sllave e rumune dhe sidomos studiues i shquar i studimeve albanologjike, këtë të fundit e bëri objekt studimi e krahasimi edhe me gjuhët e tjera nga shumë anë. Nga ky kënd, në njësi të shumta të *Fjalorit etimologjik*, në *Studimet gjuhësore* etj., Majeri ka trajtuar lidhjet e ngushta të shqipes, sidomos me gjuhët baltike, me gjuhën greke, me gjuhët sllave, me gjuhën rumune, me gjuhën turke etj. Këtu është me interes të shihet se si ai shprehet për këto lidhje të shqipes me gjuhët e tjera. Derisa për huazimet latine, turke e greke flet si për “ndikesa”, për huazimet sllave shprehet si për “vrragë”, ose thënë me fjalët e tij: “në gjuhën shqipe nuk mund të mohohen vrragë të forta të gjuhëve sllave” (Majer: 1943, 125). Po të lihen mënjane huazimet latine, është me rëndësi të theksohet se interesimi i Gustav Majerit ishte i veçantë, para së gjithash, për faktin se ai trajtoi jo vetëm huazimet greke të gjuhës shqipe, por edhe të kundërtën, pra edhe huazimet shqipe në greqishten e re. Madje, problemit të huazimeve të shqipes në greqishten e re,

i ka kushtuar një monografi më vete (*Neugrieschische Studien*, II 64-71) dhe sipas saj, këto huazime arrijnë afro 70 (Çabej: 1976, 72). Prof. Çabej, duke e vlerësuar mirë dhe duke e çmuar këtë vepër me interes për studimet krahasimtare të shqipes dhe ballkanistikës në përgjithësi, vijoi zgjerimin saj, zbuloi edhe një varg fjalësh të shqipes në greqishten bizantine, sidomos në dialektet e veriut, dhe arriti të konstatojë se “nga të tilla huazime del se elementi shqiptar në greqishten e re është më i madh nga çë llogariste Gustav Majeri” (*Ibid*, 72), madje, po sipas Çabejt, “shihet se ky ndikim përfshin edhe të tjera fjalë, si të mbarë gjuhës si dialektore” (1966/1976, 341, 342). Edhe sa i përket elementit shqiptar në Greqi, ndryshe nga studiuesit e kohës së tij që përgjithësisht përkrahen edhe sot në studimet shqiptare, Gustav Majeri mbante qëndrimin që “shqiptarët jetuan në Greqi edhe para vitit 1349, kur përmenden në Peloponez” (Majer, *Vep. e cit.*, 126).

Lidhur me marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, të trajtuara nga Gustav Majeri, Çabej është ndalur disa herë në studimet e tij, por këtu po i veçojmë dy elemente themelore. Duke shkruar për elementet e përbashkëta (simbioza) të leksikut shqiptaro-rumun, Çabej tërhiqte vërejtjen se “do vënë re mendimi i Gustav Majerit, që thotë se disa cilësi fonetike e semantike të elementeve shqipe të rumanishtes na shpjen në një kohë, e cila është më e moçme se formimi i gjuhës e i kombësisë rumune” (Çabej: 1976, 77). Në marrëdhëniet e rumanishtes dhe të shqipes prej shumë kohësh studiuesit hulumtojnë mundësinë e gjetjes së një substrati të përbashkët, madje shumë herë edhe duke i nxjerrë si gjuhë pranë e pranë njëra tjetrës. Sikur dihet, lidhur me këtë çështje, kanë ekzistuar më shumë se një teori për prejardhjen e tyre nga një burim i vetëm: trak, dako-miz, iliro-trak etj. Pranë e pranë kësaj çështjeje është trajtuar edhe një dorë fjalësh të shqipes e të rumanishtes që gjallojnë edhe sot në njërën gjuhë apo në të dyjat njëkohësisht. Duke shkruar për problemin e substratit të rumanishtes dhe të shqipes, Çabej tërheq vërejtjen për dallimin e tyre me dy fjalë: “Kundra mendimit të vjetër, të cilin e ka p.sh. edhe Gustav Majeri (*Alb. Studien*, III, 22,vv), që substrati i rumanishtes është një dialekt ilir dhe që baza jolatine e gjuhës dhe kombësisë rumune është ilire, gjer më sot nuk janë paraqitur gjëkund arsye vendimtare. Ndërkaq shtrurja e konceptit të substratit duke e zbatuar edhe për shqipen, duhet të kundërshtohet. Substrati lidhet e kushtëzohet me një ndërrim gjuhe; një ndërrim i tillë, nga sa dihet në truall të Shqipërisë nuk vërehet në periodën historike, sikurse përkundrazi pranohet me siguri për Rumaninë”. (Çabej: 1977, 176)

Historia e dialekteve të shqipes

Në fushë të studimit të zhvillimit të brendshëm të shqipes, problemi i moshës së dialekteve zë një vend të rëndësishëm. Siç dihet, në studimet e tij Hani, kohën e ndarjes së dialekteve e kishte shtyrë aq larg në antikitet, sa e vinte në lidhje

me ilirishten dhe epirotishten (Hahn: 1854, 219; *Cit.* Çabej: (1967/1977, 191), mirëpo më vonë kjo tezë që kundërshtuar nga një lagje studiuesish që vjen nga shekulli i kaluar deri në kohën tonë: Norbert Jokli, Justin Rrota, Karlo Taliavini Marko la Piana e sidomos Gustav Majeri, i cili i priu kësaj lagjeje. Gustav Majeri, duke u nisur nga materialet që kishte për të folmen e shqiptarëve në Greqi, ndarjen e dialekteve të shqipes e konsideronte më të vonshme (*Nuova Antologija*: 50/1885, 588; *Cit.* Çabejt: 1976, 190-91). Pra, sipas kësaj lagjeje gjuhëtarësh, të cilëve u printe Majeri, të dy dialektet e shqipes nuk ishin diferencuar deri te dy shekujt e fundit. Prof. Çabej thotë se “në fillim i këtij mendimi kam qenë edhe vetë. Tash veç rezultoi që aty duhet zbatuar një shtresim i dyfishtë”. (Çabej: 1968/1975, 256) Në një hulumtim shterues në veprat e Çabejt nuk është vështirë të shihet sesi ai, duke u mbështetur në hulumtimet dialektore dhe në dukuritë që i kanë përcjellë ato te një varg leksemash, (të cilat Majeri dhe studiuesit para tyre i konsideronin të lashta, ose më saktë të ilirishtes), ai shihte jo dukuri të lashta. Mirëpo, te dukuri të përtrira brenda zhvillimit gjuhësor të shqipes, që më parë, për shumë kohë ishin shuar, e që Gustav Majeri dhe studiuesit e mëvonshëm shihnin bazën huazuese të gjuhës latine, greke ose të ndonjë tjetre., Prof. Çabej shihte dhe lidhte nyjat kohore nëpër të cilat leksema përkatëse kishte kaluar brendshëm ndërtimit të gjuhës shqipe që nga lashtësia. Me një fjalë, Çabej pasi ua njihte meritën lagjes së gjuhëtarëve në krye me Gustav Majerin për përmbyjsjen e tezës së Hanit, besonte që këtë mendim, siç shprehej ai “ta kem përforcuar në pika të veçanta sidomos me anën e krahasimit të dialekteve të At-dheut e të kolonive si midis tyre si me monumente të vjetra letrare e me emrat historikë të vendeve e të personave ta kem çuar më tej duke e ngjitur në periodat e mëparme të gjuhës e ta kem pjesërisht dhe modifikuar” (Çabej: 1936/1977, 305).

Themeluesi i fonetikës historike të shqipes

Në fushë të studimit të fonetikës historike të shqipes, kontributi i Gustav Majerit është parësor dhe këtë rëndësi Çabej e ka vlerësuar çdo herë. Studiuesit e historisë së gjuhës që më parë e kanë theksuar se vepra e Gustav Majerit *Albanesische Studien* III (1892), prof. Çabejt i kishte shërbyer si bazë për përgatitjen e veprës *Fonetika historike e shqipes* (1959), që për mëse një gjysmë shekulli, krahas arritjeve të tjera të tij dhe të albanologjisë si tërësi, në fushë të fonetikës historike është vepër themelore universitare në studimet albanologjike. Këtë vepër të Majerit Çabej e quante “studim bazë deri në gjysmën e parë të shekullit XX, kur në mënyrë sistematike është trajtuar fonetika historike e shqipes”. Mirëpo, tërheq vërejtjen Çabej, sado që “kurrkush nuk e mbron që Gustav Majeri në veprat e tij ka vënë themelet e fonetikës historike dhe të etimologjisë (...) megjithatë ndërtesa e ngrehur prej këtij dijetari të shquar, kryesisht për arsye të kohës, është vjetruar

në disa pika, si bie fjala në lëmin e fonetikës historike, në kapitullin e grykoreve (guturaleve), të likuideve e hundoreve rrokjesore (silabike) (Çabej: 1975, 255). Për ndihmesë të veçantë të studimit të fonetikës historike të shqipes, meritën ua njihje sidomos edhe Holger Pedersenit, autorit të studimit monografik për guturalet e shqipes dhe mësuesit të tij Norbert Joklit të cilët, siç shkruante Çabej, “i kanë shpënë më tej e sqaruar shumë çështje të papërfunduara definitivisht prej Majerit” (Çabej: 1988, 9). Fjala është këtu për njërin nga problemet më të rëndësishme të fonetikës historike të shqipes dhe përgjithësisht të studimeve indoevropiane në fushë të fonetikës historike, pra, çështjen e guturaleve dhe aty “sidomos çështja e mënyrës së trajtimit të palataleve indoevropiane, të cilat edhe sot mbeten temë e hapur e diskutimeve shkencore. (Topalli: 1996, 37-44) “Dihet se këto dy teza – shkruan Çabej – qëndrojnë përballë njëra-tjetrës. Në njërin anë është rregulla e Gustav Majerit (...) e në anën tjetër ajo e Pedersenit” (Çabej: 1977, 212). Në këtë problem Çabej e përforcon rezultatit e Holger Pedersenit, ndërsa sa u përket rezultateve të Majerit, ai gjen një rrugë tjetër. “Rregullat e Majerit – shkruan Çabej – ne i zëvendësojmë me dy rregulla të tjera: 1. Një -nd- intervokaliqe e lashtë, pavarësisht nga theksi, nëpërmes të një trajte -nn- ka dhënë -n-; 2. Një -nd-, -ng- e gjuhës së sotme, në çdo pozicion që të jetë në një fjalë, është historogjene, sekondare. Me fjalë të tjera, edhe ne pranojmë bashkë me Majerin që në ato fjalë ku n-ja intervokaliqe nuk është kthyer në -r- në toskërishten, kjo -n- ka dalë nga një -nn- dhe ky grup rrjedh nga asimilimi i një konsonanti tjetër me n-në; veçse ne, në kundërshtim me Majerin, besojmë që edhe një konsonant që vinte pas n-së mundi e u asimilua me këtë” (Çabej: 1953/1977, 56).

Autori i fjalorit të parë etimologjik të shqipës

Në studimet etimologjike të Gustav Majerit, “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” (1891) zë vendin kryesor. Kjo është vepra për të cilën autori fillimisht është lavdëruar më së shumti dhe për të cilën më vonë është kritikuar po kaq shumë. E shikuar kështu në mënyrë të skajshme, për më se një shekull, ajo është bërë vepër referimi, vepër bazë e studimeve albanologjike dhe njëkohësisht vepër e kritikuar. Le të kujtojmë këtu vetëm çmimin e vitit të Akademisë Franceze, poezinë e Ndre Mjedës në shenjë nderimi për Gustav Majerin dhe kritikën e Holger Pedersenit me shprehjet e rrepta: “Më vjen keq të them se linguisti gjerman dhe miku im Gustav Majeri ka bërë shumë për të përhapur mendime të rreme në këtë fushë (d.m.th. se gjuha shqipe ka një karakter të përzier-BB)”. (Pedersen: 1917/1988, 23-24) Pavarësisht nga këto, vlerësimi i Eqrem Çabejt për studimet etimologjike të Gustav Majerit ka qenë i gjithanshëm dhe shterues. Për Çabejn, Gustav Majeri në studimet e gjuhësisë historike është figurë qendrore e studimeve etimologjike. Duke e vlerësuar me maturi këtë vepër,

Çabej thotë: “Autori i kësaj vepre është përfolur shpeshherë që ai e kishte mbiçmuar disi elementin e huaj në visarin e fjalëve të shqipes dhe se ky visar nuk përfaqësohet në masën e duhur në fjalorin e tij”. (Çabej: 1972/1975, 289) “Megjithatë, – thotë Çabej – duhet pranuar që ai edhe sot përbën një bazë jo vetëm për studimet shqiptare, po edhe përgjithësisht për studimet ballkanistike” (Çabej: 1972/1975, 289). Prof. Çabej e ka njohur mirë gjendjen e studimeve albanologjike në fund të shekullit të kaluar, sidomos i ka njohur dhe studiuar mirë edhe kritikën që i janë bërë vepërës së Gustav Majerit deri në kohën e tij, prandaj qasja e tij vepërës së Majerit në përgjithësi, e sidomos *Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe*, është e tipit analitik dhe referues.

Cilat ishin ato veçanti objektive që dallonte Çabej për të arsyetuar “të metat e *Fjalorit* të Gustav Majerit, sidomos në punë të materialit”: (Çabej: Ibid. 289) – gjendja e përgjithshme kulturore në Shqipëri, në të cilën nuk kishte kushte hulumtimi për punë të tilla sistematike; – njohja e kufizuar e literaturës së shkruar, sidomos e letërsisë së vjetër; – mungesa e fjalorëve të shqipes deri në fillim të shek. XX; – gjendja e studimeve albanologjike dhe mbështetja e studimeve të saj kryesisht vetëm në burimet e diasporës etj.

Sa i përket pasqyrës së paraqitur në parathënien e *Fjalorit* lidhur me karakterin gjuhësor, Çabej thotë: “Karakterizimin e shqipes si “një gjuhë e përzier gjysmëromane”, që e dha së pari Franc Bopi, e përfaqësuan disa gjuhëtarë të shquar të shek. XIX, si F. Miklosichi, Schuchardt i Gustav Majeri” (Çabej: 1976, 54). Më në fund vlerëson Çabej, në mbivlerësimin e këtij elementi përveç që ishte prirje e kohës së tij, ai kishte edhe arsye objektive, vërtetësie. Pra, sipas Çabejt ka pasur shumë arsye objektive që ky fjalor të dalë i mangët, ndërsa autori i tij të nxjerrë rezultate të gabuara, për të cilat edhe vetë Majeri më vonë ishte i vetëdijshëm, sepse për një numër njësisht, të cilat i rimori më vonë, ai solli përfundime që shkonin në të mirë të shqipes. Duhet pranuar se Gustav Majeri ndikimin latin e ka mbiçmuar, por pas punës së tij dhe më tutje të Holger Pedersenit e të Norbert Joklit, gurra vetjake e përfitimit të shqipes ka krijuar mundësi për të hequr nga rendi i ditës çështjen e mbisundimit të latinishtes dhe italishtes më vonë, ose mendimin e përgjithshëm se shqipja është gjuhë romane. Ky mendim tashmë nuk përsëritet. Çështjen e heqjes së kësaj hijeje mbi shqipen Çabej e mori shumë seriozisht, prandaj në vend që t’i bënte një kritikë kaluese, ai fillimisht objektin e studimit (d.m.th. *Fjalorin*) e përkufizoi kështu: “Kjo çështje është me rëndësi themelore për gjuhësinë shqiptare, sepse prek në vetë problemin e karakterit gjuhësor të shqipes. Për shqiptarët kjo përtej caqeve të gjuhësisë ka edhe një rëndësi nacionale; megjithatë dijes si kudo edhe në këtë çështje i ka hije të ruajë objektivitetin e duhur” (Çabej: 1976, 70). I nisur nga këto parime morale dhe shkencore, Çabej së pari voli në mënyrë shteruese gjithë materialin e njohur leksikor të shqi-

pes, të cilin e sintetizoi me akribi shkencore, pastaj çdo njësi etimologjike të Majerit e pasqyroj në kuadër të leksikut të përgjithshëm dhe pasi bëri një sintezë të shumfishtë dhe të drejtë shkencore, duke e përvijuar në shumë anë të studimit të saj, arriti në rezultate të tjera, për të cilat më parë studiuesit e huaj dhe ata të shqipes më vonë vetëm ishin deklaruar apriori, por pa dëshmuar rezultate konkrete. Mbi këto kritere, Eqrem Çabej u bëri një kritikë të gjithanshme jo vetëm rezultateve shkencore të Gustav Majerit, por edhe përfundimeve shkencore të Mikloshiqit, Ksilanderit, Nopçes, Majer-Lubkes, Nahtigalit, Oshirit, Manit etj. Konstatimeve për përpërsinë e romanitetit, sipas Çabejt, duhet nisur nga së paku dy kritere: ose me numrin e fjalëve bazë, ose me përdorimin e gjallë të tyre, pra: “Kriteri i parë do të rrokte më mirë këtë anë historike të leksikut, po duke lënë jashtë numërimit morinë e fjalëve të rrjedha prej fjalëve bazë, nuk do të pasqyronte pasurinë e vërtetë të tij, do të paraqiste si të thuash eshtërinë, jo muskulaturën e tij. Pavarësisht nga këto rrethana, përpjestimi i sasisë së trashëguar të leksikut ndaj sasisë së huazuar, përveç anës sasiore, thjeshtë numerike, mund të shqyrtohet edhe nga ana cilësore, kualitative” (Çabej: 1986, 264). Në këtë çështje Çabej bëri edhe një sintezë të gjerë të leksikut të shqipes dhe vetëm pastaj edhe nxjerrjen e përfundimeve për sasinë e leksikut të vendit dhe atë të huazuar (Shih pasqyrën e të dhënave sintetizuese të Çabej në *Studime gjuhësore*, VII, “Rilindja”, Prishtinë, 1986, f. 264-265). “Nga një vështrim paraprak, – shkruan Çabej, – po i mbështetur në një studim të gjatë të leksikut të shqipes nga kjo anë, neve na del që elementi i trashëguar mbizotëron në atë pjesë të tij që ka lidhje me një jetë më afër natyrës e me një ekonomi e një kulturë më fort baritore-agrare, elementi i huazuar – në pajtim me vetë karakterin e huazimit në atë pjesë që i përket një veprimtarie njerëzore më të shumanshme në fushën e kulturës materiale e morale; megjithëse do shënuar që pjesa e leksikut abstrakt e të ideve është në shqipen më e konsiderueshme nga sa mund të mendohet” (Çabej, *Ibid.*, 264).

Janë një varg problemesh që dalin në studimin përfundimtar të njërive leksikore të cilat duhen marrë parasysh. Ndër to, Çabej ka parasysh leksikun e marrë nga atdheu në diasporë, bie fjala te arbëreshët e Italisë, njohja e dukurive të gjuhëve në kontakt, njohja e leksikut të shqipes në gjuhët fqinje, dallimi i huazimeve nga leksiku i trashëguar, ndërtimi i brendshëm leksikor, rrjedhojat, kryqëzimi etj., për disa fjalë të cilat edhe sot e kësaj dite nuk e kanë zënë vendin e merituar në fjalorët etimologjikë. Po sipas Çabejt, problematike del, sidomos, çështja e formimeve onomatopaike. Po t’i kishte parasysh Majeri të gjitha këto edhe rezultatet do t’i nxirrte të tjera, që të formulonte një sintezë të tillë. Gustav Majeri së pari është dashur që të viltë materialin bazë, domethënë leksikun shterues të shqipes së vendit për kohën e tij.

Kontributi i Gustav Majerit në fushë të gjuhësisë

Më shumë se në fushë të letërsisë së shkruar dhe të folklorit, ndihmesa e Gustav Majerit është parë kryesisht në fushë të gjuhësisë. Për mëse një shekull nuk ka asnjë fushë e historisë së gjuhës shqipe në të cilën nuk është përmendur emri i tij dhe që nuk është shkruar për ndihmesën e Gustav Majerit. Duke filluar nga artikujt gjuhësorë për prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe e deri te studimet etimologjike që kulmojnë me Norbert Joklin e Eqrem Çabejn, Shaban Demirajn, Jup Kastratin, Kolec Topallin etj., vepra e tij përbën bazën themelore për hulumtimin diakronik dhe sinkronik të shqipes. (Christo Dako, Holger Pedersen, Dr. Treul Lajos, Aleksandër Xhuvani, M(ati) L(ogoreci), Shpend Bardhi (Pseudonim), Namik Resuli). Mirëpo, me gjithë praninë e veprës së tij në shtrirje kohore për më se një shekull, ndihmesa e tij është parë kryesisht përmes artikujve përgjithësues dhe as sot e kësaj dite ende nuk është botuar ndonjë monografi e veçantë për ndihmesën e tij në fushë të studimeve albanologjike, as ndonjë nga veprat e tij të shumta, përveç disa fragmenteve të caktuara.

Pikëpamjet e tij për letërsinë e shkruar

Në botimet shqipe të historisë së letërsisë, kontributi i Gustav Majerit nuk shënohet veçanërisht as në rrjedhat e studimit, as në kuadër të bibliografisë (Anton N. Berisha: 1985, 14-15). Në bibliografinë e zgjedhur të *Historisë së letërsisë shqipe* (Grup autorësh: 1989, 606) gjejmë vetëm veprën e tij *Della lingua e delle letteratura albanese*. Vol. L. Serie II, 15. IV. 1885, e cila përmendet edhe brenda në tekst si njëra ndër veprat studimore, që ishin botuar në fund të shekullit XIX. Në veprën *Histori e letërsisë shqipe* (Romantizmi), I (Qosja: 1984, 395-396), viti i lindjes së Gustav Majerit nuk është shënuar në “Pasqyrën kronologjike” mjaft të zgjeruar për vitin 1850. Po në këtë pasqyrë emri i tij shënohet vetëm për vitet 1883, 1887, 1891 dhe 1897, pra vitet kur Gustav Majeri botoi *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* dhe *Studimet shqiptare* I-VI. Në këtë vepër sintezë të Rexhep Qosjes, emri i Gustav Majerit përmendet si botues i letërsisë popullore, si mbrojtës i tezës së prejardhjes ilire të popullit shqiptar, si njohës dhe shfrytëzues i veprave të Jeronim de Radës nga aspekti gjuhësor, si letërkëmbyes me Jeronim de Radën, Thimi Mitkon, Konstandin Kristoforidhin, Ndre Mjedën, i cili ia kishte përkushtuar vjershën *Gjuha shqipe* dhe kishte pasur një letërkëmbim shkencor me të, si mik i Zef Skiroit etj., por jo edhe si autor i studimeve për letërsinë shqipe. Në *Historinë e letërsisë shqipe* të Robert Elsit gjejmë një bibliografi më të zgjeruar, por pa ndonjë funksion të veçantë brenda tekstit. Brenda teksteve që merren me historinë e letërsisë shqipe, vendi i studimeve të Gustav Majerit është më i peshuar në veprën e Namik Resulit *I più antichi testi albanesi*. Brenda kapitullit të këtij studimi, në të cilin janë komentuar veprat studimore të shekullit XIX,

Namik Resuli ka radhitur edhe katër artikuj të Gustav Majerit, (Resuli: f. 39; Majer: 1883, 211-225; 1888, 128; 1888) siç i quan autori, dhe ka tërhequr vërejtjen se “këta artikuj e ruajnë vlerën e tyre edhe sot” (Resuli, 39).

Botimi i letërsisë popullore

Ndihmesa e Gustav Majerit në fushë të letërsisë popullore po ashtu ende nuk është shikuar në shkallë të kënaqshme, mirëpo ndryshe nga konsultimi i artikujve të tij në fushë të letërsisë, ndihmesa e tij në mbledhjen, botimin dhe studimin e folklorit shqiptar, është konsultuar më shumë për faktin se kjo ndihmesë është mbledhur dhe ribotuar në vëllime të veçanta të folklorit shqiptar. Njëra nga veçantitë e kësaj fushe, ndërkaq, është marrë fakti që Gustav Majeri është botues i parë i këngës kreshnike.

Botimi i letërkëmbimit të Gustav Majerit

Ndryshe nga interesimi i studiuesve për botimin e veprave të tij, interesimi posaçërisht i madh ka qenë për botimin, madje edhe ribotimin e letërkëmbimit të tij, shpesh me komente dhe sqarime hyrëse, me rilindësit shqiptarë. Pavarësisht nga botimet e deritashme, nga studiuesit dhe hulumtuesit e letërkëmbimit të Majerit me bashkëkohësit shqiptarë, vërehet se botimi i letrave të tij nuk ka përfunduar. Vetëm viteve të fundit një hulumtues i pasionuar i arkivave, Albert Rama, ka njoftuar se në bashkëpunim me Universitetin e Gracit është duke përgatitur letërkëmbimin e plotë të Gustav Majerit me rilindësit shqiptarë.

Dhe tash si të shpjegohet qëndrimi jo dinjitoz i studiuesve shqiptarë ndaj personalitetit dhe ndihmesës së tij shkencore dhënë kulturës dhe historisë së shqiptarëve. Me një fjalë, ky qëndrim do shpjeguar me qëndrimin e përgjithshëm, që paten shqiptarët gjatë këtij shekulli që po e lëmë, ndaj trashëgimisë së brendshme dhe të jashtme kulturore e historike të tyre.

Bibliografia e tij

Në artikujt e përgjithshëm dhe të veçantë të studiuesve shqiptarë, ndihmesa e Majerit është cilësuar kryesisht si autor i *Fjalorit etimologjik* dhe i *Studimeve shqiptare*, në të cilat ai i ka botuar studimet etimologjike të shqipes, studime krahasuese, studime mbi fonetikën dhe gramatikën historike të shqipes, dokumente të shkrimeve të para, fjalorë, leksik, folklor (poezi dhe prozë), studime mbi letërsinë, bibliografi, tekste popullore dhe tekste fetare të përkthyer më parë, të gjitha këto të përcjella me komente dhe shënime etj., dhe si mik dhe bashkëpunëtor i rilindësve shqiptarë, por deri më tash, në këto shkrime asnjëherë nuk është ndonjë bibliografi shtruese e tij. Prandaj, pa pretenduar se do të bëjmë një punë të madhe rreth kësaj çështjeje, po i radhisim veprat e tij, që kapin ndihmesën e tij në fushë të albanologjisë, e që nuk lënë pa prekur edhe studimet në fushë të ballkanistikës dhe indoevropianistikës.

“Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache”. Strassburg: Trubner 1891, Verlag von Karl J. Trubner. 1891, pp. XIII+526. “Albanische Bibliographie”, pp. 516-524.

“ALBANESISCHE STUDIEN” I. Die Pluralbildungen der Albanesischen Nomina. Wien, 1883. In Commission bei Carl Gerold's Sohn, Buchhandler der kais. Akademie des Wissenschaften., In. – 8 de 108 pp.

“ALBANESISCHE STUDIEN” II. Die albanesischen Yahlvorter. Wien, 1884. In Commission bei Carl Gerold's Sohn, Buchhandler der kais. Akademie der Wissenschaften. In. 8 de 82 pp.

“ALBANESISCHE STUDIEN” III. Lautlehre der indogermanischen Bestandtheile des Albanesischen, Wien, 1892. In Commission bei F. Tempsky, Buchhändler der kais. Akademie der Wissenschaften. (A la fin:) Ausgegeben am 23 Jänner 1892.

“ALBANESISCHE STUDIEN” IV. Das griechisch-sudrumanisch-albanesische Wortverzeichniss des Kavalliotis, herausgegeben und erklärt. Wien, 1895. In Commission bei f. Tempsky, Buchhändler der kais. Akademie der Wissenschaften. (A la fin:) Ausgegeben am 20 September 1895. 127 pp.

“ALBANESISCHE STUDIEN” V. Beiträge zur Kenntniss in Griechenland gesprochenen albanesischen Mundarten. Wien, 1896. In Commission bei Carl Gerold's Sohn, Buchhändler der kais. Akademie der Wissenschaften. (A la fin:) Ausgegeben am 1 September 1896, 106 pp.

“ALBANESISCHE STUDIEN” VI. Beiträge zur Kenntniss verschiedener albanesischen Mundarten. Wien, 1897. In Commission bei Carl Gerold's Sohn, Buchhändler der kais. Akademie der Wissenschaften. (A la fin :) Ausgegeben am 30 September 1897.

“Kurzgefasst albanesische Grammatik (Mit Lesestücken und Glossar)”. Leipzig: Breitkopf und Hartel 1888, pp. XII + 105.

“Neugriechische Studien” II. Die slawischen, albanischen und rumänischen Lehnworte im neugriechischen. Wien, 1894. In Commission bei F. Tempsky, Buchhandler der kais. Akademie der Wissenschaften. Druck von Adolf Helzhausen, k. und k. Hof- und Universitäts Buchdrucker in Wien. Ausgegeben am 27 Apr. 1894, pp. 104.

“Albanische Märchen übersetzt”, Anmerkungen von Reinhold Kohler, 1881.

“Albanisches Lied”. In: “Yum 24. Juni 1890 begrüßten Reinhold Kohler vier Grazer Freunde. In Eile”. 4 Blt. 4.

“Zum indogermanischen e – Perfektum”. - “Indogermanischen Forschungen”, Strassburg, 1895. V. Bd. S. 180-182 betrifft ausschl. Das Albanesische.

“Türkische Studien” I. Die griechischen und romanischen Bestandteile im Wortschatz des Osmanisch-Türkischen. Wien 1893.

“Gli albanesi nella storia e nella letteratura”, në La sicilia litteratura, 1888.

“Della lingua e della letteratura albanese”, në La Nuova Antologia, Roma, Via del Corso, n. 466, numero du 15 04. 1885. Pp. 585-607.

“Über die Sprache und Literature der Albanesen”. In: Nord und

Süd, Hsg. Von Paul Lindau, XXIV. Band, Februar 1883.- 71 Heft. Breslau 1883, S. 211-226; Gustav Meyer, Essays und Studien. zur Sprachgeschichte und Volkskunde. Strassburg 1885, S. 49-90.

“Essays und Studien”, Zur Sprachgeschichte und Volkskunde. Strassburg 1885; III. Über die Sprache und Literatur der Albanesen, S. 49-90; IX. Der Pathe des Todes, S. 245-250; Siche it. Übersetz.; Della lingua e letteratura albanese. Nuova Antologia (Roma), 15 April 1885.

“Drei toskische Märchen. Hochzeitslieder aus Korytza. In: G. M. Kurtzgefasste albanesische Grammatik mit Lesestücken und Glosar. Leipzig 1888, S. 57-67, S. 75-77.

“Zwei albanesische Lieder aus S. Marzano. In: Zeitschrift für Romanische Philologie. Hsg. Von Dr. G. Grober, XV. Bd. Halle 1891, S. 549-550.

“Die albanesischen” Tanzlieder in Byrons Childe Harold. Anglia 15, N. F. 3, 1-8.

“Zum den mittelgriechischen Sprichwörtern. In: Byzantinische Zeitschrift. Hsg. K. Krumbacher. III. Bd. Jhg. 1894. Leipzig 1894, S. 396-408, bsd. 401-408.

“Fabeln, Märchen, Erzählungen und Schwanke. (In: Albanesische Studien V.) Wien, 1896, S. 6-66.

“Sprichwörter und sprichwortliche Redensarten aus Skutari; Lieder. In: Albanesische Studien VI, Wien, 1897, S. 5-114.

“Die lateinischen Elemente im Albanesischen. (In: Grobers Grundriss der romanischen Philologie) I J. Auflage , 1888.

“Der Einfluss des Lateinischen auf die albanesische Formenlehre” In: Miscellenca di filologia e linguistica in memoriam di Napoleone Caix e Angelo Canello. Firenze 1886 pp. 101-111.

“Die Stellung des Albanesischen im Kreise der indogermanischen Sprachen”, In: Beiträge zur Kunde der idg. Sprachen 8 . Graz, 1884.

“Über Sprache und Literatur des Albanesen” (In: Nord und Süd) 24. 1883.

“Zur älteren Geschichte der Albanesen” (In: Zeitschrift für allgemeine Geschichte), Stuttgart 1884.

“Das Verbum substantivum im Albanesischen” (Philologische Abhandlungen für Herty). 1888.

“Die Albanesen”. Neue Freie Presse, 12. Juni. 1880.

“Albanesisches”. Allgemeine Zeitung Beil. 142, 22 Mai 1881.

“Über Sprache und Literatur der Albanesen”. “Nord und Süd”, 24. Februar 1883, 211-226. (Vgl. Nr. 9, S. 49-90).

“Zur älteren Geschichte der Albanesen”. Zeitschrift für allgemeine Geschichte 9. Heft 1884, 667 ff. (Vgl. Nr. 9, S. 49-90).

“Ein albanesisches Memorandum”. Tagespost 5, November, 1885.

“Die Albanesen”. I. Österr. -ungar. Revue, Juli 1886.

“Die Albanesen”. II. Österr. -ungar. Revue, Oktober 1887.

“Butrinto”. Schl. Zeitung . 27 Mai. 1888.

“Bei den Albanesen Apuliens”. Neue frei Presse .8. Mai. 1890. (Vgl. Nr. 17, Kap. 20).

J.U. Jarnik, Zur albanischen Sprachenkund. (Leipzig 1881) Lit., Centralbl. 42. (Rez.).

Kuluriotis, Αλβανικον αλφαβηταριον. Lit. Centralbl. 9 (1883). (Rez).

Kuluriotis, Αλβανικον αλφαβηταριον. Phil. Wochenschrift 31/32. 1884. (Rez).

J. U. Jarnik, Prispěvky ku poznání nářečí albánských. (Beiträge zur Kenntnis alban. Mundarten), Prag 1883. (Rez) Arch. Trad. Pop. III. 146 ff.

P.W., Grammaire albanaise (London 1887). Lit. Centralbl, 50 (Rez).

H. Pedersen, Albanesische Texte. (Leipzig 1895). Lit. Centralbl. 47. (Rez.).

Jung, Kleines albanesisch-lateinisches Wörterbuch (Skutari 1895). Lit. Centralbl. 47. (Rez).

Pisko, Kurzgefaßtes Handbuch der nordalbanesischen Sprache. (Wien 1896). Phil. Wochenschrift 1. (Rez).

“Neugriechische Studien”, I, Wien, 1894.

“Neugriechische Studien”, III, IV, Wien, 1895.

“Türkische Studien”, Wien, 1893.

LIDHJE TË REJA TITAN-QELQ

Studiuesit në California Institute of Technology kanë realizuar një gamë materialesh prej përbërjes metal-qelq me bazë titani që janë më të lehtë dhe më pak të kushtueshëm se çdo material tjetër i prodhuar më parë duke ruajtur të njejtat karakteristika si qendrueshmëria dhe elasticiteti.

Qysh në fillim të vitit, ky grup nga Caltech publikoi një punim në revistën *Nature* ku përshkruheshin strategji të reja për përfitim dhe përbërjeve lëng-metal. Ky studim i dha jetë “lidhjeve me karakteristika të jashtëzakonshme rezistence” shpjegon Douglas Hofmann, bashkëautor i artikullit të publikuar së fundi edhe nga revista *Proceedings of the National Academy of Sciences* (PNAS).¹

Në lidhjet e paraqitura në periodikun shkencor *Nature* kishte disa mangësi: meqë ishin krijuar për industrinë aerospaciale dilte nevoja e arritjes së dendësive shumë të ulëta.

Kështu, Hofmann dhe kolegët William Johnson e Ruben F. filluan perfeksionimin e komponentëve të lidhjeve të tyre duke arritur të përftojnë mostra me përqindje të lartë titani dhe që ruanin karakteristikat e mëparshme: rezistojnë më shumë në tërheqje, janë më shumë elastike dhe kanë një peshë specifike 4,5-5 gr/cm³ kur lidhja e mëparshme e zirkonit kish një peshë prej 5,6-6,4 gr/cm³.

Ulja e peshës specifike pati si rezultat edhe uljen e koston qysh nga momenti që zirkoni është më i shtrenjtë se titani.

Elementet kimike: emërtimi, etimologjia dhe drejtshkrimi i tyre

1. Botëkuptimi për elementet dikur dhe sot

Që nga Antika, zbulimi, identifikimi dhe veçimi i elementeve kimike është kuptuar si çështje fundamentale për shkencën. Emërtimi i elementeve ka filluar që nga civilizimet e lashta, nga persët, egjiptianët, grekët, romakët dhe indianët parakolumbianë. Por ata kishin tjetër koncept për atë që ne sot kuptojmë me elemente. Me mijëra vjet me elemente janë nënkuptuar: *toka*, *ajri*, *zjarri* dhe *uji*, katër elemente të Empedokliut (Sicili, 495-430 p.e.r.) të njohura nga Aristoteli, të cilat të përziera në përpjesëtime të caktuara “jepnin” materien (substancën) e caktuar. Këto elemente kanë të bëjnë me atë që ne sot quajmë *gjendje agregate të materies: e ngurtë, e lëngët dhe e gaztë*, duke e shtuar edhe *plazmën*, por të ndryshme nga ato. Ndërkaq, sipas mendimit të filozofit grek Epikur (vdekur më 270 p.e.r.), të bazuar në atomizmin e Demokritit dhe Leukipit, materia nënkuptohej si një grumbull atomeesh pafundësisht të vogla të cilat me kombinimin e tyre të rastit krijojnë universin (gjithësinë) dhe se ndryshimet fizike dhe kimike shkaktoheshin nga lëvizja e atomeve. Llojet e atomeve nuk jepeshin, por thuhej se ishin të mjaftueshme për të krijuar llojet e ndryshme të gjësëndeve.

Botëkuptimi ynë për elementet kimike është i ri, ndaj kur flitet p.sh. për “bakrin” në kohët e lashta, kemi të bëjmë në fakt me bronzin, i cili përmban kallaj por edhe plumb e zink. Kjo bën që ngandonjëherë të ngatërrohen elementet (metalet) e ndryshme, ose që të kemi zhvendosje të kuptimit. Kështu p.sh., “plumbit (Pb)” serbisht i thonë *olovo*, e me *olovo* në rusisht nënkuptohet “kallaji (Sn)” (plumbit në rusisht i thonë *svinec*, njësoj si në sllovenisht). Nga ana tjetër me *m(j)ed* rusët e bullgarët nënkuptojnë “bakrin” e kroatët e serbët nënkuptojnë “bronzin”.

Në kohën antike kanë qenë të njohur shtatë trupa të mëdhenj qiellorë të sistemit tonë diellor dhe me to janë lidhur shtatë elementet (metalet) e njohura në atë kohë: *Dielli – ari*, *Merkuri – zhiva (merkuri)*, *Venera – bakri*, *Marsi – hekuri*, *Hëna – argjendi*, *Jupiteri – kallaji*, *Saturni – plumbi*.

Disa nga këto elemente i hasim edhe në Bibël: Numrat, Kap. 31-22/23: “Vetëm *arin*, *argjendin*, *bronzin*, *hekurin*, *kallajin* dhe *plumbin*, çdo gjë që i reziston zjarrit, do ta kaloni nëpër zjarr dhe do të bëhet i pastër.” Jobi, Kap. 28-2: “*Heku-*

ri nxirret nga toka dhe guri i shkrirë jep *bakrin*.” Psalmi 10(11)-6: “Ai do të bëjë që të bien mbi të pabesët leqe, zjarr, *squfur* dhe erëra zhuritëse.” (Dhjata e vjetër, 1994, www.shqiptarortodoks.com)

Eksperimentet kuantitative të fundshekullit XVIII, të priera nga kimisti francez Lavuazie (Antoine Lavoisier) paraqesin fillimet e teorisë moderne atomike: *oksigjeni*, *hidrogjeni*, *merkuri*,

karboni dhe substanca të tjera kundrohen si të pandashme në substanca të tjera më të thjeshta. Ky botëkuptim për elementin, d.m.th. që duhet të jetë homogjen për nga vetitë e tij dhe të mos jetë i ndashëm në elemente të tjera më themelore ka qenë në përdorim po thuajse deri në fund të shekullit XIX.

Përkufizimi i sotëm i *elementit*, i përdorur nga Unioni Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (*International Union for Pure and Applied Chemistry, IUPAC*), bazohet në modelin atomik, sipas të cilit elementi është i përcaktuar me numrin e tij atomik (*Z*) apo numrin e ngarkesave pozitive (protonëve) në bërthamë.

2. Emërtimi i elementeve kimike dhe drejtshkrimi i emrave të tyre

Sot, IUPAC, ndër të tjera, është përgjegjës edhe për emërtesën (nomenklaturën) e elementeve kimike. Në pajtim me traditën, elementet emërtohen sipas: a) një koncepti ose një figure mitologjike (përfshirë trupat qiellorë); b) një minerali ose një substance të ngjashme; c) një vendi ose një rajoni gjeografik; ç) një vetie të elementit përkatës; ose d) një shkencëtar.



Mendelejevi (Portret nga Ilya Repin, 1885)

Për shkak të koherencës gjuhësore, elementet e reja mbarojnë me “-ium”. Nga viti 1994, është e ndaluar të emërtohet një element sipas një personi të gjallë. Më 1951 dhe më 1953 *ajnshtajniumi* (Es) dhe *fermiumi* (Fm) janë emërtuar kështu për të gjallë të Ajnshtajnit dhe Fermiut, përkatësisht.

Nga ana tjetër, emri zyrtar i secilit element kimik është i shoqëruar me një simbol zyrtar, të formuar ose nga njëra prej 26 shkronjave të mëdha të alfabetit latin, ose nga dy pre 26 shkronjave të alfabetit latin me shkronjën e parë të madhe dhe të dytën të vogël të emërimit zyrtar të emrit në latinisht, si: Au “ar” (lat. *aurum*), C “karbon” (lat. *carbon*), Cu “bakër” (lat. *cuprum*), Fe “hekur” (lat. *ferrum*), I “jod” (lat. *iod*), P “fosfor” (lat. *phosphorum*), Sb “antimon” (lat. *stibium*), Sn “kallaj” (lat. *stannum*), Hg “merkur (zhivë)” (lat. *hydrargyrum*), Xe “ksenon” (lat. *xenon*) etj. Nga 111 elemente kimike emrat e të cilëve janë zyrtarizuar nga IUPAC-u, me simbol njëshkronjës janë 13 elemente (elementet B, F, H, I, K, N, O, P, S, U, V, W, Y) dhe me simbol dyshkronjës janë 98 elemente (elementet e tjera). Përdorimi i kësaj simbolike është tejet praktik si për të shkruar formulat atomike të molekuleve, ashtu edhe për të përshkruar reaksionet kimike.

Në fund, simbolet e përkohshme të formuara nga 3 shkronja, ku një shkronjë e madhe pasohet nga dy shkronja të vogla, shërben për të shkurtuar emrin sistematik të përkohshëm të dhënë një elementi në pritje të emërimit të tij me një emër zyrtar. Simbole trishkronjës tash për tash janë 7: Uub (112 Ununbium “Njënjëdy”), Uut (113 Ununtrium “Njënjëtre”), Uuq (114 Ununkuadrium “Njënjëkatër”), Uup (115 Ununpentium “Njënjëpesë”), Uuh (116 Ununheksium “Njënjëgjashtë”), Uus (117 Ununseptium “Njënjësttë”) dhe Uuo (118 Ununoktium “Njënjëtetë”).

Gjermanishtja e rusishtja, po dhe kroatishja dhe disa gjuhë të tjera i kanë përkthyer nga latinishtja disa nga emrat e elementeve kimike, si p.sh.: shqip *hidrogjen* (H) < lat. *hydrogenium* “lindës uji” –: gjerm. *Wasserstoff*, rus. *vodorod*, kroat. *vodik*; shqip *oksigen* (O) < lat. *oxygenium* “lindës acidi” – gjerm. *Sauerstoff*, rus. *kislorod*, kroat. *kisik*; shqip *karbon* (C) < lat. [*carboneum*] – gjerm. *Kohlenstoff* dhe rus. *uglerod* “lindës thëngjilli”, kroat. *ugljik*.

Shqipja, sikurse edhe gjuhët e tjera, ka huazuar fjalë jo vetëm nga gjuha e pushtuesve, por edhe nga gjuhët e popujve me të cilët është takuar gjatë historisë së saj dymijëvjeçare, si nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja, turqishtja. Një numër fjalësh të huazuara tashmë janë pronë e shqipes dhe nuk ndihen si të huaja [Caka 2006]. Të tilla janë edhe ato që shënojnë emrat e elementeve të njohura që nga lashtësia, si: *ar*, *argjend*, *bakër*, *kallaj*, *plumb*, *squfur*.

Në disa gjuhë drejtshkrimi i emrave të elementeve kimike të caktuara ndjek ngandonjëherë një model të caktuar. Kështu, p.sh., në anglishte emrat e të gjitha metaleve alkaline mbarojnë më -ine: *fluorine* (F), *chlorine* (Cl), *bromine* (Br),

iodine (I), *astatine* (At), ndërkaq emrat e gazeve të plogëta mbarojnë me -on (sikurse edhe në shqipe): *argon* (Ar), *krypton* (Kr), *radon* (Rn), *xenon* (X), përveç atij të *helium*-it (zbuluesi ka menduar se ka identifikuar një gaz, ndaj ia ka vënë edhe emrin që mbaron me -ium, mbaresë kjo e rezervuar në atë kohë për metale).

Në gjuhën shqipe është ruajtur tradita e shkrimit të emrave të vjetër, si *ar*, *argjend*, *plumb*, *squfur* etj. ndërsa emrat e elementeve të emërtuara pas shekullit XVII kanë ruajtur kryesisht emërtimin në gjuhën latine me ndonjë përshtatje të vogël në gjuhën shqipe, por nuk ka ndonjë konsistencë në drejtshkrimin e tyre. Kështu, p.sh. derisa në latinisht 87 emra (nga gjithsej 111) mbarojnë me -ium, në anglishte 74, në frëngjishte 69, në gjermanishte 66; ose me ‘variantet’ e saj: -ijum në serbisht 70, -jum në turqishte 64, -ij në kroatish 74 dhe në rusisht 70, -io në italishte 84 dhe në spanjishte 76 etj., në shqipe vetëm 51 emra të elementeve mbarojnë me -ium, që është 36 më pak se në latinisht, apo 23 më pak se në anglisht. Pra, është bërë ‘shqipërimi’ i këtyre emrave, edhe pse jo plotësisht, si në polonisht, ku emri i asnjë elementi nuk mbaron më -ium, ose ndonjë variant të saj. Kështu emrat *astat*, *bor*, *brom*, *gadolin*, *irid*, *niob*, *rubid*, *silic*, *selen*, *titan* e *vanad* dallojnë nga emrat përkatës në latinisht vetëm se këta të dytët kanë edhe nga një *ium* në fund. Këtij grupi i përkasin edhe emrat *europ* e *americ*, të cilët hasen të shkruar edhe si *europium* e *americium* (të emërtuar kështu sipas kontinenteve Europa dhe Amerika); trajtat e emrave me -ium janë më të drejta nga aspekti etimologjik, meqë në to ruhet motivimi i emërimit. Nga ana tjetër edhe emri *neptun* do të duhej të shkruhej si *neptunium*, jo vetëm për të mos e ngatërruar (në shqiptim) me planetin Neptun, por edhe për shkak të koherencës me dy emrat e tjerë që kanë të njëjtin motivim të emërimit: *uranium* e *plutonium* (shih më poshtë!). Po ashtu edhe emri për elementin Md do të duhej të ishte *mendeleevium*, siç është në shumicën e gjuhëve, madje edhe në rusisht (atdheun e shkencëtarit sipas të cilit e ka marrë emrin), e jo *mendelejevium*, që është madje edhe i vështirë për shqiptim. Mospërputhje në disa raste kemi madje edhe ndërmjet “Fjalorit drejtshkrimor” (FD) dhe “Fjalorit të kimisë” (FK), të dytë të redaktuar nga A. Kostallari, si: *astatin* (FK) – *astat* (FD), *europ* (FK) – *europium* (FD), *tehne* (FD) – *teknec* (FK), ku trajtat e dyta janë ato që duhen përdorur. Në “Fjalorin drejtshkrimor” janë dhënë gabim edhe simbolet e disa elementeve si: P për Pm (*promet*), J për I (*jod*).

3. Klasifikimi i emrave të elementeve kimike sipas mënyrës së emërimit

a) Elemente me emra të lashtë

– Elemente (metale) të njohura që nga kohët parahistorike: *ar*, *argjend*, *bakër*, *hekur*, *kallaj*, *plumb*.

– Elemente, të njohura si të tilla që nga Perandoria Ro-

make deri në shekujt XV/ XVI: *antimon*, *arsenik*, *bismut*, *karbon*, *squfur*, *zhivë* (= *merkur*).

b) Elemente të emërtuara sipas mineraleve dhe xeherorëve

– Elemente të emërtuara me emra që nuk bazohen në fjalë latine: *kobalt*, *nikel*, *volfram*, *zink*.

– Elemente të emërtuara sipas një kombinimi në të cilin elementi është përbërës kryesor: *alumin*, *berilium*, *bor*, *litium*, *kadmium*, *kalcium*, *kaliun*, *natrium*, *silic*, *zirkonium*.

– Elemente të emërtuara sipas elementeve të tjera: *molibden*, *platin*, *protaktin*, *radon*.

c) Elemente të emërtuara sipas një vetie

– Vetë kimike: *argon*, *astat*, *azot*, *hidrogjen*, *oksigen*, *fluor*.

– Vetë fizike: *aktin*, *barium*, *fosfor*, *radium*.

– Ngjyra e avullit, kripës etj.: *irid*, *jod*, *klor*, *krom*, *rodium*.

– Ngjyra e spektrit: *indium*, *ceziu*, *rubid*, *taliun*.

– Kundërmimi (era): *brom*, *osmium*.

– Disponueshmëria (arritshmëria): *dizproz*, *kripton*, *kse-non*, *lantani*, *teknec*.

– Lidhja me elementet e tjera: *neodim*, *neon*, *prazeodim*.

ç) Elemente të emërtuara sipas një toponimi

– Qytet, rajon, shtet ose kontinent: *americium*, *berkelium*, *darmshtatium*, *dubnium*, *erbiun*, *europium*, *francium*, *germanium*, *hafnium*, *hasium*, *holmium*, *itrium*, *kalifornium*, *lutece*, *magnez*, *mangan*, *polonium*, *renium*, *ruten*, *skandium*, *stroncium*, *terbium*, *tulium*.

– Trup qiellor: *cerium*, *helium*, *merkur* (= *zhivë*), *neptunium*, *plutonium*, *selen*, *telur*, *uranium*.

d). Elemente të emërtuara sipas një emri vetjak

– Të një figurë mitologjike: *niob*, *promet*, *titan*, *torium*, *vanad*.

– Të një personi që ia ka dhënë emrin një minerali ku është gjetur elementi: *gadolin*, *samarium*.

– Të shkencëtarit i cili e ka zbuluar elementin ose për nder të tij: *ajnshtajnum*, *borium*, *fermium*, *kyrium*, *majtnerium*, *nobelium*, *radhërfordium*, *rëntgenium*, *siborgium*.

4. Etimologjia e emrave të elementeve kimike

Më poshtë jepet etimologjia e emrave të 111 elementeve kimike të emërtuara (nga gjithsej 118 të njohura). Secili element jepet si zë më vete. Pas emrit të elementit jepet simboli i tij, i paraprirë me një numër të vogël, i cili tregon numrin atomik të elementit (Z). Numri atomik (Z) është numri i protoneve në bërthamën e atomit të elementit të caktuar. Kështu p.sh. $_{13}\text{Al}$ paraqet aluminin, i cili e ka masën atomike 13, ndaj dhe gjendet në vendin e 13-të të Tabelës periodike të elementeve kimike.

Shkurtesat: gr. – greqisht, lat. – latinisht, arab. – arabisht, pers. – persisht, gjerm. – gjermanisht.

Ajnshtajnum-i ($_{99}\text{Es}$) – Është quajtur kështu sipas fizikanit (e pacifistit) amerikan, me origjinë hebreje, *Albert Ein-*

stein, themeluesit të Teorisë së relativitetit, të vdekur pak kohë (1955) pas zbulimit të këtij elementi (nga Albert Ghiorso) në mbetjet e shpërthimit të bombës së parë termonukleare a hidrogjenike (në Oqeanin Paqësor, më 1952).

Aktin-i ($_{89}\text{Ac}$) – Emri i tij vjen nga gr. *aktinos* “rrezatim”, për shkak të rrezatimit radioaktiv (grimcave alfa) që lëshon (emeton) ky element. Me emër të përbashkët “*aktinide*” quhen elementet me numër atomik 89 deri në 103.

Alumin-i ($_{13}\text{Al}$) – Emri i tij vjen nga lat. *alun* > *alumen* “i hidhur, i hidhët”, për shkak të shijes së hidhët (si të sapunit) të “gurit të shapit” (sulfat i dyfishtë i aluminut dhe kaliumit; në fr. *alun* “shap, stipës”), të përdorur si regjës (për lëkura) në Mesjetë.

Americium-i ($_{95}\text{Am}$) – Është quajtur kështu sipas kontinentit *Amerika*, sepse është veçuar në SHBA, dhe në analogji me *europiumin* (emërtuar sipas kontinentit Europa), me të cilin americiumi ka shumë veti kimike të përbashkëta. Vetë emri *Amerika* (*America*) rrjedh nga emri i njërit ndër eksploruesit e parë të këtij kontinenti, italianit *Amerigo Vespucci*.

Antimon-i ($_{51}\text{Sb}$) – Emri i tij supozohet se rrjedh nga gr. *anti-monos* “jo i vetëm”, nga fakti se ky element (metal) është gjetur gjithmonë i shoqëruar me metale të tjera. Antimoni njihet që nga antikiteti. Simboli Sb për antimonin vjen nga emri i tij latin *stibium*, që rrjedh nga emri i mineralit *stibnit* (tresulfur antimoni, Sb_2S_3), prej të cilit përftohet një pudër kozmetike, e quajtur kështu nga gr. *stibni* “shenjë, njollë”, për shkak se ky mineral është përdorur si pigment i zi.

Ar-i ($_{79}\text{Au}$) – Emri i tij vjen nga latinishtja (etruskishtja) *aurum* (*ausom*) që do të thotë “i verdhë” (e krahasueshme me sanskrishten *hari* “i verdhë”), por dhe “i shndritshëm, shkëlqyes”, e krahasueshme me *aurora* (*ausosa*) “flakërimi i mëngjesit, agu i mëngjezit”. Edhe anglishtja *gold* “ar” lidhet me “shkëlqyes, i verdhë” (*gold* < **gelwa* “i verdhë” < sanskritishtja *jval* “shkëlqim”); me këtë kuptim lidhet edhe emri *zlato* “ar” në gjuhët sllave. Ari njihet që nga lashtësia, dhe supozohet që është metali i parë që e ka përdorur njeriu. Fjala *ar* në shqipe del qysh më 1555, te Buzuku: “*Përse tek anshtë ari e vistari* [= visari “thesari”] *uit, aty anshtë edhe zemëra jote*” (f. XLI/2, Matheu Kapitulli VI/21). Te Bardhi (1635) kemi: *Aurum* – *Aar* [Blanchum 1635]. Për “ar” në shqipe përdoret edhe fjala *flori* < it. *fiorino*, e cila fillimisht është përdorur në kuptimin e një monedhe mesjetare, e më vonë u përdor edhe si emërtim për metalin “ar”.

Argon-i ($_{18}\text{Ar}$) – Emri i tij vjen nga greqishtja *argos* “joveprues”, për shkak se argoni është një gaz shumë inert (i plogët), joveprues, i cili nuk formon komponime valence me asnjë element.

Argjend-i ($_{47}\text{Ag}$) – Emri i tij vjen nga lat. *argentum* < gr. *arguros* “i shndritshëm, i shkëlqyer”, për shkak të pamjes fizike të tij. Argjendi është ndër metalet e para dhe më së shumti të përdorura për punimin e monedhave dhe emri i tij në shumë

gjuhë shënon edhe “paratë”, “të hollat” të çfarëdo lloji, si në frëngjisht: “*j'ai de l'argent*” = “kam para”. Në Amerikën Latine *plata* “argjend” ka kuptimin edhe të “parave”, edhe pse në Spanjë për këtë përdoret fjala *dinero* (me prejardhje nga arabishtja). Fjalën *rgjand* “argjend” për *argentum* të latinishtes e hasim që te Budi: “*Posikuur ari oo rgjandi provohet, e mirë munë njihet*” (Budi, SC 1621: 278). Te Bardhi kemi: *Argentum* – *Rgiand* [Blanchum 1635].

Arsenik-u ($_{33}\text{As}$) – Është quajtur kështu sipas lat. *arsenicum* “pigment i verdhë në portokalli (ngjyrë limoni)”, me origjinë nga minerali “orpiment” (tresulfur arseniku, As_2S_3) < lat. *auripigmentum* “pigment i arit” < pers. *az-zarnikh* (*zar* “ar”), të cilin grekët, romakët dhe persët e vjetër e përdornin si ngjyrues ose për mjekim. Si element arseniku është veçuar së pari më 1250. Emri i arsenikut në anglishte haset për herë të parë si: arsenik i verdhë (*yellow arsenic*), më 1386; si arsenik i kuq (*red arsenic*), më 1591 dhe si arsenik i bardhë (*white arsenic*), më 1605. Fjala “arsenik” përdoret ngandonjëherë për të treguar edhe “trioksidin e arsenikut”; për këtë arsye, në Kosovë për arsenin elementar (As) përdoret edhe termi *arsen*, si në gjermanishte, serbishte, bullgarishte, rumanishte e në disa gjuhë të tjera.

Astat-i ($_{85}\text{At}$) – Emri i tij vjen nga gr. *astatos* “i paqëndrueshëm”, për shkak të karakterit të paqëndrueshëm të të gjitha izotopeve të tij, të cilat janë radioaktive.

Azot-i [nitrogjeni] ($_{7}\text{N}$) – Emri *azot* është zgjedhur nga Antoine Lavoisier dhe vjen nga gr. *azotos*, *azotikon* “i pajetë”, për shkak të shfaqjes së asfiksise (vështirësimit ose ndalimit të frymëmarrjes) te qeniet e gjalla në prani të këtij elementi. Emri tjetër për azotin, *nitrogen* (prej nga simboli N) vjen nga lat. *nitrogenium* < gr. *nitron gennan* “lindës/përfutës salpetri (nitrati kaliumi KNO_3)”; *nitrat* < gr. *nitron* “salpetër” < egjipt. *ntr* [Harper, 2001].

Bakër, bakri ($_{29}\text{Cu}$) – Emri i tij vjen nga turqishtja *bakır*, e kjo nga lat. *cuprium* (prej nga simboli Cu) < *aes Cyprium* “tunxh (bronz) Qiproje”, turq. *Kıbrıs tuncu*, prej nga me metatezë *bakır* (< *kipar*) ; që të dyjat nga gr. *Κυπρος* [Kypros/Kipros/Kypros] “ishulli Qipro”, ku ka pasur miniera të bakrit që në kohën parahistorike. I së njëjtës origjinë është edhe emri për “bakër” në frëngjishte *le cuivre*, në anglishte *copper* e në shumë gjuhë të tjera. Nga turqishtja, emërtimi për “bakrin” ka kaluar, përveç në shqipe, edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit, si në serbishte *bakar*, në arumanishte *băcră*, në gr. e re *mpakri* etj. [Matasovic 2007]. Vetë ishulli Qipro e ka marrë emrin nga drunjtë e tij të shumtë halorë mesdhetarë *qiparis* (= selvi) < gr. *kuparissos*. “Barasvlerësi” grek i *Cyprium aes* ka qenë *χαλκος κυπριος* [*chalkos kuprios*], prej nga rrjedh emri i sotëm i bakrit në greqishte *χαλκος* (sipas minierave të bakrit në Chalcis të Euboeas). Në fjalën *halkopirit* “piriti i bakrit”, *halko* shënon “bakrin”. Fjala *halkos* në greqishte është përdorur edhe për “hekurin”, shumë kohë para se të krijohet fjala

“*sideros*”, e cila sot shënon hekurin. Në shqipe për “bakër” përdoret edhe fjala **rem**, nga lat. *aeramen*, *aramen* ose nga it. *rame*, e cila del që te Buzuku: “*E të nthenj dyertë n rembje* [= prej bakri], *e dryenëtë n hekuri t i këputinj*.” (XXXII/2, Isai, Kapitulli 45/2, E. Çabej, Botim kritik, Prishtinë, 1987).

Barium-i ($_{56}\text{Ba}$) – Emri i tij vjen nga gr. *baris* “i rëndë”, meqenëse oksidi i tij, “toka bariore” a minerali *barit* (hidroksid bariumi) është më i rëndë se tokat e tjera alkaline; vetë bariumi, përkundrazi, është më i lehtë se metalet e tjera.

Berilium-i ($_{4}\text{Be}$) – Emri i tij vjen nga emri i mineralit *beril* (silikat i beriliumit dhe aluminit), emri i të cilit rrjedh nga lat *beryllus* < gr. *berullos* “i gjelbër”, për shkak të ngjyrës së gjelbër të fortë të gurit të çmuar *smerald*, i cili është një modifikim i tij. Kristalet e tejdukshme prej berili janë përdorur nga grekët e vjetër edhe si “qelq zmadhues” (syzat e para), prej nga rrjedh edhe emri për “syza”, *Brille* në gjermanishte dhe *besicles* < fr. vj. *bericle* në frëngjishte. Emri i vjetër i beriliumit ka qenë **glucinium** (Gl), që vjen nga gr. *glukus* “sheqer”, për shkak të shijes së ëmbël të shumë kripërave të beriliumit. Pra, nuk duhet të ngatërrohet *beriliumi* (element) me *beril* (mineral i beriliumit).

Berkelium-i ($_{97}\text{Bk}$) – Është quajtur kështu sipas qytetit të vogël *Berkeley* në Kaliforni të SHBA-së, universiteti i të cilit ka kontribuar shumë për zbulimet kimike dhe ku është i vendosur laborator i njohur Lawrence, ku është zbuluar ky element radioaktiv. Emërtimi i tij ka ndjekur po ashtu modelin e emërimit të elementeve të serisë së lantanideve sipas qyteteve të vogla (edhe Ytterby, sipas të cilit është emërtuar një elementi tjetër i kësaj serie, *terbiumi*, është po ashtu qytet i vogël).

Bismut-i ($_{83}\text{Bi}$) – Emri i tij vjen nga fjala gjermane *Wismuth*, e cila është përngjitje e fjalëve *Wies* “Wiesen” (vend në Gjermani) dhe *Mutung* “minierë”, dhe me shndërrim të pastajmë të *w* në *b* gjatë latinizimit të dokumenteve gjermane. Por mund të jetë edhe: *bismut* < lat. *bisemuntum* (v. 1530) < gjerm. *Wissmuth* “masë e bardhë”. Bismuti përmendet me këtë emër së pari në një dokument gjerman më 1472, por një kohë të gjatë ai nuk është njohur si element i veçantë dhe shpesh është ngatërruar me kallajin ose plumbin. Bismuti është pranuar si element më vete më 1753.

Bor-i ($_{5}\text{B}$) – Emri i tij vjen nga *boraks*, një oksid bori që njëhej që në antikitet, emri i të cilit rrjedh nga arab. *bawraq* < pers. *boûraq* “i shkëlqyer, i shndritshëm”. Bori kristalor ka fortësi të madhe dhe radhitet i dyti, menjëherë pas diamantit (karbonit), për këtë arsye një kohë të gjatë është menduar se bori është një formë e karbonit (emri *boron* në anglishte për “borin” mund të interpretohet si *borax* + *carbon*).

Borium-i ($_{107}\text{Bh}$) – Është quajtur kështu për nder të fizikanit danez Niels Bohr, i cili ka propozuar një model të atomit të bazuar në teorinë e kuanteve të Max Planck-ut dhe ka parashikuar (bazuar në këtë model) një numër të caktuar të vetive të elementit hafnium ($_{72}\text{Hf}$). Për “boriumin” më parë ka qenë

Francium-i ($_{87}\text{Fr}$) – Është quajtur sipas emri latin të Francës, *Francia*, për nder të atdheut të zbulueses së këtij elementi (më 1939), Marguerite Perey.

Gadolin-i ($_{64}\text{Ga}$) – Është quajtur sipas mineralit *gadolinit*, nga i cili nxirret ky metal i tokave të rralla, quajtur kështu sipas kimistit finlandez *Johan Gadolin*, i cili ia ka kushtuar tërë jetën e vet studimit të “tokave të rralla” a lantanideve (Gadolini i ka veçuar të gjitha elementet e tokava të rralla, si terbiumin, itrium-in etj.).

Galium-i – Është quajtur sipas emrit të lashtë latin të Francës, *Gallia*. Thuhet edhe se francezi Paul Emile Lecoq de Boisbaudran, i cili e ka veçuar (më 1878) këtë metal e ka quajtur atë sipas fjalës lat. *gallus* (fr. *le coq*) “gjel”, sipas mbiemrit të vet.

Germanium-i ($_{32}\text{Ge}$) – Është quajtur sipas emrit të lashtë latin të Gjermanisë, *Germania*, meqenëse është veçuar (më 1886) në Freiberg, të Saksonisë/Gjermanisë, nga kimisti gjerman C.A. Winkler. Thuhet se Winkleri e ka quajtur me emër të Gjermanisë për t’ia kundërvënë këtë galiumit, të quajtur sipas Francës (tetë vjet më parë).

Hafnium-i ($_{72}\text{Hf}$) – Është quajtur sipas *Hafnia*, emri i lashtë latin i Kopenhagës, kryeqytetit të Danimarkës dhe vendit ku është veçuar ky element.

Hassium-i ($_{108}\text{Hs}$) – Është quajtur sipas emrit të lashtë latin të landit gjerman Hessen, *Hasia*, ku gjendet qyteti Darmstadt ku është zbuluar ky element.

Hekur-i ($_{26}\text{Fe}$) – Ndër etimologji të shumta e të pasigurta për emrin e këtij metali në shqip, si shpjegim më i drejtë mbetet ai i Norbert Joklit (i kumtuar me gojë Eqrem Çabejt) se *hekur* vjen prej gr. *ἀγκυρα/ankura* “spirancë”, me metaforë *a:e* që duket se rrjedh nga shumësi, pra hekur do të jetë një shumës i singularizuar [Çabej 1986]; këtu mbetet i pasqaruar përfundimi i *h-së* nistore. Nga gr. *ankura* “spirancë” rrjedh edhe fjala latine *ancora*, *anchora* po me të njëjtin kuptim, si dhe fjalët përkatëse në fr. *ancree*, angl. *anchora*, gjerm. *Anker* e në disa gjuhë të tjera, e supozohet se edhe emri i kryeqytetit të Turqisë, *Ankara* e ka po këtë etimologji. Që hekuri ka lidhje me “spirancën” dëshmon edhe fjala kroate *sidro* “spirancë”, që rrjedh nga gr. *sideros* “hekur” apo dhe fjala turke *demir* (në: *çemi demiri*) “hekur” (si në shqipe: *hekuri i anijes*) me domethënie “spirancë”, pra, ku kemi “materialin” në vend të “objektit”, krahas *lenger* nga arabishtja/persishtja *langar* (që del në Shâhnâme, 1000 vjet përpara), që po ashtu mund të ketë lidhje me gr. *ankura*. *Sidero* (nga gr. *sideros* “hekur”) përdoret në disa fjalë të përbëra që kanë të bëjnë me hekurin, si në *siderit* “mineral i hekurit”, *siderurgji* “metalurgji e zezë” etj. Simboli i hekurit *Fe* rrjedh nga shkurtimi i emërimit në latinisht të këtij metali: *ferrum*. *Ferrum* rrjedh nga lat. *īra*, *eira* (**eisā*) “zemërim” (angl. *anger*), për shkak të fortësisë së këtij metali krahasur me bronzin. Nga *ferrum* “hekur” rrjedh edhe siparashesa: *ferro* (*ferronikel* = lidhje e hekurit me nikel-

lin etj.). Edhe fjala *hekur* del që te Buzuku (shih te *bakri*, më lart). Te Bardhi (1635) kemi: *Ferrum, ferro* – *Hëkurë* [Blanchum 1635].

Helium-i ($_{2}\text{He}$) – Është quajtur sipas fjalës greke *Helios* “Diell”, meqë së pari është identifikuar, nga Pierre Jansen dhe Norman Lockyers (në mënyrë të pavarur), me analizën spektroskopike të dritës së diellit gjatë eklipsit diellor më 1868, në bazë të vijës spektrore të tij të verdhë. Elementi i zbuluar u emërtua me prapashtesëm *-ium*, të rezervuar zakonisht për metale, meqë Lockyer besonte se ka zbuluar një metal. Heliumi i pastër u veçua në Tokë, nga W. Ramsay dhe P. T. Cleve, më 1895, dhe atëherë u vërtetua se ai nuk ishte metal, por gaz.

Hidrogjen-i ($_{1}\text{H}$) – Është quajtur *hidrogenium* (prej nga rrjedh emërtimi në shqip *hidrogjen*), më 1787 nga kimisti francez A. Lavuaziei, në bazë të gr. *hidroginos* < *hydro gennan* “lindës/përfutës i ujit”, nga fakti se është përbërës i ujit (H_2O). Në Kosovë, në gjuhën bisedore, fjala *hidrogjen* përdoret edhe për “peroksidin e hidrogjenit” (H_2O_2) apo “ujin e oksigjenuar”, i cili përdoret si mjet për zbardhjen e mëndafshit, pambukut, flokëve etj., e në mjekësi si dizinfektues dhe antiseptik.

Holmium-i ($_{67}\text{Ho}$) – Është quajtur kështu, nga kimisti suedez P. T. Cleve (i cili e zbuloi më 1879), për nder të kryeqytetit të vendit të tij, Stokholmit, emri i lashtë latin i të cilit ishte *Holmia*.

Indium-i ($_{49}\text{In}$) – Është quajtur kështu sipas ngjyrës *indigo* “ngjyrë llullaqi, blu e errët” të vijës së tij spektrore të emisio-nit të dritës, në bazë të së cilës është identifikuar, nga F. Reich dhe H. T. Richter më 1867. Emërtimi *indigo* për këtë ngjyrë vjen nga ngjyruesi blu *indigo*, i cili përdorej nga grekët dhe romakët e vjetër, të cilët e quanin *indikon* (gr.), përkatësisht *indicum* (lat.), meqenëse ngjyruesi importohej nga *India*.

Iridium-i ($_{77}\text{Ir}$) – Emrin e ka marrë nga fjala lat. *iris* < gr. *iridos* “ylber”, meqenëse kripërat e tij kanë ngjyra të shumë-llojshme.

Iterb-i ($_{70}\text{Yb}$) – Është quajtur sipas emrit të qytet *Ytterby* në Suedi, ku u zbulua më 1878.

Itrium-i ($_{39}\text{Y}$) – Është quajtur sipas emrit të qytet *Ytterby* në Suedi, ku u zbulua nga C. G. Mosander më 1843, në të njëjtën kohë me erbiumin dhe terbiumin.

Jod-i ($_{53}\text{I}$) – Emri i tij rrjedh nga gr. *iodhis* “ngjyrëvjollcë”, për shkak të ngjyrës vjollcë të avujve të tij. Jodi (në temperaturë të dhomës) është në trajtë kristalesh ngjyrë hiri të errët, me shkëlqim metalik (ai është jometal), dhe lehtë sublimon (kalon drejtpërdrejt nga gjendja e ngurtë në gjendje të gaztë), duke dhënë avuj vjollcë.

Kadmium-i ($_{48}\text{Cd}$) – Emri i tij vjen nga lat. *cadmia* < gr. *kadmeia* “kalaminë”, emri i vjetër për karbonatin e zinkut, mineral nga i cili nxirret kadmiumi dhe gjendej në rrethinat e Tebës, të krijuar nga *Kadmos-i*, i biri i mbretit fenikas Agenor.

Kalcium-i ($_{20}\text{Ca}$) – Emri i tij vjen nga lat. *calx* [kalks] “gëlqere” (oksid kalciumi, CaO), meqenëse u veçua nga ki-

misti anglez Humphry Davy (më 1808) me anë të elektrolizës së një tretësire ujore të gëlqerës.

Kalifornium-i ($_{98}\text{Cf}$) – Është quajtur kështu sipas shtetit *California* në SHBA, ku është i vendosur laborator i Universitetit të Berkliut, ku u përftua (më 1950) ky element nga reaksioni bërthamor i kyriumit 242 me grimca alfa. *Kalifornia* vetë është quajtur nga eksploruesit spanjollë sipas emrit të mbretëreshës *Kalifia* të një fisi të Amazonisë, që supozohet të ketë jetuar në pjesën veriore të Kalifornisë.

Kalium-i [**potasi**] ($_{19}\text{K}$) – Emri i kaliumit vjen nga lat. *kalium* < arab. *al-qali* “një lloj bime, hiri i së cilës përdorej për përfitim e potasës (karbonatit të kaliumit)”. Emri *potas* a *potasium* (që përdoret në anglisht, frëngjisht e në disa gjuhë të tjera) vjen nga fjala holandeze *pot-aschen* “hi poçi”. Hiri i bimëve, i cili përftohej me djegien e materialit bimor në një poç, përmbante përbërës alkaline, natriumin dhe kaliumin, që përdorehin shpesh për përfitim e sapunit. Pra, nuk duhet të ngatërrohet fjala *potas* “kalium” me fjalën *potasë* “karbonat kaliumi”.

Kallaj-i ($_{50}\text{Sn}$) – Emri për “kallaj” (Sn) vjen nga fjala turke *kalay*, që rrjedh nga arab. *qalā'i* < pers. *qal'*, urdu *qala^i*. Nga turqishtja fjala është përhapur në shqip *kallaj*, arumanisht *cālae*, serbisht *kalaj*. Supozohet se me “kallajin” lidhet edhe emri i kryeqytetit të Malajzisë, *Kuala Lumpur*, të pasur me kallaj. Simboli i kallajit Sn vjen nga emri i tij në latinisht *stannum* “hekur i bardhë”, emër që përdorej për një përzierje të argjendit dhe plumbit, e cila kishte pamje të njëjtë si të kallajit, e bardhë e shndritshme (së këndejmi, ndoshta, emërtimi për kallajin në rusisht *olovo*, që në serbisht do të thotë “plumb”).

Karbon-i ($_{6}\text{C}$) – Emri i karbonit vjen nga fjala latine *carbo* “qymyr, thëngjill”, që është një trajtë e karbonit. Karboni elementar (diamanti, grafiti e thëngjilli) ka qenë i njohur që në kohët e lashta, por më 1797 është pranuar si element.

Klor-i ($_{17}\text{Cl}$) – Klori është quajtur kështu sipas gr. *chloros* “e verdhë e gjelbërme”, për shkak të ngjyrës së këtij gazi, që i ngjan asaj të kërcellit (biskut) të barit.

Kobalt-i ($_{27}\text{Co}$) – Është quajtur kështu sipas demonit të maleve dhe minierave *Kobold* në legjendat gjermanike, për shkak se përfitimi i këtij metali nga mineralet e tij ka qenë i pamundshëm të realizohet sipas procesit të zakonshëm dhe besohej se shkaktar për këtë ishin shpirtrat e këqij që sabotonin punën e minatorëve (xehetarëve) duke e prishur mineralin. Arsyeja ndoshta ka qenë se mineralet e kobaltit zakonisht janë të pasura me nikel, por dhe përmbajnë edhe sqfur dhe arsenik që i bën metalet e thyeshëm dhe prodhojnë flurime toksike. Emri *Kobold* vjen nga gr. *cobalos* “i djallëzuar, shejtan”.

Kripton-i ($_{36}\text{Kr}$) – Emri i tij vjen nga gr. *kriptos* “i fshehur (në atmosferë)”, që lidhet me vështirësinë e dallimit dhe të veçimit të këtij gazi, dhe faktin se ai është i rrallë.

Krom-i ($_{24}\text{Cr}$) – Është quajtur kështu sipas gr. *hroma* “ngjyrë”, për shkak të ngjyrave të shumta të kompozimeve në bazë të kromit.

Ksenon-i ($_{54}\text{Xe}$) – Është quajtur kështu sipas gr. *xénos* (*kseenos*) “i huaj”, për shkak të pranisë së tij pranë kriptonit, të cilin mendonin ta veçonin.

Kyrium-i ($_{96}\text{Cm}$) – Është quajtur kështu për nder të shkençetarëve francezë Maria Sklodovska-Kyri dhe Pjer Kyri, të cilët i kanë studiuar dukuritë e rrezatimit radioaktiv spontan.

Lantan-i ($_{57}\text{La}$) – Është quajtur kështu sipas gr. *lanthanein* “i fshehur” (në minerale me shumë elemente të quajtura “toka të rralla”; kjo e shpjegon emrin tjetër të përbashkët të “lantanideve”, me të cilat nënkuptohen elementet 57 deri 71). U deshën 36 vjet përpjekjeje që të veçohet nga minerali *cerit*.

Litium-i ($_{3}\text{Li}$) – Emri i tij vjen nga gr. *lithios* “gur”, për shkak të origjinës së tij minerare, ndryshe nga kaliumi dhe natriumi që i takonin të njëjtës familje (metaleve alkaline), por ishin me origjinë bimore.

Lorencium-i ($_{103}\text{Lr}$) – Emrin e ka marrë për nder të fizikanit amerikan Ernest Orlando Lawrence (Lorenc), zbuluesit të ciklotronit, aparatit i cili ka mundësuar prodhimin sistematik të elementeve “transuraniane”.

Lutec-i ($_{71}\text{Lu}$) – Është quajtur kështu sipas emrit të lashtë latin të kryeqytetit të Francës Paris, *Lutetia*, vendlindjes së zbuluesit të këtij elementi, kimistit francez George Urbain.

Magnez-i ($_{12}\text{Mg}$) – Emri i tij rrjedh nga *magnezia* “oksid magnez”, prej së cilës u përftua së pari më 1808/28 dhe që njihej prej kohësh. *Magnezia* është quajtur kështu sipas *Magnesia*, emri i lashtë latin i qytetit Manisa në Turqi, ku u zbulua së pari ky mineral. Pra nuk duhet të ngatërrohet *magnezi* dhe *magnezia*.

Majtnerium-i ($_{109}\text{Mt}$) – Është quajtur kështu për nder të fizikanës austriake *Lise Meitner*, specialiste e studimeve të rrezatimeve lidhur me radioaktivitetin, e cila së bashku me fizikanin Otto Hahn kanë zbuluar proaktinin.

Mangan-i ($_{25}\text{Mn}$) – Emri i tij vjen nga gr. *magnes* “magnet”, për shkak të vetive magnetike të piroluzitit (dyoksid mangani natyror, MnO_2), mineral i cili përdorej nga faraonët për prodhimin e qelqit. Një tjetër mendim është se është quajtur sipas fjalëve greke *man* “me të vërtetë” dhe *ganimi* “kthjelloj, jap shkëlqim”, që lidhen me emrin e xehërorit piroluzit, i cili qysh prej shekullit XII është quajtur *manganes* e përdorej për të çngjyrosur qelqin gjatë shkrirjes.

Mendelevium-i ($_{101}\text{Md}$) – Është quajtur për nder të shkencëtarit rus *Dimitri Ivanoviç Mendelev*, krijuesit të tabelës periodike të elementeve kimike.

Merkur-i [**zhiva**] ($_{80}\text{Hg}$) – Është quajtur kështu sipas planeit *Merkur* (lat. *Mercurius*), perëndisë romake të tregtarëve dhe lajmëtarit të perëndive, për shkak të lëvizshmërisë së këtij metali të lëngët. Ka edhe mendime se mercuri është quajtur kështu për arsye se ai është konsideruar njëri ndër elementet

themelore, i afërt me arin, ndaj dhe është quajtur sipas planetit Merkur, planetit më së afërmi Diellit, element i të cilit është konsideruar ari. Simboli Hg për elementin “merkur” vjen nga lat. *hydrargyrum* “argjend i lëngët” < gr. ὑδραργυρος [hydrargyros] < ὑδωρ [hydōr] “ujë” dhe αργυρος [argyros], quajtur kështu për shkak të gjendjes së tij fizike (merkuri është metali i vetëm në gjendje të lëngët në temperaturë të dhomës). Emri tjetër për merkurin (Hg) në gjuhën shqipe, **zhivë** vjen nga sllavishtja *živa* [zhīva] “i gjallë”, e afërt me turqishten *civa* [xhiva] “zhivë” < pers. *jīwa* [xhīwa] “zhivë” < pers. vjet. *jīvag* [xhivag] “i gjallë”, e afërme me sanskrishten *jiva* < indoevropianishtja *ǵiv* “jetë”. Nga emërtimi tjetër për *zhivën* (Hg) në latinisht, *argentum vivum* “argjend i gjallë”, rrjedhin edhe emrat për këtë metal në disa gjuhë, si: në gjermanisht *Quecksilber* (*queck* “i gjallë”, në sllovenisht *živo srebro*, në polonisht *żywe srebro*, në lituanisht *gyvsidabris* etj. dhe emrat popullorë: në anglisht *quicksilver* (nga emri i tij i vjetër: *argent vive*, shënuar së pari më 1453), në frëngjisht *vif-argent* dhe në serbisht *živo srebro*. Edhe në shqipen popullore kemi: *engjërddhi* < *engjërvi* (përfutur me ndërndërrimin e spiranteve *dh* e *v* në fushën dialektore), e kjo nga it. *argento vivo* ose ven. *arzento vivo* “ergjend i gjallë” = *zhivë* [Çabej IV 1996, f. 84]. Shprehja e shqipes “(si) *zhivë*” dhe ajo e turqishtes “*civa gibi*” do të thonë “shumë i shkathët, i gjallë e i zhdërvjellët; shumë i lëvizshëm”.

Molibden-i ($_{42}\text{Mo}$) – Emri i tij vjen nga gr. Μολυβδος [molivdhos] “plumb”, për shkak të ngjasimit të madh të këtij metali (molibdenit) me plumbin (ndaj në fillim janë ngatërruar), si dhe për shkak të faktit se çdo metal i rëndë i errët që linte shenjë në letër është quajtur “plumb” në kohët e lashta (shih **Plumb**, më poshtë!).

Natrium-i [**sodiumi**] ($_{11}\text{Na}$) – Emrin e ka marrë nga karbonati natyror i natriumit a *natroni*, i cili është përdorur qysh në lashtësi si lëndë larëse, me emrat *neter* (hebraishte e vjetër), *nitron* (greqisht), *nitrum* (latinisht), nga të cilët rrodhën emrat *natr* (për oksidin e natriumit) dhe *natrium* (për metalin). Haset edhe me emrin *sodium* (si në anglisht, frëngjisht e në disa gjuhë të tjera), i cili rrjedh nga arab. *sod* ose *souwad* “bimë që përmban shumë karbonat natriumi (sodë)”.

Neodim-i ($_{60}\text{Nd}$) – Është quajtur kështu, më 1885, nga Carl Auer von Welsbach, sipas fjalëve greke *neos* “i ri” dhe *didymos* “binjak”, që do të thotë “binjak i ri” Ai vërtetoi se minerali të cilin e kishte zbuluar Carl Gustav Mosander më herët e për të cilin besonte se përmbante një element i cili mund të ishte “binjak” i lantanit, meqë shfaqej gjithmonë me të në një mineral tjetër (të quajtur cerit) dhe për të cilin kishte propozuar më 1841 ta quanin *dydimium*, përmbante në fakt dy elemente, të cilat u quajtën “neodim” dhe “prazedom”.

Neon-i ($_{10}\text{Ne}$) – Është quajtur kështu, më 1898, nga zbuluesi i tij William Ramsay, sipas fjalës gr. *neos* “i ri”, meqë atëherë ishte një gaz “i ri” në serinë e gazeve fisnike.

Neptunium-i ($_{93}\text{Np}$) – Është quajtur kështu sipas planetit

Neptun, i cili në sistemin tonë diellor vjen pas *Uranit*, e para *Plutonit*, sikurse *neptuniumi* që vjen pas *uraniumit*, e para *plutoniumit* në tabelën periodike të elementeve. Vetë planeti *Neptun* e ka marrë emrin sipas Neptunit, perëndisë romake të detit.

Nikel-i ($_{28}\text{Ni}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës gjermane *Kupfernikel* “xeheror djalli”, sepse për shkak të përpjekjeve të pafrytshme për të nxjerrë nikelin nga minerali i tij (xeherori i arsenuar, me të njëjtin emër, NiAs, që njihej qysh në fund të shek. XVII), besohej se ky mineral është nën pushtetin e demonëve; ose sipas fjalës suedeze *Kopparnickel* “bakër i rrejshëm”, që ka të bëjë, sipas legjendave suedeze, me një shpirt të keq që jetonte nëpër miniera. Nikeli është identifikuar nga kimisti suedez Alexander Cronstedt më 1751.

Niob-i ($_{41}\text{Nb}$) – Është quajtur kështu sipas emrit të perëndeshës greke *Niobe*, bija e gjysmëperëndisë Tantal, për të treguar ngjashmërinë ndërmjet niobit e tantalit. Fillimisht është zbuluar në Kolombi (më 1801), dhe është quajtur *kolomb* (*colombium*, Cb), sipas vendit të zbulimit dhe për nder të Kristofor Kolombos, zbuluesit të Amerikës, por pastaj është ngatërruar me tantalin.

Nobelium-i ($_{102}\text{No}$) – Është quajtur kështu për nder të industrialistit suedez, Alfred Nobel, shpikësit të dinamitit dhe themeluesit të Çmimit Nobel. Emërtimi është bërë me konsensus, sepse autorësinë për zbulimin e këtij elementi e kërkonin me ngulm (më 1958) dy laboratorë, njëri rus dhe tjetri amerikan.

Oksigjen-i ($_{8}\text{O}$) – Emri i tij rrjedh nga fjala lat. *oxygenium* (fr. *oxygène*), me të cilën e ka emërtuar, më 1777, kimisti francez A. Lavuazie, në bazë të fjalëve greke *ὀξύς* (*oxys*) “acid” dhe *γενής* (*-genēs*) “lindës/përftues i acidit”, nga fakti se në atë kohë të gjitha acidet e njohura përmbanin oksigjen dhe besohej se nuk kishte acid pa oksigjen.

Osmium-i ($_{76}\text{Os}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës greke *osmi* “erë, kundërmim”, për shkak të erës së keq e irrituese (ngacmuese) që ka anhidriti osmik (OsO_4), e cila të kujton njëkohësisht erën e klorit e të hudhrës.

Paladium-i ($_{46}\text{Pd}$) – Është quajtur kështu, më 1803, sipas asteroidit *Palad*, i zbuluar një vit para tij (më 1802), i cili është quajtur kështu sipas perëndeshës greke të artit e urtësisë *Palada Athena*.

Platin-i ($_{78}\text{Pt}$) – Emri i tij rrjedh nga fjala spanjolle *platina* (diminutiv i *plata* “argjend”) “argjendth”, për shkak të pamjes fizike të platinut, e cila i përngjan asaj të argjendit. Njihej dhe përdorej nga indianët parakolumbianë.

Plumb-i ($_{82}\text{Pb}$) – Emri i këtij elementi rrjedh nga lat. *plumbum* “i rëndë”, për shkak të “masës (peshës) vëllimore” të madhe të tij. Të së njëjtës origjinë janë edhe fjalët për “plumb” në rum. *plumb*, në fr. *plomb*, në it. *piombo*, në arum. *plumbu* etj. Te Bardhi kemi: *plumbum* – *plumb* [Blanchum 1635]. Fjala *plumb* në shqipe ka kuptimin edhe “grafit i lapsit”, si në

anglishtje *plumbago* “grafit i lapsit”, po dhe *lead pencil* “laps grafit”; nga *plumb* kemi *plumbç* “laps plumbi”, si në turqisht nga *kurşun* “plumb” < *kurşun* “laps” e në serbishtje nga *olovo* “plumb” > *olovka* “laps”. Plumb në shqip e ka edhe kuptimin e “fishekut (të pushkës)”, si në turqisht *kurşun*.

Plutonium-i ($_{94}\text{Pu}$) – Është quajtur kështu sipas planetit *Pluton* [që në kohën e fundit është futur në kategorinë e “planetëve xhuxhë” nga ana e Unionit astronomik ndërkombëtar], i cili vjen pas Neptunit në sistemin diellor sikurse që plutoniumi vjen pas neptuniumit në tabelën periodike të elementeve. Emri i planetit Pluton, ndërkaq, vjen nga emri i perëndisë greke të Nëntokës a Skëterrës (Ferrit), e me “zjarrin e skëterrës” figurativisht mund të lidhet edhe elementi (metali radioaktiv) plutoniumi, i cili përdoret për të përfutur energjinë bërthamore.

Polonium-i ($_{84}\text{Po}$) – Është quajtur kështu sipas emrit të lashtë latin të Polonisë, *Polonia*, për nder të atdheut të shkencëtares Maria Kyri - Sklodowska, e lindur në Varshavë të Polonisë, e cila e ka zbuluar këtë element së bashku me bashkëshortin e saj Pjer Kyri më 1898.

Potas-i [shih: **kaliu-m-i**] ($_{19}\text{K}$)

Prazeodim-i ($_{59}\text{Pr}$) – Emri i tij rrjedh nga fjalët greke *prasios* “e gjelbër e çelët” dhe *didymos* “binjak”, për shkak të ngjyrës karakteristike të gjelbër të oksidit të tij dhe të pranisë së neodimit dhe prazeodimit në një oksid të tij, për të cilin besohet se ishte një substancë e pastër. (Shih: *neodimi*!)

Promet-i ($_{61}\text{Pm}$) – Emri i tij rrjedh nga emri i Prometeut (gr. *Prometheus*), titanit i cili ia kishte vjedhur një shkëndijë Diellit për t’ia dhënë njerëzimit, e lidhur me përpjekjet e pareshtura për ta veçuar këtë element në prodhimet e fuzionit të uranimit.

Protaktin-i ($_{91}\text{Pa}$) – Emri i tij rrjedh nga fjala greke *protos* “i parë, paraprijës” dhe *aktin* (nga. lat. *actinium*), meqenëse gjatë zbërthimit të tij radioaktiv emeton grimca α (alfa) dhe formon aktinin.

Radhërfordium-i ($_{104}\text{Rf}$) – Është quajtur kështu për nder të fizikanit amerikan Ernest Rutherford, i cili ka treguar se gjatë zbërthimit radioaktiv shfaqen tri lloje rrezatimesh (α , β , γ) dhe i cili e ka dhënë një model të strukturës së atomit, i cili ka një bërthamë. Për këtë element është propozuar fillimisht (më 1966) emri **Kurçatovium** (**Ku**), i cili haset edhe sot në literaturën sovjetike, por dhe në literaturën shqipe të mëhershme (*Fjalori drejtshkrimor*; *Fjalori i kimisë*).

Radium-i ($_{88}\text{Ra}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës latine *radius* “rreze”, për shkak të rrezatimit që i përket radioaktivitetit të emetuar (lëshuar) nga ky element.

Radon-i ($_{86}\text{Rn}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës latine *radium* “burim, flurim, emanacion”, meqenëse radoni është një gaz që përftohet me shpërbërjen e radiumit.

Renium-i ($_{75}\text{Re}$) – Është quajtur kështu sipas emrit të lashtë latin të lumit Rin (Rajna), *Rhenus*, në Gjermani, për

nder të vendit të zbulimit të këtij elementi, Gjermanisë, nëpër të cilën kalon ky lumë.

Rëntgenium-i ($_{111}\text{Rg}$) – Është quajtur kështu për nder të fizikanit gjerman Wilhelm Conrad Roentgen, i cili “rastësisht”, më 1895, i ka zbuluar rrezet X (= të panjohura, deri atëherë), të quajtura më vonë sipas tij edhe rreze rëntgen.

Rodium-i ($_{45}\text{Rh}$) – Është quajtur kështu sipas gr. *rodos* “ngjyrëtrëndafili”, përkatësisht *rhodon* “trëndafili”, për shkak të ngjyrës së trëndafiltë (rozë) të disa kripërave të tij.

Rubid-i ($_{37}\text{Rb}$) – Është quajtur kështu sipas lat. *rubidus* “e kuqe e mbyllët”, për shkak të ngjyrës së kuqe të mbyllët të vijës spektrorë kryesore të emisionit të tij të dritës.

Ruten-i ($_{44}\text{Ru}$) – Është quajtur kështu, më 1828, nga zbuluesi i tij kimisti rus Gottfried Osann, sipas emrit të lashtë latin të Rusisë, vendlindjes së tij.

Samarium-i ($_{62}\text{Sm}$) – Është quajtur kështu sipas mineralit *samarskit*, ku është gjetur së pari, i cili emrin e ka marrë sipas inxhinierit rus të xehetarisë, W. J. Samarski, që e ka zbuluar këtë mineral.

Selen-i ($_{34}\text{Se}$) – Është quajtur kështu sipas Hënës, satelitit të Tokës, gr. *Selene* “Hënë”, meqenëse gjendet gjithmonë së bashku me telurin, i cili e ka marrë emrin nga Toka (lat. *Tellus*).

Siborgium-i ($_{106}\text{Sg}$) – Është quajtur kështu për nder të fizikanit amerikan *Glenn T. Seaborg*, i cili ka marrë pjesë në “zbulimin” e shumë elementeve transurane, prej të cilave plutoniumi, americiumi, kyriumiumi, berkeliumi dhe kaliforniumi nga laboratorit Lawrence i Universitetit të Berkelit, Kaliforni, SHBA.

Silic-i ($_{14}\text{Si}$) – Emri i këtij elementi vjen nga lat. *silicis*, *silex* [*sileks*] “strall”, për shkak të origjinës së tij, sepse stralli përbëhet kryesisht nga *silica* (dyoksidi i silicit, SiO_2). *Silica* nuk duhet ngatërruar me *silicin* elementar (Si). Me *silicin* elementar (Si), nuk duhet ngatërruar [nën ndikimin e angl. *silicon* “silic”] as *silikonet* “produkte makromolekulare sintetike që përmbajnë në molekulë elementin silic, e që kanë strukturë në trajtë filli” [Haxhimihali 1984], të cilat përdoren si vajra lyrëse, kauçuke speciale, cipa kirurgjikale [gjinjtë prej silikonit]. Pra, jo “Lugina e silikonit”, por “Lugina e silicit”.

Sodiumi [shih: **natriu-m-i**] ($_{11}\text{Na}$)

Skandium-i ($_{21}\text{Sc}$) – Është quajtur (më 1879) sipas emrit të lashtë latin të Skandinavisë *Scandia*, rajoni i vetëm ku gjenden mineralet që përmbajnë skandium, e për nder të zbuluesit të tij kimistit suedez Kilson.

Sqfur-i ($_{16}\text{S}$) – Emri i tij vjen nga lat. *sulphurium* “gur që djeg” < rrënja IE **suelf* ose **swel* “me u djeg në vetvete”, siç ‘digjet’ një copë sqfuri. *Sqfuri* nuk duhet të ngatërrohet me mineralin e tij *sulfur*, i cili përftohet nga bashkimi i sqfurit me një metal ose me një element tjetër (*sulfuri i zinkut*, ZnS ; *sulfuri i plumbit*, PbS etj.).

Stroncium-i ($_{38}\text{Sr}$) – Është quajtur kështu sipas mineralit *stronciamit* (karbonat stronciumi natyror, SrCO_3) që e përm-

bante dhe u gjet pranë qytetit *Stroncian* në Skoci, prej nga dhe e mori emrin ky mineral.

Talium-i ($_{81}\text{Tl}$) – Emri i tij vjen nga gr. *Thallos* “degëz e gjelbër, filiz, bisk”, për shkak të ngjyrës së gjelbër (të filiztë) që karakterizon njëren prej vijave spektrore të rrezatimit të tij të dritës.

Tantal-i ($_{73}\text{Ta}$) – Është quajtur kështu sipas heroit të mitologjisë së lashtë greke *Tantal-it* (gr. *Tantalos*), mbret legjendar i Lidisë, baba i Penelopës dhe Niobës dhe bir i Zeusit, i cili nga Zeusi që ndëshkuan për keqpërdorimin e dashamirësisë dhe të mikpritjes së tij e të zotave të tjerë në Olimp: ushqimi dhe pija (uji) i zmbrapseshin para gojës sikurse tantalit që i shmangeshin acidet me të cilat ai përpiquej të binte në kontakt (tantali nuk formon kripëra me acidet).

Tekneç-i ($_{43}\text{Tc}$) – Është quajtur kështu sipas gr. *tehnitos* “artificial”, meqenëse ishte elementi i parë që ishte krijuar në mënyrë artificiale nga njeriu dhe nuk gjendej në natyrë.

Telur-i ($_{52}\text{Te}$) – Është quajtur kështu sipas perëndeshës romake të Tokës, *Tellus*, nga fakti se teluri dhe seleni kanë veti shumë të ngjashme dhe gjenden gjithnjë së bashku, të pandashëm si Toka dhe Hëna (sateliti i saj).

Terbium-i ($_{65}\text{Tb}$) – Emri i *terbiumit* (sikur ai i *erbiut*, i *itriumit*, dhe i *iterbiumit*) rrjedh nga emri i qytetit suedez Ytterby, afër Stokholmit, ‘kryeqytetit kimik’ i “tokave të rralla” (lantanideve), vend ku është gjetur për herë të parë.

Titan-i ($_{22}\text{Ti}$) – Është quajtur kështu sipas *Titanëve* (gr. *Titanes*) të mitologjisë së lashtë greke, bij dhe bija gjigantë të Uranit (perëndisë së Qiellit) dhe Geasë (perëndeshës së Tokës), për shkak të qëndrueshmërisë (fortësisë) së këtij metali (titani është po aq i fortë sa çeliku, por 45% më i lehtë).

Torium-i ($_{90}\text{Th}$) – Është quajtur kështu, më 1828, sipas *Thor-it*, zotit të luftës e të bubullimës në mitologjinë e lashtë skandinave, për shkak të shkëndijave që dalin nga toriumi kur ai goditet me çelik.

Tulium-i ($_{69}\text{Tm}$) – Është quajtur kështu, më 1879, sipas ishullit mitik nordik (skandinavez) *Thule*, për nder të zbuluesit të tij, kimistit norvegjez Per Theodor Cleve.

Tungsten-i [shih: *vofram-i*] ($_{74}\text{W}$)

Uranium-i ($_{92}\text{U}$) – Është quajtur kështu (më 1789) sipas planetit *Uran*, të zbuluar tetë vjet më parë (më 1781), e të quajtur kështu sipas perëndisë greke *Uran*, atit të *Titanëve* e bashkëshortit të perëndeshës së tokës *Gea*.

Vanadium-i ($_{23}\text{V}$) – Është quajtur kështu (më 1830) sipas emrit të perëndeshës së lashtë skandinave të dashurisë dhe bukurisë, *Freya Vanadis*, për shkak të komponimeve të tij të shumta me ngjyra të ndryshme të “mrekullueshme”.

Volfram-i [*tungsteni*] ($_{74}\text{W}$) – Emri i volframit vjen nga gjerm. “*Wolf Rahm*”, që është përkthim i lat. *lupi spuma* “shkumë (jargë) ujku, për shkak se gjatë procesit të ekstraktimit (nxjerrjes) së kallajit ai e zvogëlonte dukshëm rendimen-

tin (gratin), sikurse ujqit që “gëlltitin” prenë e tyre (delet). Emri *tungsten*, i përdorur në Francë, Angli e SHBA, por jo dhe në Suedi, për volframin, vjen nga suedishtja “*tung sten*” “gur i rëndë”, për shkak të dendësisë së madhe të xehërorit të tij, mineralit *sheelit* (CaWO_4), të quajtur kështu për nder të kimistit suedez Karl Vilhelm Sheele.

Zink-u ($_{30}\text{Zn}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës gjermane *zinke* “dhëmb; teh i mprehtë”, për shkak se minerali *kalamini* (karbonat zinku), nga i cili mund të përftohet metali zink, ka shumë tehe të mprehta.

Zirkonium-i ($_{40}\text{Zr}$) – Është quajtur kështu sipas fjalës arabe *zarkun* (= minerali cinabër) që vjen nga pers. *zargûn* (= gur i artë) “ngjyrtë”, e sipas ngjyrës së artë të mineralit kryesor të zirkoniumit, gurit të çmuar *zirkon* (ZrSiO_4).

Zhivë, zhiva [shih: *merkur-i*] ($_{80}\text{Hg}$)

Referencat

- [Bardhi 1635] Blanchum, Franciscum, *Dictionarum latino epiroticum*, Romae 1635; [Data entered by Michiel de Vaan, May 2004]; [Frang Bardhi, *Fjalor latinisht-shqip*]
- [Bourque 2007] Bourque, Ghislaine, *Origine du nom des éléments chimiques*, 2007.
- [Budi 1621] Budi, Pjetër: *Specchio di Confessione (Pasqyra e t Rëfyemit)*, Roma 1621.
- [Buzuku 1987] Buzuku, Gjon: *Meshari*, 1555. [E. Çabej, Botim kritik, Prishtinë, 1987].
- [Caka 2006] Caka, Nebi, *Huazimet leksikore dhe qëndrimi ndaj tyre*, “KOHA Ditore” Nr. 3339: “KOHA për kulturë”, Nr. 324, f. 29, Prishtinë, 30 shtator 2006.
- [Çabej 1986] Çabej, E.: *Studime etimologjike në fushë të shqipës*, A-O, Prishtinë, 1986.
- [Çabej 1996] Çabej, E.: *Studime etimologjike në fushë të shqipës* IV, AShSh, Tiranë 1996.
- [Dhama 1988] Dhama, T.: *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, 1988.
- [Erat 2008] Erat, Janez, *Etimoloski sulovar*, 2008.
- [Gábor 2007] Gábor, Lente, *Words for the element ‘iron’ in 213 languages*, Debrecin, 2007
- [Harper 2001] Harper, D.: *Online etymology dictionary*, 2001, <http://www.etymonline.com>
- [Haxhimihali 1984] Haxhimihali, Dh., H. Haxhi, H. Karagjozi, S. Durrësi: *Fjalori i kimisë*, Tiranë, 1984.
- [Matasovic 2007] Matasovic, R.: *Etimoloski rjecnik hrvatsko jezika*, Zagreb 2007
- [Nişanyan 2008] Nişanyan, Sevan, *Sözlerin Soyağacı, Çağdaş Türkçenin Etimolojik Sözlüğü*, 2008
- [Van der Krogt 2007] Van der Krogt, Peter, *Multilingual dictionary of the names of chemical elements*, 2007
- [Zamarovsky 1985] Zamarovsky, V., *Heronjtë e miteve antike – Leksikon i mitologjisë greke dhe romake*, (përkthyer në shqip nga serbokroatishtja nga Z. Mirdita), Rilindja, 1985.

Rrugëtimi i identiteteve fetare dhe influenza e tyre në shoqërinë shqiptare

I

Në fillim të vitit 2006, ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhuroi një fond përreth 30.000 euro për të restauruar një objekt brenda kështjellës së Rozafës që kishte shërbyer për një kohë të gjatë si kishë dhe xhami njëkohësisht. Në fakt, objekti me historinë e tij të veçantë mund të konsiderohet si një nga objektet sintezë të historisë religjioze së shqiptarëve. E njohur dhe e dokumentuar si kisha e Shën Stefanit në veprat e Marin Barletit dhe Marin Beçikemit, dy autorëve të shekullit të XV, kisha do të shndërrohej në një xhami gjatë pushtimit turk. Sipas specialistëve mendohet se minarja është shtuar rreth vitit 1405“ (*Peçi.A, 2006:1*) dhe jo në vitin 1479 siç mendohet rëndom duke marrë për bazë pushtimin e kështjellës nga turqit. Viti 1405 është vit kur osmanët e patën në duart e tyre qytetin e Shkodrës për disa vjet së bashku me Ulqinin dhe Lezhën. Vendosja e garnizonit osman në këtë periudhë dhe stili i minareve selxhuke bashkëkohëse me minaren e kuqe në kalanë e Beratit të vitit 1389, si dhe vendosja e saj në anën fundore të xhamisë dhe jo në të djathtë hyrjes, është karakteristikë për xhamitë osmane të shekullit XV“ (*Po aty, 2006*).

Adoptimi i bërë nuk kërkoi ndryshime të mëdha në arkiteturë, kjo për faktin se “orientimi i mihrabit koïncidonte, me atë të mjedisit të altarit në absidë. Ky mjedis ka qenë i mbuluar deri vonë me kupolë nervaturash të kryqëzuara të stilit romano-gotik. Në vitin 1760-1764 Veziri i Shkodrës, Mehmet Pashë Bushatlliu, në punimet rindërtuese e restauruese në strukturat e kalasë kreu ndërhyrje edhe në xhami duke shtuar hajatin me arkadë në anën jugore. Ai porosi nga Venediku edhe një mekanizëm sahati akustik, për të cilin siç shprehet vetë në një dokument kishte ngritur para xhamisë një kullë të lartë” (*Po aty, 2006*). Si mund të vështrohet, me gjithë shndërrimet që iu bënë objektit, banorët e këtij qyteti e ruajtën harmoninë fetare” (*Po aty, 2006*). Shkresa e firmosur nga Veziri i Shkodrës, ku rinovohet e leja zyrtare për të mbajtur meshën çdo të premte në mëngjes, tregon se banorët ende të përqendruar në kala, kishin mirëkuptimin maksimal mes tyre (*Po aty, 2006*). Por ajo që ishte shmangur për një kohë të gjatë me mirëkuptim midis dy komuniteteve fetare u lëkund në ditët e sotshme kur godina nuk shërbente më si një objekt kulti.

Qysh prej vitit 1878, kur ajo u kthye në një depo baruti, godina në gjendjen e sotshme është duke pritur një restaurim të mundshëm që sipas specialistëve duhet të përfshijë të gjitha etapat e ndërtimit të saj. Por jo të gjithë ndanin të njëjtin mendim në qytetin verior të Shkodrës. Një debat shpërtheu midis Myftinisë së Shkodrës dhe shtetit shqiptar (nën administrimin e të cilit ishte objekti si monument kulture) për administrimin e fondeve të dhëna

nga ambasada amerikane. Myftinia e Shkodrës kërkonte që ta përdorte fondin për të restauruar xhaminë që dikur kish qenë Kisha e Shën Stefanit. Në debat ndërhyri dhe Kisha Katolike e cila ndante mendimin tjetër se gërmallat e godinës duhej të restauroheshin në kishë. Si gjithmonë në raste të tilla lindën pyetje të ndryshme të cilat nxorën në pah sërish konflikte të heshtura nën petkun e fortë të formimit të shtetit-komb të periudhës së viteve '20 dhe totalitarizmit të viteve '40-'90 që qenë munduar ti fashisnin konflikte të tilla në emër të formimit të identitetit dhe kombit shqiptar.

Më tepër se një konflikt mbi pronësinë e një objekti, situata hodhi dritë mbi identitetet e fjetura fetare të shqiptarëve dhe në këtë mënyrë mund të thuash se ishte një pararendës e debatit Kadare-Qose që mbërtheu elitën intelektuale shqiptare pas nënshkrimit të marrëveshjes së MSA-së dhe publikimit të veprës së Kadaresë *Identiteti Evropian i Shqiptarëve*.



Ndërtesa e të gjitha feve, Kazan, Republika e Tataristanit. Ajo përfshin 16 lokale për degë të ndryshme të Krishtërit, Islamizmit, Hinduizmit dhe Budizmit.

Në këtë studim do të mundohemi të hedhim dritë nëpërmjet një analize të hapave të parë të formimit të shtetit modern të shqiptarëve sesa përcaktues ka qenë identiteti fetar në zgjimin nacionalist të shqiptarëve, si ka ndikuar dhe ndikon ky identitet në shoqërinë shqiptare dhe prirjet moderniste të religjionit të shqiptarëve në epokën e sotshme të globalizmit.

II

Identiteti fetar në Shqipëri nuk është marrë gjithmonë në konsideratë në rrugëtimin e tij drejt realitetit që kemi sot, duke vlerësuar se motoja e rilindësit Pashko Vasa “Feja e shqiptarit është shqiptaria” është përgjithësuese dhe karakteristike për epokën e Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve dhe si e tillë duhet t’i përshtatet apriori të gjitha situatave shtet formuese apo kulturore-historike të mëvonshme. Ky përcaktim vjen pasi Rilindja Kombëtare ka një peshë të veçantë në botëkuptimin nacionalist shqiptar si apogjeu i përpjekjeve intelektuale dhe shpirtërore për të themeluar një Shqipëri moderne dhe të zhvilluar. Në fakt rrugëtimi identitetit fetar të shqiptarëve i ka përngjarë një batice e zbatice, pa qenë asnjëherë në gjendje të luajë fuqinë e një force centrifugale për të realizuar një bashkim të qëndrueshëm kombëtar, as shumë i fuqishëm sa të pengojë përjetësisht atë, por i mjaftueshëm sa të influencojë dhe vonojë disa procese intriguese që popujt e tjerë të Ballkanit i realizuan më shpejt se shqiptarët.

Gjithsesi shprehja nuk duhet marrë si simboli i një lëvizje apo epoke, siç ka prirje të shumta në qarqe studiuesish apo politikanësh për ta përqasur atë, pasi në një analizë të thellë të veprës së dy poetëve tanë kombëtarë që kanë luajtur dhe një rol të madh në formimin e ndërgjegjes kombëtare vëren se identiteti fetar është një pjesë e rëndësishme e veprës së tyre. Kështu p.sh është e pamundur ta lexosh Gjergj Fishtën dhe të mos hasësh binomin “Fe dhe Atdhe”, ku me fe ai nënkupton fenë e të parëve- Katolicizmin apo Naim Frashërin dhe të mos hasësh Bektashizmin dhe filozofinë e panteizmit të tij. Madje Naimi shkon dhe më larg në botëkuptimin e tij fetar kur krijon një poemë si *Qerbelaja* që përshkruan një konflikt të mirëfilltë fetar.

Shqiptarët nuk mund të bënin dallim nga popujt e tjerë ballkanikë kur nisën zgjimin e tyre nacionalist. Prirja e natyrshme do të ishte ashtu si dhe te fqinjët e vet, një kundërvënie ndaj fesë zyrtare të pushtuesve-Islamit, diçka që hasi në vështirësi që në hapat e parë, sepse një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve kishin pranuar Islamin dhe nën influencën e shtetit teokratik osman e identifikonin veten shpesh herë si myslimanë dhe pastaj si shqiptarë.

“Kultura islamike e Perandorisë Osmane i kishte mëshuar identifikimit të besimit fetar me kombin, duke sheshuar dallimin midis shqiptarëve e myslimanëve të tjerë nga njëra anë dhe duke nxjerrë më në pah, nga ana tjetër, atë midis is-

lamikëve dhe të krishterëve gjithfarësojësh. Në një shoqëri shumëkombëshe, siç ishte ajo e Perandorisë Osmane, jeta e nënshtetasve të saj, çështje e vërteta, ishte organizuar rreth besimit, të cilit, ata i përkisnin: domethënë, vija ndarëse ndërmjet të qeverisurve dhe qeverisësve-ose, thënë më shkoqur, popullsisë hegjemone-ishte religjioni dhe jo kombësia, ku padyshim, ashtu si në të gjithë perandorinë, myslimanët përftonin një pozicion të privilegjuar, gjë që, në rastin e Shqipërisë që shndërruar e kishte përbërë një pengesë objektive për të arritur bashkimin kombëtar të myslimanëve me të krishterët, qofshin ata ortodoksë apo katolikë.” (Salleo, 2000:22).

Edhe pse ekzistonte një farë “patriotizmi lokal” që shpesh herë gjente shprehje ashtu siç na dëshmon Hobhouse-i në veprën e vet *A Journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia, to Constantinople during the years 1809 and 1810* në deklaratimet e banorëve, që kur i pyesnin se ç’ishin, banori shqiptar nuk thoshte përkatësinë fetare, por përgjigjej “Jam shqiptar” (Mema, 1988:70), prapëseprapë ky patriotizëm lokal nuk shtrihej në përmasa përgjithësuese që mund të përbënte një nga bërthamat e themelimit të identitetit shqiptar dhe pastaj më vonë atë kombëtar.

Ishin lëvizjet e mëvonshme anti-osmane të viteve ’20, ’30 e ’40 të shekullit të XIX në kuadër të luftës kundër centralizimit të perandorisë turke që krijuan kundërvëniet e para serioze pas 3 shekujsh pushtimi. Rëndësia e këtyre kryengritjeve qëndron se shqiptarët myslimanë u ngritën në kryengritje kundër pushtetit turk që faktikisht duhej të konsiderohej si i tyre. Është e vërtetë se ato nuk ishin lëvizje me karakter të plotë kombëtar, por gjithsesi vërehet një ngjizje e identitetit kombëtar shqiptar, kur rapsodi popullor i këndon përpjekjeve të kryengritësve që s’luftojnë “as për mua e s’për ti / po për gjithë Shqipëri” (Islami, 1977:67).

Në këtë kohë nis dhe procesi i gjatë para-rilindës i ngjizjes së idesë mbizotëruese se shqiptarët në rrugën e tyre drejt pavarësisë apo afirmimit të tyre si komb, duhet ta shmangnin faktoren fetar dhe të bënin të tyren dy faktorë të tjerë: gjuhën shqipe dhe figurën mitike të heroit të tyre kombëtar Gjergj Kastriot-Skënderbeut. Për të arritur këtu mendimi politik i rilindësve tanë për sa i përket identitetit kombëtar kaloi në tre etapa maturie, të cilat dëshmojnë dhe rrugëtimin e identitetit fetar të shqiptarëve. “Ndërmjet fqinjëve ballkanikë të Shqipërisë feja dhe kombësia përputheshin. Përderisa kjo nuk ndodhte me shqiptarët, udhëheqësit e tyre u përpoqën të zhvillonin ato aspekte të kulturës kombëtare që ishin të një natyre jofetare sepse vetëm kështu mund të arrihej bashkimi” (Skëndi, 2000:111).

Etapa e parë i përket periudhës të viteve ’20-’60 të shekullit XIX, kohë në të cilën përkthehen Bibla nga gjuha greke në atë shqipe¹, duke krijuar kështu një sfond të nevojshëm

1. Periudha që analizohet është më e vonshme sesa Meshari i Buzukut ku dihet se ende nuk ishte kristalizuar as si ide, krijimi i shteteve-komb. Për më

shpirtëror për shqiptarët e besimit ortodoks që gjuhën e tyre tashmë mund ta shikonin dhe si “gjuhë perëndie”, ku mund të lexonin dhe kuptonin shkrimet e shenjta. Kjo epokë lidhet fort dhe me krijimin e komuniteteve të forta tregtare në jug të vendit, tashmë fshatra por dikur të lulëzuara si Voskopoja, Vithkuqi etj apo rritjen e qyteteve si Elbasani, Gjirokastra, Shkodra e Berati. Nga radhët e këtyre komuniteteve do të dilnin dhe disa nga figurat e shquara të mendimit politik rilindas shqiptar si Vangjel Meksi që përkthen *Biblën* në shqip, Naum Veqilharxhi që krijon abetaren e parë në shqip, Kostandin Kristoforidhi që përkthen e boton *Biblën* në shqip etj figura, vepra e të cilëve do të influenconte në zgjimin nacionalist shqiptar.

Etapa e dytë i përket viteve '40-'70 të të njëjtit shekull, kohë në të cilën fillojnë të dalin në pah manifestet e para të Rilindjes Kombëtare dhe nën influencën e Romantizmit Evropian dhe përmbledhjet e para folklorike. Interesant është fakti se në këto manifeste ndihet një pranim i situatës religjioze në Shqipëri dhe bëhet përpjekje që të mos cenohen marrëdhëniet midis komuniteteve fetare, por gjithsesi ka akuza të tërthorta për situatën e keqe në të cilën gjendet Shqipëria dhe një nga ato sipas *Letrës Encilike Për Të Gjithë Të Pasurit E Të Mësuarit Ortodoksë Shqiptarë* të Naum Veqilharxhit është dhe “hyrje dogmash të reja fetare” (*kupto Islamin*), (*Islami. M, 1977:147*). Po kështu përjashtues mbetet fakti që encilika u drejtohet vetëm “të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptare” (*Po aty: 147*), duke mos përmendur të pasurit e të mësuarit myslimanë një pjesë e të cilëve ishin dhe elitë e Perandorisë turke apo të pasurit e të mësuarit katolikë, të cilët kishin një komunitet të fuqishëm tregtar në Shkodër.

Encilika në këtë mënyrë, sa shpreh një vullnet nacionalist kur flet për përparimin dhe dëshirën për tu vënë “në radhën e kombeve të qytetëruara” (*Po aty: 149*), po aq ka dhe një karakter lokalist e përfaqësuar nëpërmjet titullit të vet. Në këtë etapë vërehet se identiteti fetar vazhdon të jetë një pjesë e rëndësishme e përpjekjes për të formuar identitetin kombëtar.

Efkti i kësaj karakteristike lokaliste të *Encilikës* u mundua që të shmangej në epokën e tretë që i përket viteve 1878-1912, vite të stuhishme këto për themelimin e shtetit dhe identitetit shqiptar. Në fakt lëvizja shqiptare kishte humbur mbështetës që në fillimet e para të tyre kishin përkrahur idenë e shqiptarizmit por nën influencën e prosiletizmit që filloi Patrikana greke e Stambollit jo vetëm ndaj zgjimit nacionalist shqiptar por dhe atij të kombeve të tjerë në Ballkan, kaluan në përkrahës të hapur të helenizmit.

Sigurisht, përkatësia fetare kish qenë një faktor kryesor që i kish kthyer si me “magji” këta figura në identitete të deformuara “greke” sipas kulturës që i përkisnin por që shumë shpejt përqafuan dhe deklaruan dhe identitetin e tyre si “grekë”. Një rast tipik është shqiptari i pasur nga Labova Vangjel Zhapa, i cili nga një përkrahës i një “lëvizje për kulturë kombëtare” (*kupto shqiptare*), (*Po aty: 120*) në vitin 1844, kthehet në një përkrahës të Hellenizmit në vitin 1860 kur polemizon me Naum Veqilharxhin “kundër alfabetit shqiptar” (*Po aty: 84*).

Për të tejkaluar këtë pengesë të rrezikshme që mund të shkaktonte dështimin e projektit nacionalist shqiptar, rilindasit i kushtuan më shumë rëndësi bashkimit sesa identiteteve të veçanta fetare. Në asnjë promemorie apo program të saj nuk do të gjendet më ndonjë thirrje e njëanshme si e Veqilharxhit, bazuar në identitetet fetare. Madje dhe kur do të ketë propozime gjithëpërfshirës si ai i De Radës për një Shqipëri të ardhme federative, “të ndarë në tre njësi, në bazë të besimeve fetare” (*Skëndi, 2000:159*), mendimtari politik i Rilindjes Sami Frashëri do ta kundërshtonte si plan “jo të mirë dhe as të realizueshëm” (*Po aty: 159*). Në vend të njërive të bazuara mbi identitetet e veçanta fetare, të cilat sipas Sami Frashërit do të sillnin ndarje, ai propozonte se “fetë duhet t'i lireshin kishës dhe xhamisë dhe se gjithë shqiptarët duhej të bëheshin vëllezër ashtu siç e kishte caktuar vetë natyra dhe siç kishin qenë në kohët e lashta” (*Po aty: 160*). Të njëjtin mendim ndante dhe Naim Frashëri i cili shprehej në librin e vet *Liga e vërtetë e Shqiptarëve* se “ne të gjithë kemi fe Perëndinë dhe nënë Shqipërinë. Kushdo le t'i falet Perëndisë si të dojë. Po kjo nuk bën të na ndajë” (*Po aty: 159*). Është po Naim Frashëri që në 1898, në prag të vdekjes së tij boton *Istori e Skënderbeut*, një lloj testamenti politik me të cilin poeti kombëtar i shqiptarëve dëshironte t'u jepte kumte të reja bashkatdhetarëve të vet. Në poemë mungojnë referencat fetare, por ka një idealizim të fortë të gjendjes së Shqipërisë të para pushtimit turk.

Në poemë nuk përmendet asnjë institucion fetar apo lidhjet e Skënderbeut me Papët e Romës e aq më tepër cilësimin prej tyre si “Kampion i krishterimit”, por ka një “pamje idilike” (*Sulstarova, 2007:6*), ku si karakteristika të kohës jepen paqa, kama, nderi, shpresa, drejtësia, dashuria, miqësia dhe besa-besa. Nuk është e vështirë të kuptohet se duke mos përmendur asnjë fe konkretisht, por duke dhënë në të njëjtën kohë pothuajse të gjitha karakteristikat e besimeve monoteiste, Naimi Frashëri dëshiron të “krijojë” një besim të përbashkët të gjithë shqiptarëve, të cilin ai e gjen të konkretizuar në epokën e Skënderbeut. Kjo “fe” e re që Naimi kërkon të krijojë nuk është gjë tjetër veçse bashkimi kombëtar i shqiptarëve dhe atdhedashuria. Zgjedhja e figurës së Skënderbeut si simbol i bashkimit kombëtar nuk është e rastësishme, por nëpërmjet figurës së tij rilindësit kërkonin

tepër, në këtë pjesë analizohet zgjimi kombëtar i ortodoksëve shqiptarë mbi të cilët efektet e *Mesharit* dhe i shkrimeve të tjera biblike në shqip pothuajse ka qenë zero për shkak të kundërshtive që kishin Kisha katolike dhe ajo Lindore midis tyre.

të nënvizonin faktin e kundërvënies dhe luftës me turqit për të arritur pavarësinë, simbol të të cilave janë bërë vargjet e Naim Frashërit :

*Jo nuk vdiq Shqipëria
Nuk vdiq por është gjallë
Tjatër përgjigjie Turqia
Nuk do përveç me pallë
(Frashëri, 1966:63)*

Për të shmangur kontradiktat fetare midis shqiptarëve, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve kishin përqaftuar Islamin dhe që ndoshta akoma e shihnin Turqinë si pjesë përbërëse të atdheut të vetë, antagonizmi turko-shqiptar në poemë përshkruhet më shumë si “përplasje qytetërimesh” midis Evropës dhe Azisë sesa dhe kundërvënie fetare siç shihet në letërsinë apo programet politike të kombeve të tjerë ballkanikë. Këtij qëndrimi që ravijëzohet dalëngadalë në mendimin politik shqiptar do t’i qëndrojnë besnik jo vetëm Naim Frashëri që i përkiste vetë besimit mysliman por dhe shkrimtarë dhe ideologë të tjerë të krishterë të Rilindjes Kombëtare.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se kjo zgjedhje e rilindësve ka qenë më tepër e detyruar sesa ka në të një përçmim apo kundërvënie ndaj Azisë-Lindjes. Vetë Naim Frashëri ishte një orientalist i shkëlqyer, i cili madje kish botuar dhe një përmbledhje poetike në persisht. Natyrisht ishte e natyrshme që intelektualët shqiptarë të kishin filluar të kishin një tërheqje ndaj zhvillimit kulturor dhe ekonomik të Evropës, fenomen që nuk ndodhte vetëm ndër shqiptarë që ishin afër Evropës gjeografikisht, por dhe që në momente të ndryshme kishin marrë pjesë aktive në disa nga proceset evropiane, por dhe vetë ndërmjet elitës turke. Shekulli i XIX ishte një shekull i shndërrimeve të mëdha dhe modernizmi ishte prirja e ditës.

Identiteti fetar kish luajtur një rol të fuqishëm dhe frenues në ngjarjet e Lidhjes shqiptare të Prizrenit, ku nuk u arrit të avancohej apo shkohej më tej në kërkesat ndaj Portës së Lartë, sepse “forcat që sundonin në mbledhjen e Prizrenit ishin forca myslimane konservatore dhe nëpërmjet tyre Porta mund të ushtronte një ndikim për interesat të veta. Kjo shpjegon përse shqiptarët e Prizrenit luftonin në fillim, bashkë me boshnjakët myslimanë për një kauzë të përbashkët.” (Skëndi, 2000:46).

Ky lloj dyzimi i elitës administrative shqiptare jo vetëm gjatë Lidhjes së Prizrenit por në vazhdimësi, për t’i quajtur të vetat interesat e perandorisë, do të pengonte dhe vononte rrugëtimin e shqiptarëve drejt pavarësisë.

Duke qenë se patriotizmi lokal, kishte një influencë jo të vogël në botëkuptimin e shqiptarëve, për të cilët mund të qe “një gjë e natyrshme që të kridheshin në mbretërinë më të madhe (*kupto Perandorinë turke*) e të linin pas dore atdheun e tyre të vogël dhe primitiv, interesin e të cilit e shihnin të lidhur ngushtë me atë të perandorisë” (Po aty: 29), gjithsesi

“në përgjegjësi nuk harronin se ishin shqiptarë” (Po aty: 29), faktorit të dytë që iu mëshua për të shmangur dallimet, ishte gjuha kombëtare.

Pothuajse gjithë poetët dhe mendimtarët shqiptarë i kanë kënduar apo thurur himne gjuhës së tyre kombëtare. “Gjuhë perëndie” (Po aty: 120) e quan Naim Frashëri, ai që nuk flet shqip sipas Fishtës, “duket i ulët... Krejt i turpëruar? si ai që... nuk di se kush është babai i tij” (Po aty: 121). Rëndësinë e gjuhës dhe lëvritit të saj e jep Kristoforidhi kur shprehet se “nëse gjuha shqipe nuk do të shkruhet, atëherë brenda një kohe të shkurtër nuk do të ketë më Shqipëri në faqe të dheut dhe as do lexohet më emri shqiptar në hartën e botës” (Po aty: 119). Është ky përkushtim me figurën e Skënderbeut, gjuhën dhe kulturën kombëtare që formon shtratin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, u jep atyre kohezionin që u mungon nga dallimet fetare dhe i përgatit për maturinë e tyre si komb. Në brezin e dytë të Rilindësve gjejmë vargjet monumentale të Andon Zako Çajupit që shpërthen në *Myslimanë e të krishterë / jemi keq / Të ngrihemi të tërë / djem e pleq* (Po aty: 121). Përballë këtyre dy faktorëve, identitetet fetare të nxitura më shumë nga turqit për sa i përket popullsisë myslimane dhe Patrikanës së Stambollit dhe shtetit grek për sa i përket popullsisë ortodokse fillojnë e humbin terren, neutralizohen por jo deri sa të zhduken fare.

Nuk mungojnë edhe rrugët e tjera të tërthorta, të cilat duke e ditur rëndësinë e identitetit fetar kërkojnë të ndërmarrin hapa të rëndësishëm për bashkimin e shqiptarëve duke nxitur përqaftimin e një feje të vetme apo konvertimin në një tjetër perëndimore siç ishte protestantizmi. Është i ditur fakti se në këtë rast Naim Frashëri preferonte dhe propozonte bektashizmin si sekti islam që ishte dhe më afër kristianizmit. Për bektashizmin ai shprehte shpresën se ai do të bëhej një ditë feja e gjithë Shqipërisë, derisa bektashizmi merrte frymëzim në vet si nga *Ungjilli* dhe nga *Kurani*” (Bartl. P, 2006:166). Një propozim tjetër erdhi nga radha e intelektualëve patriotë ortodoksë, të cilët vuanin faktin se përveç që shqipja ndalohej nga autoritetet turke, ata nuk mund ta praktikonin gjatë liturgjisë fetare, sepse ndalohej nga autoritetet kishtare greke. Ata u ndodhën përpara një dileme, “nëse duhej të përqaftonin një degë tjetër të kristianizmit që kështu të hiqnin qafe ndikimin grek dhe të fitonin proteksionin e fuqive dhe popujve të perëndimit?” (Po aty: 169). Për këtë dilemë pati dy versione, gazeta *Kombi* e Bostonit propozoi “kthimin e shqiptarëve në ortodoksë unikë, do me thënë të ruhej liturgjia ortodokse por të njëjhej Papa si udhëheqës suprem shpirtëror” (Po aty: 169), një rast i tillë ishte popullsia e Shpatit në Elbasan, kurse shoqëria shqiptare e Egjiptit mbështeste “konvertimin në protestantizëm, e cila jo vetëm kishte pasues të fortë në perëndim por gjithashtu, duke qenë gjë e re në Shqipëri, mund të tërhiqte pasues nga të tre fetë.” (Po aty: 169) Siç kuptohet dhe nga pyetjet dhe dilemat e ngritura identitetet e veçanta fetare kanë qenë një pengesë serioze për lëvizjen kombëtare shqip-

tare dhe klasa intelektuale shqiptare ishte gati të bënte dhe kompromise të këtij lloji, të cilat natyrisht nuk dihet nëse do të priteshin mirë apo përqafoheshin nga populli i thjeshtë.

Në fakt shqiptarët, nuk ishin të përgatitur për veprime të tilla, pasi ata nuk ishin aq të pjekur politikisht sa të ndërmerrnin një hap të tillë, ndaj në lëvizjen kombëtare shqiptare zuri vend më shumë propozimi i Fan Nolit, i cili nuk e shikonte problemin në ekzistencën e tre feve, por në faktin që “asnjëra nga besimet e njohura në Shqipëri nuk praktikohej në gjuhën shqipe, dhe klerikët qenë armiq me njëri-tjetrin”² (*Po aty: 169*). Më andej Noli shtonte se “fatkeqësia nuk qëndron aq shumë në ndryshimin e feve sesa në krerët fetarë. Ata nuk duhen të jenë të huaj, por shqiptarë dhe patriotë” (*Po aty: 169*). Këtu zë fill projekti i Nolit, i cili themeloi Kishën Autoqefale Ortodokse shqiptare, duke e shpëputur nga ndikimi grek dhe u duke u dhënë një shembull të mirë edhe shqiptarëve të besimeve të tjera sesi mund të fitonin pavarësinë shpirtërore dhe forcimin e vetëdijes së tyre kombëtare. Kështu identitetet fetare fillojnë të përftojnë ngjyrat shqiptare, por gjithsesi kjo rrugë ishte ende e brishtë për të dhënë rezultat menjëherë.

Në prag të shpalljes së pavarësisë, atëherë kur fillon e kuptohet se bërja e Shqipërisë si shtet i pavarur është shumë afër dhe e pashmangshme, identiteti fetar rigjallërohet sërish për të dalë në skenë herë në trajta të verbëta në formën e kryengritjeve dhe herë denoncues për lirinë e munguar përgjatë pushtimit të gjatë turk. Influenca e tij përgjatë viteve të para të pavarësisë dhe formimit të shtetit modern të shqiptarëve do të jetë jo e papërfillshme dhe madje në disa raste përcaktuese.

Madje ai është prezent dhe në programin prej 14 pikash më 9 gusht 1912 që kryengritësit shqiptarë kërkuar të realizohej nga qeveria turke për të fituar autonominë, ku në një nga pikat krahas krijimit të liceve me bazë gjuhën shqipe, kërkohej dhe “krijimi i *medreseve* (shkolla me mësim fetar mysliman) dhe ruajtja e adeteve dhe zakoneve të Islamit” (*Po aty: 389*). Prania e këtyre pikave në programin autonomist shqiptar tregonte se identiteti fetar përbënte gjithashtu një pjesë të rëndësishme të vetëdijes së shqiptarëve, e cila nuk mund të mos merrej parasysh. Shqipëria hynte në radhën e kombeve të rinj të kontinentit, si kombi me katër besime fetare, si askush tjetër më parë.

III

Ekzistenca e shtetit shqiptar të vitit '13 e në vazhdim do përbente një kuriozitet të veçantë sociologjik për të gjithë ata që do ta ndiqnin nga afër, pasi kërkohej të kryhej pothuajse e pamundura, të ngrihej dhe mbijetonte një shtet me fqinjë

agresivë që nuk dëshironin që ta njihnin pasi tokat shqiptare i konsideronin si plaçka të luftës ballkanike që kishin fituar, me rezerva financiare të pamjaftueshme as për të paguar rrogat e nëpunësve të vet dhe me një popullsi që ishte në mes të formimit të identitetit kombëtar dhe e ndarë në katër besime fetare.



Fan Noli

Për sa i përket armiqësisë së fqinjëve, kjo gjë nuk mund të ishte e pakapërcyeshme pasi herët a vonë nën presionin e fuqive të mëdha Austro-Hungarisë dhe Italisë fqinjët do të neutralizoheshin, po kështu gjendja financiare do të përmirësohej, pasi Shqipëria zotëronte burime natyrore dhe me ndihmën e fuqive të mëdha të interesuara për të, do të dilte nga kriza. Problemi i vërtetë nuk do të qëndronte as në marrëdhëniet midis komuniteteve fetare, pasi Shqipëria deri në atë kohë kish demonstruar një tolerancë fetare deri diku të pranueshme, por në ndarjen e pushteteve në shtetin e ri, ku myslimanët kishin pasur privilegjet tradicionale të pjesëmarrjes në qeveri, kurse të krishterët katolikë në veri dhe ortodoksë në jug kishin qenë të përjashtuar.

Kjo do të ishte sfida më e madhe në shtetin e ri, ku identitetet fetare do të kërkonin të rikonfiguroheshin në kërkim të afirmimit të tyre për të ndarë më vonë tortën e pushtetit. Logjika që mund të ekzistonte ishte se përderisa shteti i ri u krijua nën kujdestarinë e Evropës, të krishterët shqiptarë do të kishin më tepër pjesëmarrje dhe se myslimanëve do u duhej të hiqnin dorë nga privilegjet tradicionale.

I pari që e kuptoi këtë ishte publicisti Faik Konica i cili në një artikull të vet qysh në prag të shpalljes së pavarësisë “drejtuar vetëm myslimanëve vinte në dukje se për ata po afrohej një rrezik iminent” (*Skëndi, 2000:359*). Më tej Konica shtonte se “ishte i sigurtë se otomanët do të dëboheshin prej Evropës dhe shqiptarët myslimanë rrezikonin kështu të përziheshin dhe ata dhe vendi i tyre të ndahej” (*Po aty: 359*). Prandaj sipas Konicës “kishte vetëm dy zgjidhje për bashkëfetarët e tij: ose të ktheheshin në fenë e stërgjyshërve të tyre, domethënë të bëheshin të krishterë, ose të mbeteshin myslimanë, por të ishin aq të afërt dhe sinqerisht të bashkuar me të krishterët, sa t'i jepnin kombit një karakter semi-kristian” (*Po aty: 359*). Më andej Konica vazhdonte të këshillonte se “përderisa rikon-

2. Bëhet fjalë për liturgjinë fetare e cila praktikohej në gjuhë të huaj: latinisht për katolikët, greqisht për ortodoksët dhe arabisht për myslimanët.

3. Kjo pjesë është cituar nga libri i Stavro Skëndit dhe për hir të origjinalit është lënë ashtu.



Faik Konica

versioni nuk mund të bëhej, shqiptarët mund ta mbanin fenë Islame, por në të njëjtën kohë të largoheshin nga e keqja politike që vinte prej saj: identifikimi nga të huajt i shqiptarit mysliman me turkun” (*Po aty*: 359-360). Ndoshta Konica ekzagjeronte pakëz kur kërkonte që kombit t’i jepej një “karakter semi-kristian” pasi ndoshta nuk ishte e nevojshme të shkohej deri në atë pikë dhe as vetë popullsia myslimane nuk ishte e gatshme për një gjë të tillë, por që ishte e nevojshme një ri-rregullim i ri në raportet mes myslimanëve dhe të krishterëve, kjo patjetër që s’kishte diskutim.

Për një kohë të gjatë dhuna feudale e identifikuar dhe shpesh herë si dhunë fetare ndaj të krishterëve në Shqipëri, kish krijuar të çara të mëdha, të cilat kërkoheshin të riparoheshin. Në formimin e qeverisë së parë shqiptare u morr parasysh identiteti fetar dhe ajo përfaqësonte të katër besimet. Caktimi i një princi evropian, një vit e gjysmë më vonë, krijoi të çarat e para në besimin e ri të ndërsjellë që po krijohej.

Një rol të rëndësishëm në acarimin e situatës luanin dhe fqinjët ballkanikë të Shqipërisë që kërkonin të destabilizojn shtetin e ri dhe xhonturqit që kërkonin të rikonfirmonin influencën e tyre nëpërmjet caktimit të një princi mysliman. Këta të fundit “duke shfrytëzuar në mënyrë të veçantë grupe fanatikësh myslimanë boshnjakë, që ishin vendosur në Shqipëri nën mbrojtjen e Portës, në kohën e pushtimit austriak të Bosnjë-Hercegovinës” (*Salleo, 2000:86*) si dhe ndjenjat islamike të një pjese të popullsisë vendase “organizuan një kryengritje të vërtetë” (*Po aty*: 86) me tendencë islamike kundër qeverisë së Princ Vedit. “Këta agjitorë kishin përhapur lajme se princi, që ata e përshkruanin si hebre, kishte ndërmend të ndalonte Islamizmin dhe kjo shkaktoi zemërim tek myslimanët boshnjakë, zemërim që përfshiu dhe myslimanët sunitë, që mendonin se një hap i tillë do dhunonte lirinë e tyre. Për më tepër, shumë myslimanë kishin frikë se princi, si i krishterë do përmbyste në favor të të krishterëve epërsinë shoqërore që ata si myslimanë kishin gëzuar gjatë regjimit turk” (*Swire. J., 2005:176*) Lëvizja ka hyrë në histori si “kryengritja e Haxhi Qamilit” dhe përfaqëson një nga episodet më të errtë në historinë moderne të shqiptarëve. Kërkesat kryesore të “kryengritësve” ishin që Shqipëria të futej nën *suzer-*

ainite turk, përdorimi i flamurit turk dhe i turqishtes si gjuhë zyrtare në shtetin e ri.

Identiteti fetar shfaqej kështu në formën më të egër dhe primitive për të shkatërruar identitetin kombëtar që mezi kish filluar të merrte jetë. Në të njëjtën kohë por me një kahje tjetër për sa i përket identitetit fetar shpërthen dhe rebelimi i ashtuquajtur “epirot” në jug të Shqipërisë, i organizuar nga një renegat shqiptar, Kristaq Zografo-ish ministër i jashtëm i Greqisë nga fshati Qesarat i Lunxhërisë dhe një nga “shpirtërat e humbur” të shqiptarëve në betejën e tyre me helenizmin dhe Kishën greke. “Rebelimi” u nxit dhe u mbështet nga ushtritë pushtuese greke, të cilat kishin hyrë në territorin shqiptar, përkatësisht në Gjirokastrë e Sarandë. “Bandat epirote” të Zografos mundën të marrin pjesë si palë në bisedimet që Komisioni ndërkombëtar ndërmori me autoritetet greke, bisedime nga të cilat u formulua dhe “Protokolli i Korfuzit”, që iu dërgua Fuqive të Mëdha për ta miratuar, miratim i cili erdhi në datën 2 Korrik.

“Dispozitat e protokollit ndërmjet të tjerash parashikonin shndërrimin e bandave të armatosura në xhandarmëri lokale, e cila do të ushtronte detyrat e saj vetëm në qarqet e Korçës e të Gjirokastrës. Në të dyja rrethet, qeveria shqiptare do të emëronte guvernatorë të krishterë, pranë të cilëve do të vendoseshin këshilltarë të zgjedhur nga vota e popullit. Sigurohej liria e plotë e besimit, ndërsa gjuha greke do të mësohej në shkollat fillore, si dhe do të përdorej në administratë dhe në sistemin e drejtësisë” (*Salleo, 2000:78*).

“Kjo xhandarmëri që përbehej nga vullnetarë që tashmë ishin nën armë” (*Po aty*: 78), përbën pikën më të errët të kësaj historie pasi asnjëherë nuk është theksuar në historinë zyrtare të Shqipërisë se këta vullnetarë ishin banorë lokalë të krishterë të Shqipërisë së jugut, të cilët “mbajtën një qëndrim të dyzuar duke u luhatur ndërmjet ndjenjave nacionaliste nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, filohelenizmit, rezultat i lidhjes së tyre me Greqinë dhe propagandën greke.” (*Swire. J., 2005:160-161*). Sigurisht këto ndjenja nuk mund të ishin arsye të mjaftueshme që këta njerëz në emër të identitetit të tyre fetar të braktisnin identitetin etniko-gjuhësor si shqiptarë, për të përfaqësuar një identitet tjetër kombëtar, por që shoqëria shqiptare e asaj kohe i duhej të bënte një “mea culpa”, për sa i përket dhunës feudale që shpesh herë aristokracia shqiptare myslimane kish ushtruar mbi popullsitë krishtere shqiptare, ky duhej të ishte pa diskutim një nga hapat e parë që ajo duhej të ndërmernte për të realizuar një bashkim të vërtetë kombëtar. Madje, ekzistencën e kësaj dhune dhe mosbarazie në të drejta kish arritur që të shfrytëzonte propaganda greke që kish arritur të ngjallte frikën “midis shtrësve filohelene-që politikisht nuk ishin progreske” (*Swire. J., 2005:161*) se një “qeveri shqiptare e mbizotëruar nga myslimanët do të vazhdonte ta konsideronte elementin ortodoks si inferior ndaj elementit mysliman sikurse kish ndodhur nën

sundimin otoman” (*Po aty: 161*). Në fakt ai shqetësim nuk i përkiste vetëm asaj periudhe, ai kish filluar më herët qysh gjatë shtypit të Rilindjes ku kish patur një debat të gjerë mbi barazinë politike të shtetasve në shtetin e ardhshëm shqiptar, ku natyrisht nuk kishin munguar dhe tonet e ashpra. Një nga më të ashprtit ishte poeti Asdreni i cili në artikullin e vet “Dy fjalë për Aristokracinë” botuar në *Albania* theksonte se:

“Nëse Shqipëria ishte duke fituar pavarësinë e saj... ajo mundet dhe të mos e fitonte këtë, në qoftë se të gjithë shqiptarët nuk kanë për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre; dhe nëse duam të ndjekim idetë e mëdha: barazi, vëllazëri, liri-atëherë ç’nevojë ka kombi të ndahet në shkallë, me zotërinj dhe skllëvër? Shqiptarët duhet të jenë të barabartë midis ligjit. Titujt duhen të hiqen... Apo mos vallë besoni se aristokracia duhet të urdhërojë dhe atëherë siç bën tani?” (*Skëndi, 2000:175*)

Ky paragraf shpesh herë është komentuar edhe si parim i luftës së klasave nga historiografia komuniste, por dhe nga historinë shqiptarë në përfundim (*shih Skëndi Stavro, Zgjidhje kombëtar shqiptar, Tiranë, dhjetor 2000*), por në të vërtetë pasqyron një realitet të hidhur që ishte mbizotërues në Shqipëri në atë kohë. Asdreni jetonte dhe punonte në Rumani e cila ishte një monarki, dhe asgjëkund tjetër nuk gjenden shkrime që të jetë kundër aristokracisë në përgjithësi, por mendimi i tij i drejtohej pikërisht kundër arbriritetit me të cilin qeveriste aristokracia shqiptare në atë kohë. Është shumë i rëndësishëm të kuptohet fillimi i këtij debati sepse në vitet ’20 ai do të marrë përmasa më të mëdha dhe kontestuesit e klasës feudale nuk do të nisen nga premisa thjesht anti-lindore kur do ta cilësojnë aristokracinë feudale si “anadollake” (*Sulstarova, 2007:7*), por me këtë term do të identifikonin burimin e privilegjeve që ata kishin fituar gjatë pushtimit turk. Anadulli konsiderohej si vendi ku ishte themeluar shteti i osmanëve, “ndaj dhe Ataturku e transferoi kryeqytetin e shtetit të ri turk nga Stambolli kozmopolit në Ankara, duke dashur të në këtë mënyrë të përforcojë dhe tregojë karakterin aziatik të kombit turk” (*Aleksandri. A, Istorika 2000:12*) Identifikimi shpesh herë me lavdinë perandorake të familjeve aristokrate shqiptare vazhdonte dhe pas pavarësisë dhe hapësira e shtetit të ri që u krijua nuk i mjaftonte asaj për të demonstruar ambiciet e veta për karrierë prandaj dhe vetë midis saj pati një konflikt të fortë për pushtet.

Përfaqësuesi tipik i saj ishte Esat Pashë Toptani, i cili në një intervistë të dhënë në një gazetë italiane në vitin 1914 kur fliste për ardhjen e princ Vidit në Shqipëri, “nuk i mohonte simpatitë e tij për Turqinë” (*Salleo, 2000:61*), por në të njëjtën kohë i zotohej princit se “askush tjetër përveç tij nuk do të bëhej mbret i Shqipërisë në qoftë se princi jepte dorëheqjen” (*Po aty: 62*), duke shprehur në këtë mënyrë ambiciet e tij personale.

Lufta e Parë Botërore i fashiti për një moment konfliktet e brendshme të bazuara në identitetet fetare, pasi shteti shqiptar pushoi së ekzistuari dhe Shqipëria u bë shesh lufte.

Ashtu si dhe në periudhën e para pavarësisë dhe tani çështja shtrohej për garantimin e pavarësisë së Shqipërisë prandaj identiteti fetar nuk luan ndonjë rol shkatërrues apo pengues. Aq më tepër që një pol i rëndësishëm i tërheqjes shpirtërore të shqiptarëve myslimanë, perandoria turke ishte shkatërruar, po kështu ishte shkatërruar dhe perandoria e Habsburgasve, poli tradicional mbështetës i katolikëve shqiptarë me politikën e vet të “Kulturprotectorat”, si dhe perandoria ruse një mbështetëse e fortë e ortodoksisë. Fuqitë lokale fqinje nuk mund të luanin më rolin e këtyre perandorive, ndaj identiteti fetar i shqiptarëve tashmë hyn në një fazë të re, në atë të afirmimit dhe ndarjes së pushtetit në shtetin e ri, sesa forcimit të karakterit të vet shpirtëror dhe dallues. Delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris do ketë përfaqësues të tre besimeve, po kështu regjencia e parë që krijohet më 1921 kishte në përbërje të saj katër përfaqësues, të cilët përveç cilësive të tyre politike përfaqësonin dhe të katërt komunitetet fetare.

Natyrisht që nuk mund të mungojnë dhe shpërthimet e identitetit fetar, siç është rasti i “vetëshpalljes” së republikës së Mirditës më qershor 1921, nga ana e prijësit katolik Marka Gjoni, i cili kërkonte “të krijonte një republikë të pavarur nën kujdesin e Jugosllavisë. Justifikimi i Gjonit për shkëputjen nga Shqipëria ishin prirjet “xhonturke” (*kursivi është i origjinalit*) të qeverisë së Tiranës dhe qëndrimi i saj armiqësor ndaj lirisë së katolikëve” (*Austin, 2003:57*). Mirdita dhe fiset katolike po e kalonin tani ethet e forta të identitetit fetar që kish kaluar Shqipëria e mesme me lëvizjen e Haxhi Qamilit dhe një pjesë e Shqipërisë së jugut me lëvizjen “epirotase” të Kristaq Zografos. Gjithsesi, në veprimin e Marka Gjoni kish më tepër një prapavijë politike sesa fetare. Si prijës i një krahine që historikisht ishte qeverisur tradicionalisht nga familja e vet, Marka Gjoni nuk mund të pranonte të ishte një qytetar i zakonshëm i shtetit të ri, ndaj thërriste në ndihmë identitetin fetar për të krijuar një identitet të ri shtet formues, natyrisht për të ruajtur pozitat e veta sunduese në krahinë. Akuzat e Marka Gjoni nuk ishin të vërteta pasi siç deklaroi anëtari i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë Mithat Frashëri, “qeveria e Tiranës nuk ishte qeveri muhamedane. Në kabinetin e saj kishte përfaqësues nga të gjitha fetë shqiptare.” (*Po aty: 57*), por ato arritën ta vinin në vështirësi delegacionin shqiptar, i cili i duhej të përballej me faktin se brenda territorit të vet ishin dy qeveri dhe në këto kushte Fuqitë e Mëdha mund ta vononin njohjen diplomatike të Shqipërisë. Lëvizja nuk u mbështet as nga kleri katolik i Shkodrës duke zhvlerësuar në këtë mënyrë pretendimet e pa baza të Gjonit.

Prapavijat politike do të bëhen shprehëse të një lufte për pushtet, e cila kur nuk do të gjej argumente bindëse për të mposhtur kundërshtarin do u kthehen identiteteve fetare duke dhënë kampionin e alarmit se të drejtat e njërit grup po

shkelen nga tjetri. Kështu grupet politike dhe partitë që do të rreshtohen në parlament, shpesh herë do të kenë ngjyra lokaliste, krahinore dhe i vetmi karakteristik e përbashkët do të jetë besimi fetar. Kështu blloku mysliman i çifligarëve do të rreshtohet në Partinë Përparimtare, intelektualët ortodoksë në Partinë Popullore dhe intelektualët katolikë në grupin parlamentar të quajtur “Ora e Maleve”. Të gjitha këto grupe do të jenë shumë të ndjeshëm ndaj pushtetit politik dhe sidomos çështjes së tokës që përbënte një pikë kyçe në marrëdhëniet e barazisë qytetare. Shumica e çifligarëve myslimanë nuk dëshironin që të bëhej një reformë agrare pasi pretendonin se toka ishte e trashëgueshme, ndërsa intelektualët ortodoksë dhe katolikë pretendonin se tokën çifligarët e kishin fituar si rezultat i privilegjeve që kishin pasur në perandorinë turke ndaj ajo duhej t’i nënshtrohej reformës agrare.

Në këtë kuadër nuk mënonin të ndizeshin dhe debatet të bazuara mbi identitetet fetare se kujt i përkiste toka dhe rrjedhimisht Shqipëria, atyre që kishin përqaftuar Islamin dhe kishin bashkëpunuar me turqit apo atyre që kishin ruajtur besën e të parëve dhe kishin vuajtur dhunën feudale për shekuj me radhë? Debatet do të vazhdonte të ishte i hapur përgjatë viteve ’20-’24 dhe në një farë mënyre vazhdon të ketë spiralet e veta deri në ditët e sotshme. Me rastin e debatit për identitetin Kadare-Qose, publicisti dhe piktori Maksi Velo do t’iu drejtohet “pasardhësve të atyre që u myslimanizuan” (Sulstarova, 2007:9) se:

“Për çfarë patriotizmi mund të flasin ata që tradhëtuan fenë e të parëve dhe fenë e gjithë Ballkanit dhe Evropës, Krishterimin. Shqipërinë e ka sjellë në këtë gjendje (si vendi më i prapambetur dhe më i varfër), pikërisht kjo tradhti nga një pjesë e shqiptarëve. Shqipërinë e solli në këtë gjendje Islami, që ishte një regres i pashembullt. Jemi i vetmi popull në Evropë që kemi pasur një tragjedi të tillë. Të paktën tani pasardhësit e tradhtarëve të heshtin” (Sulstarova, 2007:9).

Tone të tilla është vështirë të gjejmë në gjithë literaturën e hershme të Rilindjes po dhe në atë të viteve ’20. Këtë lloj ligjërimi Noli do të mund ta cilësonte si një ilustrim të idesë së tij të anarkisë fetare, të cilën e radhiste në një nga pesë anarkitë që “pengonin integritimin kombëtar të shqiptarëve” (Austin, 2003:34). Noli kish qenë “veçanërisht gjithmonë i shqetësuar për ndikimin që do të kishin fetë e ndryshme ndaj bashkimit kombëtar, duke vërejtur se bashkimi fetar kishte qenë shumë i rëndësishëm për kombet e tjerë të Ballkanit si grekët dhe serbët. Për të, për sa kohë qytetarët ortodoksë shqiptarë ishin nën kontrollin e Patrikanës greke dhe myslimanët nën ndikimin e Turqisë do të kishte pak progres” (Po aty: 34). Prandaj Noli do të vazhdonte punën e tij titanike të themelimit të Kishës Autoqefale Ortodokse shqiptare me një pasion të madh duke u shkëputur dhe për një vit nga karriera politike, në mënyrë që në mos të realizohej dot bashkimi fetar për shkak të ekzistencës së tre feve të ndryshme, të paktën

shqiptarët të kishin institucionet e tyre të pavarura fetare.

Në të njëjtën rrugë do të ecte dhe komuniteti mysliman shqiptar, i cili do të kërkonte që të ishte i pavarur nga Stambolli, ndërsa bektashinjtë për shkak të përndjekjeve në Turqi, e patën më të lehtë për të siguruar pavarësinë nga teqeja e tyre mëmë. Të gjitha këto hapa, shprehnin një emancipim të elitës shqiptare e cila e shoqëruar dhe me tolerancën tradicionale fetare të shqiptarëve, krijonin premisa për ekzistencën dhe mbijetesën e shtetit të ri. Reformat për përfundimin e institucioneve fetare të pavarura vazhduan dhe gjatë qeverisjes së mbretërisë, ku në përgjithësi u ruajt formula tashmë tradicionale e pjesëmarrjes së të krishterëve në kabinetet ministrore, madje dy kryeministra ishin të tillë, Pandeli Evangjeli dhe Koço Kota. Reformat e ndërmarra më 1928 në kuadër të miratimit të Kodit civil, për zëvendësimin e statusit fetar në të cilin bazohej juridiksioni i Islamit në sektorë të gjerë të jetës shoqërore dhe familjare me atë personal, laik dhe heqjen e gjyqtarëve islamikë, kadinjve nga puna nuk shkakton ndonjë oponencë të madhe nga ana e popullsisë dhe ishte prova e parë se shteti mund të ndërhynte për të dhënë shoqërisë dhe fesë një fytyrë më moderne. Në gusht 1929 organizohet Kongresi i myslimanëve suni shqiptarë i cili miraton një sërë “masash radikale” të cilat do të ishin: përdorimi ekskluziv i gjuhës shqipe për lutjet dhe predikimin, unifikimi i medreseve dhe seminareve në një institut të vetëm formimi për tërë mbretërinë; administrimi i centralizuar i të gjitha pasurive të vakëfeve; mbyllja e shumicës së xhamive, duke mbajtur dy apo tre në çdo qytet; detyrimi i çdo funksionari fetar për të mbajtur një letërnjoftimi të lëshuar nga qeveria e Tiranës. (Dela Roka, 1994:29-30)

Këto masa të miratuara nga Kongresi, në shtator të vitit 1928, do të kodifikoheshin në një statut ligjor për bashkësinë myslimane të Shqipërisë. Ndër detyrat kryesore në të cilat angazhohej bashkësia myslimane në bazë të statuteve ishin ato të “inkurajimit të myslimanëve për t’iu konfirmuar qytetërimit modern” dhe të “ndihmesës për të zhvilluar vëllazërimin kombëtar nëpërmjet shqiptarëve të çdo besimi” (thonjëzat janë të origjinalit). (Po aty: 31)

Gjithsesi pati pakënaqësira në radhët e klerit mysliman dhe “besimtarëve të devotshëm myslimanë në qendrat urbane por kjo rezistencë u mposht pa vështirësi” (Po aty: 31)

IV


Analiza tradicionale të marrëdhënieve midis shteteve dhe besimeve fetare tregojnë se ka tre modele të tilla. “Modeli i parë është sistemi i bazuar në marrëveshje midis shtetit dhe besimeve fetare, modeli i dytë është sistemi i karakterizuar nga ekzistenca e kishës shtetërore apo nacionale dhe sistemi i tretë, i cili ka një ndarje të qartë midis shtetit dhe besimeve fetare.” (Sinani, 2007:15). Modeli i tretë i cili quhet dhe

secularist apo laik dhe është modeli të cilin ka marrë për bazë shteti shqiptar për të ndërtuar marrëdhëniet e veta me komunitetet fetare. A është kjo zgjedhje, një prirje moderniste e shqiptarëve apo është një zgjedhje e detyruar për shkak të identiteteve të ndryshëm fetarë që është e përbërë Shqipëria? Natyrisht përgjigje nuk mund të jepet lehtë, veçanërisht nëse krahason aspekte të tjera të jetës dhe kulturës sonë për të parë nëse ato kanë qenë kaq moderne sa prirja e shqiptarëve përkundrejt besimit fetar në këto 85 vjet të shteti të stabilizuar shqiptar. Por edhe në qoftë se nuk është kështu, do me thënë zgjedhja në fillimet e viteve '20 ka qenë e imponuar për shkak të realiteteve fetare, askush nuk mund ta mohojë sot prirjen moderniste të identitetit fetar të shqiptarëve.

Kjo prirje është e lidhur shumë e ngushtë dhe me identitetin kombëtar kaq të përfolur në ditët tona, aq sa shpesh herë duket se në debatin Lindje-Perëndim do të përcaktohet dhe vendi i shqiptarëve në hemisferë sipas besimit të tyre fetar. Kjo lloj përqasje mendoj se është e gabuar, sepse të kërkojmë t'i përshtatesh mjedisit (domethënë Evropës ku jetojmë) do të thotë që ta konsiderosh veten një "patate të Lisenkos", e cila rritet dhe fryhet por humbet shijen e vetë origjinale. Ka një farë përkushtimi të shqiptarëve në ditët e sotshme me pragmatizmin e skajshëm të "evropianizimit" të jetesës së tyre, ku dhe identiteti fetar tashmë i paracaktuar sipas disave, përderisa rrojmë në Evropë duhet të ketë një tendence kristianizmi, ose në qoftë se jo e tillë, të "paktën semi-kristian" siç e përcaktonte Konica në prag të shpalljes së pavarësisë. S'ka asnjë gjë të keqe nëse në momente të caktuara individë apo grupe njerëzish vendosin të përqafojnë një identitet tjetër fetar nga ai i mëparshmi apo ai i prindërve të tyre, aq më tepër që kjo "është e garantuar nga *Karta e të drejtave themelore*, artikulli 10" (Sinani, 2007:16), por kur kjo tendencë shkon dhe në përqafimin e një identiteti kombëtar tjetër atëherë këtu çalon diçka dhe duhet të fillojmë të dyshojmë nëse zgjedhja është bërë sipas kërkesës shpirtërore të pa përmbushur nga besimi i mëparshëm apo thjesht pragmatizëm në përfitim të një statusi të qytetarit të hemisferës perëndimore? Me hemisferë perëndimore nënkuptoj Perëndimin me të tërë zhvillimin e tij social, historik kulturor, përkundrejt Lindjes të përfaqësuar nga hemisfera lindore. "Për evropianët " sipas Saidit "e para është quajtur "bota jonë" kurse e dyta "tjetri" (kursivi është i origjinalit) negativ i saj" (Sulstarova, 2007:1).

Shqiptarët kanë pasur fatin historik (*mirë apo për keq, kjo mbetet ende një pyetje e hapur*) t'u përkasin të dyjave influencave dhe të jenë vendi ku të dyja botët janë ndeshur ashpër. Vetëm 95 vjet më parë territori ynë konsiderohej Lindja e Afërme dhe ishim pjesë e një perandorie që shtrihej nga Eufrati deri në Ballkan, kurse 95 vjet më vonë territoret tona quhen Ballkani Perëndimor dhe jemi gati të hyjmë në njësinë më të përparuar për sa i përket sot zhvillimit kulturor, social dhe ekonomik -Bashkimin Evropian. A do të marrim me

vete ndonjë gjë nga të qenit tonë si *ex-Near Eastern* apo do hyjmë si *present-Balkan Western*, që është afër për të mos thënë më mirë *pro-european life style*. Përgjigjen mund ta kërkojmë ta gjejmë në diasporat shqiptare në Evropë, të cilat janë integruar më shpejt sesa popullsia në Shqipëri në tërësinë administrativo-ekonomike ku ne aspirojmë të hyjmë.



Gjergj Fishta

Fatkeqësisht, vihet re një ri-gjallërim i identitetit fetar disa herë të trashëguar disa herë të fituar në vendin pritës, dhe që shpesh herë është i shoqëruar dhe me përqafim të një identiteti tjetër kombëtar. Rasti më flagrant në këtë drejtim është "vetëshpallja" e disa banorëve të Himarës apo banorëve të disa fshatrave të tjerë të Shqipërisë se Jugut që i përkasin besimit ortodoks si grekë, duke sjellë edhe njëherë ndërmend turbullimin social të 1913. Jemi ndoshta nga të paktat shtete në Evropë që mund të kemi probleme të vetëdijes kombëtare dhe të "kacafytjes" nacionaliste për të bindur njerëz tanë, bashkatdhetarë se na përkasin "neve" dhe jo "të tjerëve".

Në fakt fenomeni nuk është i ri, pasi në asnjë komb tjetër në Evropë nuk gjendet shprehja "gjaku ynë i shprishur". Për shkak me radhë shqiptarët furnizuan repartet drithëruese të jeniçerëve dhe shpesh herë qindra nga ata bënë një karrierë të shkëlqyer me një identitet të ri fetar dhe identitet të ri kombëtar, por çështja shtrohet, nëse gabuam njëherë në mugullirat tona të historisë, kur nuk ishim të ndërgjegjshëm si komb, a duhet të gabojmë tani sërish në prag të festimit të njëqindvjetorit të pavarësisë?

Duke qenë njëherë viktima të një inxhinierie sociale që na shkatërroi rëndë sepse kthimi jonë nga *njeriu i ri* i socializmit real në *homosapiensin normal* u shoqërua me trauma, efektet e të cilave i shikojmë përditë rreth e rrotull, do të jetë shumë e vështirë që të ndërtojmë apo të marrim hua një identitet tjetër. Nëse ekzistenca dhe mbijetesja e shtetit shqiptar të vitit 1913 ka pushuar së qeni një eksperiment sociologjik, dhe është tashmë një realitet atëherë suksesin nuk duhet ta shikojmë në tipin e këshillave *koniciane* për të përqasur identitete, por në diversitetin e këtyre identiteteve.

Shoqëria e sotshme shqiptare pas një rrugëtimi të gjatë të integritetit të kulturave, si rezultat i identiteteve të ndry-

shme fetare, është çka Evropa ka propaganduar dhe kërkuar të jetë shoqëria e saj në të ardhmen. Krisma e armës që vrau arkidukën Ferdinand në Sarajevë më 1914, prishi përgjithmonë dhe Bosnjën idilike të Ivo Andriçit dhe *statusquo*-në fallco të harmonisë midis identiteteve fetare që së ndjenin veten një komb. Fatmirësisht shqiptarët kanë zgjedhur që të ndihen si komb dhe pastaj të identifikohen si identitete fetare dhe kjo prirje moderniste e tyre ka treguar se ka qenë zgjedhja më e mirë që kanë bërë ndonjëherë.

Përgjigja proverbiale e poetit kombëtar të shqiptarëve patër Gjergj Fishtës, kur një diplomat francez e pyeti sesi ka mundësi që të besosh në mbijetesën e një shteti të tillë me tre besime, ishte: “Po, është e vërtetë zotëri se kemi tre besime, por ne nuk kemi pasur ndonjëherë Natë Shën Bartolomeu”, vazhdon të mbetet sfiduese edhe për kombe dhe shtete shumë më të zhvilluara sesa Shqipëria.

V

Identiteti fetar dhe bashkimi fetar ka qenë një nga qelizat më të forta të shoqërive, që kanë aspiruar dhe janë krijuar si kombe. Në vende të ndryshme këto tipare vazhdojnë ende të jenë përcaktues për zgjedhje të ndryshme apo hartimin e politikave të ndryshme. Në Shqipëri për shkak të ekzistencës së tre besimeve fetare, identiteti fetar u mënjanua nga zgjimi nacionalist i tyre, duke ia lënë rrugën kulturës dhe gjuhës kombëtare.

Në periudha të ndryshme identiteti fetar influençoi në zgjedhje lokaliste, por ai s'arriti dot që të pengonte procese integruese, falë të cilave shqiptarët u themeluan si komb dhe në të njëjtën kohë u bënë pararendës të një sistemi vlerash aq të dëshirueshëm sot në Evropë. Prirjet moderniste të shqiptarëve, duhet t'i qëndrojnë zgjimit të tyre nacionalist, duke

u munduar për të nxjerrë vlerat më të mira të tyre dhe jo të imitojnë apo krijojnë identitete të reja.

Integrimi në familjen evropiane, nuk do të thotë detyrimisht pragmatizëm por para së gjithash është integrim vlerash dhe në këtë kontekst shqiptarët kanë se ç'afrojnë nga historia e tyre e gjatë e formimit si komb.

Bibliografi

Aleksandri. A., *Mustafa Qemali-Pashai Evropian*. Istorika, Benizelos-Ataturk. Afrimi Greko-Turk 1928-1932. Athinë (9 Mars 2000).

Austin, C. Robert.(2003). *Shtegu i Pashkelur i Fan Nolit*. Tiranë: Albin

Bartl, P (2006). *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*. Tiranë: Dituria.

Islami, M. (1977). *Naum Bredhi-Veqilharxhi*. Tiranë: 8 Nëntori.

Moroco Dela Roka, R. (1994). *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: “Elena Gjika”.

Mema, Sh. (1988). *Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve anglezë*. Tiranë: 8 Nëntori.

Peçi, A. (2006). Kisha-xhami: “Dilema e madhe e Rozafës”. Internet: <http://www.tokashqiptare.com/kultura/10.htm>

Salleo, F. (2000). *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*. Tiranë: Shtëpia e librit dhe komunikimit.

Sinani, Gj. (2007). “European model of relations between state and religion”. *The National Interest*, 1:15.

Skëndi, S. (2000). *Zgjimi kombëtar shqiptar*. Tiranë: Phoenix.

Swire, J. (2005). *Shqipëria-Ngritja e një mbretërie*. Tiranë: Dituria.

Sulstarova, E. (2007). *Orientalizmi shqiptar dhe debati mbi identitetin*, Vlorë: Universiteti Veror.

KOMPROMISI I BRUKSELIT

27 vendet europiane të mbledhur gjatë dhjetorit në Bruksel arritën një marrëveshje mbi rrugën që duhet ndjekur për t'i bërë ballë ndryshimit klimatik dhe krizës energjetike. Pas shqetësimeve të vendeve të Lindjes, Italisë dhe Gjermanisë, anëtarët e Bashkimit European votuan që Europa brenda vitit 2020 duhet të reduktojë çlirimin e CO₂ me 20% në krahasim me nivelet e vitit 1990 duke shtuar në të njëjtën kohë me 20% efikasitetin energjetik dhe burimet e ripërtëritshme. Megjithatë, ky rezultat u arrit me një kompromis: për shkak të krizës ekonomike disa ndërmarrje gjermane dhe italiane nuk do të hyjnë në sistemin e “Emission trading” të vendosur nga Protokollin e Kyotos.

Në fakt, nga janari 2005 (me hyrjen në fuqi të direktivës europiane 2003/87), sasia e gazrave serrë që çdo ndërmarrje çliron ka një kufi të caktuar; kush çliron më shumë gaz duhet të paguajë për kuotat e tepërta. Vendet e Lindjes do të marrin ndihma të rëndësishme ekonomike për të transformuar sistemin e tyre energjetik, të bazuar kryesisht te qymyri.

Me rezerva e pritën këtë kompromis Greenpeace dhe Wwf, që në këto kushte e gjejnë jo shumë realist objektivin e reduktimit të gazrave deri në vitin 2020. Tani fjala e fundit i takon Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit European.

Kapitali

Recension libri


Lindita Komani

lindita.komani@edu.uni-graz.at

“Një kapitalizëm pa fytyrë njerëzore, solidaritet dhe drejtësi nuk ka moral dhe as të ardhme” citohet në kopertinë nga përmbajtja e librit *Kapitali* të arkipeshkvit gjerman Reinhard Marx. I publikuar në tetor 2008 ky libër tashmë ka hyrë në listën e bestsellerave në Gjermani.

Një letër shumëfaqëshe drejtuar adashit Karl Marx është surpriza e parë që vendos bazën për librin. A do të rrëzohet kapitalizmi për shkakun e vet? Kriza financiare dhe reagimi i shteteve ndaj saj duke iu ardhur në ndihmë bankave me paratë e taksapaguesve tregon sipas Marx që “fitimet privatizohen, humbjet socializohen. Në rast se kjo është motoja, atëherë nuk ka pse habitet njeri që sipas një studimi të Fondacionit Bertelsmann 60 vjet pas vendosjes së ekonomisë sociale të tregut 73% e gjermanëve i konsiderojnë rrethanat ekonomike si të padrejta”. Në ditët e sotshme ata që mund të çojnë në realizimin e teorive të Karl Marx nuk janë vetëm marksistët, por sipas arkipeshkvit Marx edhe kapitalistët, sepse ata rrezikojnë ta harrojnë, “që politika funksionon ndryshe nga ekonomia dhe që qytetarët dhe zgjedhësit nuk mund të pushohen nga puna sikundër punonjësit”. Duke theksuar pozicionin e tij personal¹ që tek Karl Marx shih kundërshtarin e vet të madh, por të cilit i deshmon respekt, R. Marx nis me analizën dhe artikullimin e qëndrimit të vet bazuar në doktrinën sociale të krishterë.

Kapitulli i parë i librit i kushtohet përballjes filozofike mes marksizmit, liberalizmit dhe krishtërit për të nxjerrë në pah hapësirën që secila doktrinë i jep lirisë dhe rëndësinë që liria ka për secilën prej tyre. Kundërshtia e pakapërcyeshme mes etikës së krishterë dhe marksizmit sipas autorit nuk rrjedh prej analizave ekonomike të K. Marx, por për shkak të imazhit të ndryshëm të njeriut që i qëndron atyre për bazë. Pasi bën një paraqitje të komunizmit sipas K. Marx dhe mënyrës si u shfrytëzua emri i tij nga vendosësit e mbajtësit e sistemeve totalitare, R. Marx flet për “Rrugën e Tretë” mes individualizmit liberal dhe kolektivizmit socialist, rrugë e cila në këto



kohë është shumë në modë dhe gëzon popullaritet të madh edhe jashtë rrethëve të studiuesve socialë të krishterë. Duke përshkruar rrugën deri në ditët e sotshme përmes filozofëve e filozofive që kane ndikuar zhvillimet politike, ai përfundon duke theksuar rëndësinë e zgjerimit të horizontit me transcendencën që njeriu të mos e humbë veten në perspektivën individualiste të dobisë, të mendimit ekonomik. Për ta forcuar mendimin e tij që mund të sulmohet si i ndikuar nga doktrina e krishterë, autori zgjedh këtu të citojë ekonomistin Wilhelm Röpke, njërin nga mbështetësit më të mëdhenj të ekonomisë liberale të tregut në shekullin e 20-të, i cili në librin *Jenseits von Angebot und Nachfrage* (Përtej ofertës dhe kërkesës) ka argumentuar ngjashëm me të.

Kapitulli i dytë i kushtohet ekonomisë për njeriun, ekonomisë së tregut dhe etikës. Në të bëhet krahasim mes ekonomisë së tregut dhe ekonomisë së centralizuar, bëhet një hyrje e shkurtër teorike në liberalizmin e hershëm, posaçërisht duke u ndalur tek Adam Smith dhe rëndësia e veprës së tij dhe neoliberalizmin. Mes të tjerash, në këtë kapitull vihet në dukje se mënyra sesi përdoret sot termi “neoliberalizëm” është e gabuar. Në origjinën e vet, që gjendet tek studiuesi i shkencave sociale dhe ekonomike Alexander Rüstow, neoliberalizmi dëshironte ta kufizonte veten dhe u shpall se synonte përgjegjësinë sociale të ekonomisë dhe përparësinë e të mirës së përbashkët dhe politikës. Duke u ndalur tek neoliberalizmi dhe rrënjët e tij, R. Marx jep të dhëna dhe mbi mënyrën sesi

¹ Për ta shprehur qëndrimin i referohet përfaqësuesit më të shquar të shkencave sociale katolike në shekullin e 20-të, Oswald Nell-Breuning, i cili ka artikulluar qëndrimin e Kishës Katolike ndaj Karl Marx dhe veprës së tij.

ndodhi përmirësimi i marrëdhënieve të doktrinës sociale të krishterë dhe teorisë ekonomike liberale, duke nxjerrë në pah këtu figurën dhe rolin e kardinalit Joseph Höffner, i cili që njëkohësisht një personalitet në shkencë dhe student i njërës prej përfaqësuesve të shquar të neoliberalizmit (ordoliberalizmit), Walter Eucken.

Në hyrje të shekullit të 21-te përtej problemesh konkrete që presin për t'u zgjidhur për R. Marx qëndron gjithashtu një pyetje thelbësore e pikërisht "nëse për ne edhe në vazhdim njeriu qëndron në qendër të veprimtarisë shoqërore dhe ekonomike".

Në kapitullin e tretë autori përqendron vëmendjen në kushtet sociale në shoqëri, posaçërisht në shoqërinë gjermane. Duke theksuar se qëllim i përbashkët i aktorëve ekonomikë, politikë dhe shoqërore duhet të jetë tejkalimi i përjashtimeve sociale të çdo lloji forme, si një kërkesë morale, por gjithashtu në interes ekonomik të të gjithëve, ai apelon për drejtësinë sociale. Drejtimi i shoqërisë që përmban në bazë drejtësinë sociale, sipas tij është i arsyeshëm dhe nga këndvështrimi ekonomik. Për këtë mjafton të merret për bazë shembulli i suksesshëm gjerman i ekonomisë sociale të tregut.

Ngjashëm me kapitullin e tretë vazhdohet dhe në kapitujt pasardhës. Principin e drejtësisë me aspektet e tij përbërëse autori e sheh aq të domosdoshëm për shoqërinë e shtetit, sa në hyrje e mbyllje të kapitullit të katërt të librit duke iu referuar Atit të Kishës Agustinus, të shkruajë se pa drejtësi shtetet nuk janë asgjë tjetër përveçse banda hajdutësh.

Në kapitullin e pestë paraqitet një model i drejtësisë së pjesmarrjes që vë në dukje nevojën për një politikë të drejtë dhe të qëndrueshme reformash, për të cilin Marx është i ndërgjegjshëm që nuk është aq konkret sa prej tij të nxirren menjëherë hapa reformash. Por një hap të rëndësishëm ai dhe kolegët e tij nga konferenca e ipeshkëve të Gjermanisë quajnë krijimin në Gjermani të një këshilli të pavarur ekspertësh që do të merret me vëzhgimin e zhvillimit social të vendit. Si shembull orientues për këtë ipeshkvët në propozimin e tyre marrin Këshillin e "Pesë të Urtëve të Ekonomisë", i cili qysh prej vitit 1963 vëzhgojnë zhvillimin ekonomik të Gjermanisë dhe këshillojnë qeverinë lidhur me hapat që është e nevojshme të ndiqen në të tashmen dhe të ardhmen.

Në dy kapitujt pasardhës kalohet konkretisht në temat puna, arsimit dhe familja, ku adresimi bëhet kryesisht për shtetin dhe nevojën e ndërmarrjes prej tij të reformave në këto fusha. Gjithashtu paraqitja konkretizohet në temën e moralit të kapitalit, në nevojën që ndërmarrjet të kuptojnë përgjegjësinë e tyre morale në shoqëri. Këtu duke iu referuar modelit *Stakeholder*, i cili ka fituar rëndësi veçanërisht vitet e fundit, Marx thekson se është e domosdoshme që standarte ligjore në fusha si e drejta e punës, e drejta e mbrojtjes së konsumat-

torit, e drejta e konkurrencës, të cilat janë vendosur tashmë në nivel kombëtar, të vendosen dhe në nivel ndërkombëtar, çka do të ndikonte në atë që ndërmarrjet që nuk veprojnë me përgjegjësi sociale të mos përfitojnë nga konkurrenca e pisët kundrejt të tjerëve që mbajnë përgjegjësi sociale.

Politikanët si ligjbërës duhet ta shohin si detyrë, që të mos bëjnë gjë "që do të jepte përshtypjen e keqe, që qeveria dhe parlamenti nuk vendosin sipas interesave të së mirës të përbashkët, por sipas interesave për fitim të ndërmarrjeve të caktuara ekonomike". Për interes të integritetit të institucioneve shtetërore, për R. Marx është e nevojshme që të mos ekzistojë shenjë që lë të kuptohet, se ekziston një lidhje mes vendimeve të marra në detyrën publike dhe një veprimtarie në ekonominë private, të cilën personi e nis pasi ka dalë nga detyra. Një kërkesë për një lloj kodi të tillë është sjellë tashmë në parlamentin gjerman dhe autori përfundon duke u shprehur se e ka mirëkuptim për të.

Në kapitullin e tetë temë bëhet globalizimi i drejtësisë dhe rendi botëror solidar. Në qendër të politikës për rendin botëror sipas Marx duhet të qëndrojnë Organizata e Kombeve të Bashkuara ashtu si dhe organizata të tjera, të cilat ekzistojnë tashmë, si Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF), Banka Botërore, Organizata Botërore e Tregtisë (WTO), Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). Duke pranuar kritikën e ngritur kundër këtyre organizatave, por duke kritikuar gjithashtu dhe argumenta të antiglobalistëve, autori flet për nevojën e veprimit në nivel global dhe për solidaritetin me të gjithë njerëzit.

Në kapitullin përmbyllës në të cilin autori ndalet në dëshimin e sistemeve socialiste në të cilët u zbatua marksizmi, në përpjekjet filozofike të dala pas rënies së këtyre sistemeve si ato të Francis Fukuyama, të Samuel Huntington apo të Robert Kagan. Këndvështrimi i Fukuyamas, i ndarë dhe nga shumë të tjerë, e trajtonte ekonominë e tregut si një sistem pa alternative konkurruese, ndaj kjo sipas R. Marx bëri që për vite me rradhë të mos vritej mendja për bazën etike të ekonomisë dhe ekonomibërjes. Sipas tij kjo reflektohet dhe në përgatitjen e studentëve në fakultetet e ekonomisë, ku të sapodiplomuarit zor se i njohin librat e Wilhelm Röpke, Walter Eucken, Alexander Rüstow apo Friedrich August von Hayek dhe nuk e kanë mësuar kurrë ta trajtojnë ekonominë edhe si shkencë humane, në një kohë që në të bëhet fjalë për sjelljen e njerëzve. Nisur nga kjo, Marx, duke iu referuar edhe krizës financiare të këtij viti e sheh me shqetësim tendencën që mund të çojë në një zhvillim të rrezikshëm, në të cilin ajo që në Gjermani dhe vende të tjera njihet si ekonomi tregu, të shndërrohet në kapitalizëm primitiv. Sipas tij njerëzit, të cilët do të vuajnë pasojat e një ekonomie, ku fitimi përbën tiparin

e vetëm orientues, ndoshta do të mund t'i kthehen utopive marksiste. Dhe kjo është një gjë që nuk duhet lejuar të ndodhë, sepse pasojat e këqija të këtyre utopive njerëzimi tashmë i ka përjetuar. Në të mirë të njerëzve si politika, ashtu dhe çdo njeri që është i përfshirë në zhvillimet ekonomike duhet ta konsiderojë si detyrë të punojë për një ekonomi sociale globale të tregut. Që Karl Marksini me njerëzimi mos të ndeshet më gjatë udhës. Ky është mesazhi me të cilin ipeshkvi Reinhard Marx mbyll librin e tij,

Libri *Kapitali* i Reinhard Marx vjen në kohë shumë të përshatshme në debatin për reformimin e kapitalizmit. Kombinimi i disa elementëve si titulli i librit, mbiemri i autorit, profesioni i tij, doktrina që ai përfaqeson, e bëjnë librin një befasi me vlerë për lexuesin, edhe për atë që nuk ka ndonjë lidhje shpirtërore me doktrinën e krishtere ose me marksizmin. Temat që shtrihen, mënyra e argumentimit që lë vend për debat, ilustrimi me shembuj konkretë nga jeta ekonomike dhe shoqërore, udhëzimi për shfletim literature të mëtejshme, thjeshtësia në shkrim, e bën tekstin të këndshëm dhe të kuptueshëm. Lexuesi që kërkon një përballje me argumenta e analiza thjesht ekonomike dhe/ose bazuar në modele analitike, është e nevojshme t'i ndryshojë pritshmëritë që në fillim.

Marx arrin me sukses të përcjellë idenë, se shkencat ekonomike janë edhe shkencë humane e si të tilla është koha që brenda tyre të trajtohen gjerësisht ato tema që ai i shtjellon gjerësisht në libër.

Ekonomibërësit dhe drejtuesit e bizneseve private mund të gjejnë tek ky libër një kujtesë të mirë për debatet e hershme dhe të mëvonshme në ekonomi dhe një apel të fortë për të mos rrezikuar rrjedhën e historisë së njerëzimit në kushtet e një shoqërie globale si e sotshmja.

Duke e parë Kishën Katolike si një organizëm pjesë e modelit *Stakeholder* të ekonomisë dhe shoqërisë së sotshme mund të thuhet se ky libër dhe doktrina sociale e krishterë që përcillet përmes tij, i lejon Kishës të pozicionohet mirë në platformën e debateve për reformimin ekonomisë së tregut dhe shoqërisë dhe e kthen atë në një faktor, të cilit ndoshta do t'i kushtohet përsëri më shumë vëmendje, sesa në vitet e fundit.

Das Kapital

Autor: Reinhard Marx

Pattloch Verlag GmbH & Co. KG, München 2008

<http://www.amazon.de/Das-Kapital-Streitschrift-Reinhard-Marx/dp/362902155>

RRJETI QË NDOT

Sa orë në ditë kalojmë në internet? Vështirë të japësh një përgjigje të saktë por me siguri shumë orë dhe jo me kosto zero për mjedisin. Në studim i fundit i Harvard University di Boston ka nxjerrë se vetëm një klik i mausit tonë prodhon 5-10 gramë gaz karbonik në atmosferë, po aq sa prodhon edhe një furnelë elektrike për të një tas çaji.

Ky lajm që u publikua pak më parë në faqen elektronike të Times, në pak orë bëri xhiron e botës dhe natyrisht “vëllai i madh” nuk vonoi të thotë fjalën e tij. Google menjëherë kundërshtoi të dhënat e studimit në fjalë: sipas drejtuesve të motorit të kërkimit më të përdorur në botë një klik i vetëm prodhon vetëm 0.2 gramë CO₂.

Por duke shkuar pak më tej ballafaqimit të shifrave, studimi i Universitetit të Harvardit denoncon shpërdorimet energjetike të internetit që nuk prekin vetëm Google. Sipas Alexander Wissner-Gross, fizikan dhe njeri prej autorëve të studimit, shumë site web janë përgjegjës për një shkallë të lartë të çlirimit të gazit karbonik nga gabimet në software apo probleme të tjera që zgjasin kohën dhe shtojnë energjinë kur dikush viziton faqet e tyre. E, midis tyre ka edhe site të njohur e shumë të frekuentuar.

“Analizat tona – shpjegon ai – treguan se në 10 janar 2009, siti i kryeministrit anglez punonte vetëm me 64% të efikasitetit të tij, siti i mbretërshës me 54% dhe ai i BBC-së vetëm me 49%”.

Po të konsiderojmë se janë miliona persona që çdo orë të çdo dite vozisin nëpër rrjet, llogaria për mjedisin del me të vërtetë e kripur. Sipas studimeve amerikane rrjeti është përgjegjës për 2% të të gjithë sasisë së gazit serrë të prodhuar në planetin tonë çdo vit e për herë të parë, nga viti 2007, gjurma ekologjike e teknologjisë informative dhe të komunikimit ia kaloi për herë të parë asaj të prodhuar nga industria ajrore botërore.

Megjithatë nuk është e thënë që zgjidhja e fundit është braktisja e internetit. Përkundrazi, sipas autorëve të studimit zgjidhja qendron pikërisht tek teknologjitë. “Webi mund të reduktojë impaktin e tij mjedisor duke përdorur software që i bëjnë sitet më efikasë nga këndvështrimi energjetik” përfundon Wissner-Gross.


Me pak fjalë, një sit më i shpejtë jo vetëm që do kënaqë përdoruesit e shumë por do ta bënte rrjetin edhe pak më të gjelbër.

LABORATORËT MË TË NJOHUR TË BOTËS

Fermi National Accelerator Laboratory

(Fermilab), Batavia, Illinois, është një laborator i njohur i Departmentit Amerikan të Energjisë i specializuar në fizikën e grimcave me energji të lartë. Nga viti 2007 ai drejtohet nga Fermi Research Alliance, një joint venture e University of Chicago dhe Universities Research Association (URA), një konsorcium prej 91 universiteteve më të njohur kërkimore në SHBA, Kanada, Japoni dhe Itali.

<http://en.wikipedia.org/wiki/Fermilab>



Pyjet e virgjëra të ahut në Shqipërinë e Veriut: Lumi i Tropojës

Qysh në shek. XIX kërkimi shkencor në fushën e pyjeve i ka kushtuar një vëmendje të veçante studimit të pyjeve të virgjër. Njohuri me shumë vlerë mbi proceset natyrore të jetës në pyll u nxorrën në fillim të këtij shekulli nga studime të kryer në pyjet e virgjër të Europës juglindore (Frohlich 1925, Markgraf 1926, Dengler 1931).

Qëllimi kryesor i shumë studimeve mbi pyjet e virgjër ishte *mbledhja e informacioneve të rëndësishme mbi proceset natyrore të zhvillimit të pyllit, për të krijuar koncepte të reja të mbarështrimit të tij sipas ligjeve të natyrës*.

Një arsye e rëndësishme për këtë është se në Europën perëndimore dhe qendrore nuk ekzistojnë më pyje të virgjër në kuptimin e plotë të fjalës. Pyje të paprekur ende ekzistojnë vetëm në Europën juglindore, si në Alpet, Çeki, Sllovaki, Rumania, Poloni dhe Shqipëri. Njohuritë e deritanishme mbi dinamikën e pyjeve të virgjër europiane, mbështeten pikërisht në studime të kryer në pyjet e sipërpërmendur (Frohlich 1954, Markgraf 1931, Leibendgut 1993, Korpel 1995).

Përsa i përket konceptit “pyll i virgjër”, ai është përcaktuar nga shkencëtarë të ndryshëm në forma të ndryshme. Kështu Leibendgut (1933) e përkufizon atë si “...një pyll i pa prekur nga njeriu, me dru madhështorë dhe me një vëllim drusor të madh, me një nënpyll të dendur që përshkohet me vështirësi dhe me një masë të madhe drurësh të vdekur”. Sipas Korpel (1995) me një pyll të virgjër kuptohet “...një shoqërim pyjor përbërja e të cilit, ndërtimi, rritja dhe procese të tjera jetësore janë të kushtëzuara nga kushtet e mjedisit, para së gjithash nga klima”. Kjo strukturë ekologjike u quajt nga Braun-Blanquet (1951) “Pyll klimaks, pasi shoqërimi klimaks trupëzon një ekuilibër dinamik midis klimës, geomorfologjisë, tokës dhe bimësisë...”

Shqipëria ka ende sot, në zonat malore, në rajone të pambërritshme “pyje të virgjër”. Mbrojtja e tyre është jo vetëm me interesa kombëtare por edhe ndërkombëtare. Një studim të tillë kemi kryer në Lumin e Tropojës ose siç njihet nga banorët e zonës “Lumi i Sulbicës”, i cili është tërësisht një pyll i virgjër me një sipërfaqe prej 2000 ha por për të cilin nga autoritetet shtetërore nuk është marrë asnjë masë ruajtjeje. Ky pyll bën pjesë në juridiksionin e rrethit të Tropojës dhe administrohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor të këtij rrethi.

Leibendgut (1959) ishte i pari që hodhi parimet bazë metodike të studimit të pyjeve të virgjër, të cilat duke u zhvilluar më tej nga shkencëtarë të tjerë çuan në të ashtuquajturën “teori të fazave të zhvillimit”. Sipas Leibendgut (1993) në plan të parë të studimeve silvikulturore në pyjet e virgjër janë këto qëllime:

- Proceset dhe shkaqet e dinamikës së zhvillimit të shoqërive natyrore;

- Qendrueshmëria e stukturave të ndryshme të grumbujve pyjorë kundrejt ndikimeve të mjedisit (p.sh. përmasat dhe zgjatja e fazave kritike të mplakjes së drurëve);

- Ligjësitë e ecurisë së jetës së drurëve të veçantë të kushtëzuara nga specia dhe mjedisi;

- Dukuria dhe shkaqet e suksesionit natyror të llojeve pyjore;

- Ndikimi i ecurisë së ripërtëritjes mbi ecurinë e mëvonshme të rritjes dhe të plakjes;

Qëllimet e studimit

- Dokumentimi i gjendjes së pyjeve të virgjër në Lumin e Tropojës në sipërfaqe prove të përzgjedhura;

- Me cilat metoda mund të matet dhe të përshkruhet më mirë tekstura e një pylli?

- Nëpër cilat faza kalon një pyll natyror dhe një pyll i mbarështuar dhe nga çfarë strukturash horizontale e vertikale karakterizohen fazat e veçanta të zhvillimit?

- Si ndikon madhësia e çeltirave në mundësinë e përparimit dhe përbërjes llojore të filizërisë në pyjet e virgjër?



Ekzistojnë disa koncepte kryesore të studimit të pyjeve natyrore dhe të virgjër në Europë si p.sh.:

- Studimi i pyjeve rezervate natyrore (përdoret kryesisht në Gjermani) me anë të studimeve të përsëritura në sipërfaqe prove të shpërndara në mënyrë sistematike në të gjithë sipërfaqen e rezervatit.

- Inventarizimi i mbetjeve të pyjeve të virgjër, rezervateve dhe pyjeve natyrore me vlerë për tu mbrojtur (përdoret në Austri). Në këtë metodë nuk ka një koncept të saktë përsa i përket sipërfaqeve provë.

- Përshkrimi i pyllit, kryesisht i ahishteve të vjetra, me anë të sipërfaqeve provë rrethore (në Itali).

Duke qenë se në ekonominë pyjore Lumi i Tropojës specie kryesore është ahu, kemi përdorur metodën italiane të matjeve dhe përshkrimit të sipërfaqeve provë. Konkretisht janë marrë gjithsej 20 sipërfaqe me rreze 20m (400m²) secila.

Janë përdorur aparatura si Gps, për gjetjen e pjerrësisë dhe të lartësisë mbi nivelin e detit, Vertex, për të matur distancën nga druri te pika që është marrë si qendër e sipërfaqes provë, busull, blumelais, kalibër, metërshirit etj.

U krye edhe matja e gumbullit në këmbë dhe atij të rrëzuar (drurët e tharë e të kalbur sipas shkallës së dekompozimit).




Fig.1. Shpërndarja e sipërfaqeve prove në disa parcala



Fig.2. Zona ku u krye studimi

Distanca nga njera sipërfaqe provë te tjetra u caktua 200m. Në sipërfaqet provë (400 m²) u bë matja e grumbullit në këmbë. Si pikë referimi gjatë matjeve u përdor qendra e sipërfaqes provë e cila u pajis me një piketë. U matën të gjithë drurët me diametër më të madh se 4 cm. Pastaj pasonte një matje e koordinatave të drurëve nëpërmjet distancës dhe këndit azimutal. Grumbulli në këmbë përmbledh të gjithë drurët në këmbë, me dhe pa jetë, si edhe trungjet e thyer më të lartë se 1,3 m. Cungjet e ndryshme më të shkurtër se 1,3 m u klasifikuan tek grumbulli i rrëzuar (shtrirë). Kur kishim të bënim me elemente drusorë të vdekur u krye edhe përcaktimi i shkallës së kalbëzimit të tyre si më poshtë:

	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5
Lëvorja	E paprekur	E paprekur	Gjurmë	Mungon	Mungon
Degët	Të pranishme	Mungojnë	Mungojnë	Mungojnë	Mungojnë
Tekstura e drurit	E fortë	E fortë ose pjesërisht e butë	E butë	Shumë e degraduar, pjesërisht pluhur	Pluhur
Forma	Rrethore	Rrethore	Rrethore	Rrethoro-ovale	Ovale

Inventarizimi i filizërisë

Rilevimet e filizërie u kryen vetëm në ato sipërfaqe ku kishte çeltira nga drurët e rrëzuar apo të thyer nga dëbora.

Matja u krye me metër shirit duke e hapur atë 20m në formë plusi (+) dhe në 1m² numërohen të gjithë filizat dhe matet lartësia e tyre. Më pas 2m të tjera nuk maten e më tej merret përsëri 1m² e kështu me radhë.





Fig. 3 Metodologjia e matjes së filizërisë në formë (+) 20 m

Për të parë vlerat e larta të këtij pylli të virgjër për çdo sipërfaqe prove janë llogaritur treguesit e mëposhtëm:

1. Numri i drurëve për ha
2. Sipërfaqja bazimetrike për ha
3. Volumi për ha
4. Biomasa për ha
5. Nekromasa për ha


	N	G	V	B	N
1	333.2	60.8	1159.93	524.21	145
2	697.3	54.8	996.8	453.55	66.33
3	864.6	45.5	814.5	365.95	2.53
4	353.1	70.5	1407.2	650.07	76.01
5	294.8	59	1107.9	509.66	199.32
6	310.4	60.9	1171.2	531.43	229.62
7	238.7	46.1	880.7	401.8	77.57
8	400.3	57.9	876.4	390.4	57.8
9	300.5	52	798.4	345.9	64.5
10	440.8	50.5	797.6	330.2	55.9
11	420.2	66.7	1130.8	589.3	102.3
12	280.4	42.6	798.6	325.5	67.3
13	420.3	66.7	1130.8	605.8	79.98
14	235.2	42.6	763.8	385.4	53.6
15	640.1	68.1	979.2	450.6	64.3
16	700.2	59.5	965.8	449.4	60.8
17	540.4	56.4	821.3	420.2	59.6
18	280.6	48.5	773.3	304.6	58.5
19	398.5	59.7	998.9	464.3	118.9
20	756.5	49.7	876.4	434.2	112.3
	8906.1	1118.5	19249.5	8932.5	1752.2
Mes/ha	445.3	55.9	962.5	446.6	87.6







Shpërndarja e diametrave në klasat diametrike

Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e diametrave neper klasat diametrike. Siç duket edhe nga paraqitja grafike kemi të bëjmë me një shpërndarje që është tipike për strukturën kopshtore të grumbujve pyjorë. Kjo dëshmon se kemi të bëjmë me një pyll me të vërtetë të virgjër.



Llogaritja e kurbës së lartësisë së drurëve

Kurbat e lartësive janë një paraqitje grafike e lidhjes midis lartësisë së drurëve me diametrat përkatës të tyre në një grumbull pyjor. Këto llogaritje u kryen me programin Excel.




Përfundimet e studimit dhe rekomandimet

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se përmbajtja në lëndë ushqyese e stacioneve është shumë e mirë. Reshjet vjetore në grumbujt e ekonomisë luhaten midis 1000 dhe 1500 mm në vit. Nëse kërkohet që kushtet e rritjes për ahun të vlerësohen në mënyrë të përmblendhur për grumbujt provë, mund të konstatohet që të gjithë stacionet lejojnë një rritje shumë të mirë të ahut. Për këtë flasin lartësitë maksimale të matura, të cilat në grumbujt e studiuar lëvizin midis 40 dhe 45 m. Masivi pyjor i Lumit të Trojes ka si lloj kryesor ahun, i cili në këtë ekonomi ka një shtrirje të gjerë dhe formon pyje të pastër, ndërsa në disa pjesë formon edhe përzjerje me llojet bredh, panjë mali, rrobull etj. Gjithashtu edhe llojet bredh i bardhë dhe rrobull, në disa parcela të veçanta, formojnë grumbuj të thjeshtë dhe me elemente dendrometrike të kënaqshëm. Duke ju referuar të dhënave dhe matjeve biometrike gjatë vëzhgimit ekologjik, në këtë ekonomi pyjore për llojin kryesor ah rezultojnë se grumbujt pyjorë kanë një moshë mesatarisht 150-200 vjeçare.

Vetitë silvikulturore të ahut edhe gjatë zbatimit të qëllimeve ekonomike lejon një strukturë shumë afër natyrës dhe me sipërfaqe të vogla të shumëllojshme. Metodën më të përshtatshme duket të jenë ato të prerjeve suksesive jo uniforme apo ajo pak më e moderuar e shfrytëzimit me diametër kufi. Këto metoda çojnë në forma natyrore të pyllit dhe prodhojnë në krahasim me pyjet e virgjër dhe ato kopshtore material drusor me cilësi që arrihet më shpejt. Në qoftë se çeltirat e vogla të krijuara zakonisht nga rrëzimi i drurëve të vetëm nuk do të zgjerohen më tej, atëherë qëllimi i vënë për një ripërtëritje të caktuar mund të jetë problematik. Kështu, mund të themi se pjesë përbërëse e të gjitha metodave silvikulturore që merren me çeltira ripërtëritëse, duhet të jenë zmadhimet periodike të këtyre çeltirave.

Këndi i librit



U dorëzua për shtyp libri “Data Mining in Agriculture” me autorë Antonio Mucherino, Petraq Papajorgji dhe Panos M. Pardalos. Libri do të botohet nga shtëpia botuese Springer në serinë “Springer Optimization and Its Applications”.

Dëshiroj të falenderoj me këtë rast kolegët dhe miqtë e mij të vjetër Niko Qafoku, Fatos Xhafa dhe Robert Magari për ndihmën e vyer që ata dhanë për përgatitjen e këtij libri. Vërejtjet dhe komentet e tyre shërbyen në përmirësimin e vëllimit. Jam shumë i gëzuar të shoh një projekt ku pjesëmarrja e studiuesve shqiptarë ishte e konsiderueshme. Uroj që edhe në të ardhmen të kemi suksese të tilla.

Petraq Papajorgji
Center for Applied Optimization
University of Florida

<http://www.isima.fr/~kang/DEAS/Publications.htm>

Mbi librin e Dr. Bajram Berishës “Rregullimi lokal në vezoren bovine – Degradimi i matriksit jashtëqelizor, angiogjeneza dhe angiolyza”

Në librin e tij *Rregullimi lokal në vezoren bovine- degradimi i matriksit ekstracelular, angiogjeneza dhe angiolyza* (i botuar në gjuhën angleze në Gjermani me titullin *Local Regulation in the Bovine Ovary -Extracellular Matrix Degradation, Angiogenesis and Angiolytic* nga shtëpia botuese Sierke Verlag – Göttingen, 2007), Dr. Berisha ka përmbledhur punën e tij shkencore të viteve të fundit në Universitetin Teknik të Mynihut.

Ndryshimet periodike gjatë ciklit seksual që ndodhin në vezore (*ovarium*) karakterizohen me proliferim, diferencim dhe transformim të qelizave, të cilat janë të lidhura me zhvillimin e folikulave, ovulimin si dhe formimin, funksionin dhe regresionin e trupit të verdhë (*corpus luteum*).

Hulumtimet shkencore në këtë libër janë përqendruar në analizën e faktorëve, të cilët ndikojnë në formimin e enëve të reja të gjakut, proces i quajtur angiogjenezë. Në procesin e angiogjenezës gjatë funksionimit të vezores janë të përfshira proteazat e matriksit jashtëqelizor (ECM) si metaloproteazat e matriksit (MMP), aktivatorët plazminogjenë (PA) si dhe faktorët angiogjenetikë (familjet e faktoreve VEGF, FGF dhe angiopoietinë). Nga rezultatet e Dr. Berishës mund të konstatohet se janë faktorët e njëjtë që ndikojnë edhe në procesin e kundërt pra të zhbërjes së enëve të gjakut (angiolyzës), e cila në mënyrë fiziologjike ndodh në mënyrë periodike gjatë regresionit të trupit të verdhë.

Proceset në vezore duke filluar me rekrutimin e folikulave, pjekjen dhe ovulimin e tyre e deri te formimi dhe funksionimi i trupit të verdhë, duke përfshirë edhe regresionin e tij, janë të lidhura ngushtë me procesin e angiogjenezës. Angiogjeneza konsiderohet njëra ndër pikat kyçe të funksionimit normal të vezores dhe ka implikim esencial në proceset e rregullimit të riprodhimit (fertilitetit) tek shtazët dhe njeriu. Përveç kësaj, vezorja ofron një model të shkëlqyer për të studiuar dhe kuptuar deri në detaje mekanizmat molekularë të angiogjenezës dhe angiolyzës në kushte të caktuara fiziologjike.

Dr. Berisha me punën e tij shkencore gjatë këtyre viteve të fundit ka dhënë një kontribut të madh në sqarimin e këtyre mekanizmave. Rezultatet e tij janë një ndihmë e madhe për të gjithë shkencëtarët anëmbanë botës, të cilët merren me këtë


temë. Gjithsesi, në këtë fushë ka ende segmente, të cilat kërkojnë hulumtim të mëtejshëm, kryesisht në fushën e biologjisë molekulare të qelizave.

Arritjet shkencore të Dr. Berishës paraqesin një ndihmë të madhe edhe për mjekësinë humane, ku steriliteti në përgjithësi dhe çrregullimet funksionale të vezores në veçanti, paraqesin një problem të madh.

Në anën tjetër, angiogjeneza dhe angiolyza janë fenomene me rëndësi të madhe në procesin e rritjes, respektivisht regresionin e sëmundjeve malinje (tumoreve). Këtu duhet theksuar se duke shfrytëzuar arritjet shkencore në këtë fushë, tashmë kanë filluar të aplikohen kurimet e para (*target therapy*) që paraqesin përdorimin e antitropave kundër disa faktorëve angiogjenetikë. Kështu p.sh. disa medikamente kanë filluar të përdoren në terapinë e karcinomës së gjirit dhe vezores. Shumica e këtyre medikamenteve aktualisht janë në fazën e testimit klinik dhe lejohet të aplikohen vetëm në kuader të studimeve klinike (*trials*).

Libri i Doc. Dr. Habil. Dr. Bajram Berishes, ku përfshihen një varg artikujsh origjinalë shkencorë të autorit, që janë botuar më parë edhe në revistat më të njohura botërore, paraqet një kontribut me rëndësi për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të angazhohen në hulumtime të mëtejshme në fushën e angiogjenezës dhe angiolyzës.

Autori është specialist gjinekolog në Klinikën Universitare të Jenës dhe mësimdhënës e bashkëpunëtor shkencor në Universitetin Friedrich Schiller të Jenës (Gjermani)



Instituti Alb-Shkenca
ju uron të gjithëve Vitin e ri 2009!
Suksese të mëtijshme në punë dhe në jetë.

